DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 419 • TETOR 2025

RËNDËSIA E MBROJTJES
SË IMAZHIT TË ISLAMIT

LITERATURA DHE TERMINOLOGJIA
SHKENCORE E SHKOLLES JURIDIKE HANEFITE

DEHUMANIZIMI DHE KRIZA
E NJERIUT ME HYJNOREN

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnava, me rastin e 12 Rebiul-Evelit, ditëlindjes së Pejgamberit a.s.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar besimtarë,

Vëllezër dhe motra!

Sonte, në këtë natë të bekuar të 12 Rebiul-Evelit, ne përkujtojmë lindjen e më të dashurit të Allahut, Pejgamberit tonë, Muhamed Mustafasë a.s., i cili është mëshira e dërguar për mbarë botët.

Kjo natë e shënuar dhe ky muaj i bekuar, i njohur si Muaji i Mevludit, na fton ta përforcojmë besimin tonë, dashurinë dhe respektin ndaj të Dërguarit të Allahut.

Pejgamberi a.s. është shembull i përsosur i mëshirës, drejtësisë, përkushtimit dhe moralit më të lartë. Ai është drita që ndriçoi njerëzimin, udhëzuesi që na mësoi si të jetojmë me dinjitet, me adhurim dhe me shpresë. Dashuria për të është pjesë e imanit tonë, ndërsa respekti ndaj tij është rruga drejt afrimit me Zotin. Allahu i Madhërishëm, në Kuranin fisnik, thotë: "Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) si dëshmitar, si përgëzues dhe si qortues; që të thërrasësh njerëzit tek Allahu me lejen e Tij dhe si një dritë ndriçuese." (El Ahzab, 45-46).

Dashuria e besimtarëve për Pejgamberin Muhamed a.s. është e pakushtëzuar dhe e përhershme. Ajo nuk kufizohet vetëm në fjalë, por manifestohet në adhurim, në ndjekjen e Sunetit të tij dhe në përpjekjen për të pasqyruar moralin e tij në jetën e përditshme. Besimtarët e ndiejnë të Dërguarin a.s. më afër se çdo njeri tjetër, e përmendin me salavate, e nderojnë në zemrat e tyre dhe e shohin si udhërrëfyesin që i lidh me Krijuesin e gjithësisë. Kjo dashuri është një shenjë e fortë e imanit, ashtu siç ka thënë vetë Pejgamberi a.s.: "Askush prej jush nuk beson vërtet, derisa të mos më dojë mua më shumë se prindërit e tij, fëmijët e tij dhe të gjithë njerëzit e tjerë."

Përgjatë shekujve, dijetarët dhe ulematë tanë e kanë kujtuar dhe nderuar të Dërguarin a.s. me vepra të vyera, me kaside, mevlude, ilahi dhe libra biografikë, që pasqyrojnë jetën dhe misionin e tij madhështor. Kështu, dashuria ndaj Pejgamberit a.s. është bërë pjesë e kulturës sonë fetare dhe shpirtërore.

Nata e Mevludit nuk është vetëm kujtim i lindjes së tij, por edhe thirrje për të ecur në rrugën e tij, për të manifestuar me vepra dashurinë ndaj tij, duke u munduar të përqafojmë moralin e tij të lartë dhe mësimet e tij hyjnore.

Prandaj, ftojmë besimtarët tanë, familjet tona dhe institucionet e Bashkësisë Islame që këtë muaj të bekuar ta kalojnë duke e përkujtuar në mënyrën më të mirë Pejgamberin a.s., qoftë në ambientet e shtëpisë, me namaz, dhikër dhe lexim të ilahive, qoftë nëpër institucionet fetare, me ligjërata, manifestime dhe veprimtari që ngjallin dashurinë ndaj të Dërguarit të Allahut.

Urime kjo natë e shënuar, me shëndet, mbarësi e harmoni për të gjithë.

Qoftë i kënaqur Allahu dhe Pejgamberi a.s. me veprat tona!

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnava

2 Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnava, me rastin e 12 Rebiul-Evelit, ditëlindjes së Pejgamberit a.s.

EDITORIAL

4 Selektivizimi subjektiv i dijetarëve si tregues i dekadencës sonë

FETARE

5 Rëndësia e mbrojtjes së imazhit të Islamit
Evzal Sinani

9 Pejgamberi i udhëzimit dhe i dritës për të gjithë njerëzimin
Mimoza Sinani

12 Pejgamberi a.s., model i përkryer i jetës bashkëshortore dhe familjare (2)
Prof. ass. dr. Ilmije Kuqi

15 Devotshmëria, tipar i dijetarëve të gjeneratave të së kaluarës
Hfz. Arif Emini

18 Asketizmi - ilaçi i zemrës në kohën e garës për dynjanë
Blerim Musliu

20 Oshënaria – domosdoshmëri e kohës
Mr. Artan Musliu

22 Literatura dhe terminologjia shkencore e shkollës juridike hanefite
Mr. Ekrem Maqedonci

26 Hadithi në shkollën juridike hanefite
Myfti Muhamed Teki Uthmani

30 Roli i hytbes së xhumasë në edukimin fetar
Blerim Ramabaja

FAMILJE & EDUKIM

33 Dehumanizimi dhe kriza e njeriut me hyjnoren
Dr. Adnan Shala

36 Mosndarja e kohës me fëmijët si faktor i lajthitjes së tyre në jetë
Adlie Morina-Krasniqi

KULTURË

40 Kush i dha fund skllavërisë, Islami apo Perëndimi?
Dija Halid

44 Feja, shkenca dhe përgjegjësia etike
Nehat Shehu

48 Roli historik i hoxhallarëve për arsimimin shqip në Kosovë
PhDc. Agon Krasniqi

51 Ndikimi i trashëgimisë kulturore islame në zhvillimin e Evropës
Ermal Bega

54 Leksionet e Huzurit dhe zhvillimi i tyre historik
Arton Halili

AKTIVITETE

57 Myftiu Tërnava priti në takim ministrin në detyrë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore

Nr. 419 • viti 39 • Tetor 2025
• Rebiul Ahir 1447
• Çmimi 1 €

Boton
Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi

Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnava,
Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. “Bajram Kelmendi”, nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
“Printing Press”, Prishtinë.

Selektivizimi subjektiv i dijetarëve si tregues i dekadencës sonë

"... dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli (dikujt) e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë se ajo është më afër devotshmërisë. Kini dronë Allahun se Allahu di hollësisht atë që vepronі." .

(El Maide, 8)

Gjatë epokave të ndritshme të historisë islame, epiteti i dijetarit i është dhënë vetëm atyre që e kanë merituar me virtytet e tyre të larta morale e fetare, si dhe me thellësinë e tyre hulumtuese dhe shkencore. Këtë gradë, do ta arrijnë vetëm ata që sinqeritetin me Allahun e kanë pishtar ndriçues në këtë rrugëtim, si dhe që durimin e çeliktë për të kërkuar dije e kanë të gdhendur thellë në shpirtin e tyre. Pos këtyre, ata kanë edhe tipare të cilat ua përshkroi më së miri Muhamedi a.s., kur tha: "Këtë dituri (dhe këtë fe) do ta bartin në çdo brez vijues, njerëz të drejtë-besueshëm; ata do ta largojnë prej saj shtrembërimin e ekstremistëve, pretendimet e rreme të gënjeshtarëve dhe interpretimet e gabuara të injorantëve." (El Bejhakiju, 21439). Beteja e dijetarëve të vërtetë, që janë të dëshmuar për konsekuencë, sipas këtij hadithi është me tri kategori, që me gjasë, asnjë periudhë historike nuk do të mbetet e qetë nga zhurmat e pandalshme të tyre; ekstremistët, gënjeshtarët dhe injorantët. Asnjëra nga këto tri kategori nuk mungon as sot, madje ata duket se janë të shumtë edhe në numër, por edhe më i madh duket që është numri i atyre që magjepsen me "mendimet" e tyre.

Prirjet e ndjekësve dhe pasuesve fanatikë, në çdo kohë, rëndom nuk ndalen te vlerësimi i shëndoshë i kontributit të dijetarëve, apo te veprat kolosale që ata lanë trashëgimi për ne. Rrjedhimisht, të njëjtit bëjnë dy gabime jo të lehta në peshojën e drejtësisë islame; njërin duke i mbivlerësuar e shpeshherë edhe duke i mitizuar dijetarët që ata u përcaktuan për pasimin e tyre, dhe tjetrin; duke nënvlerësuar e margjinalizuar të tjerët që i konsideruan konkurrentë të figurave ikonike të tyre. Madje, ndjekësit mediokër shkuan edhe më larg se kaq. Trilluan virtyte e cilësi që më shumë ngjanin të ishin profetike për ata dijetarë që i deshën në njërën anë, dhe akuzuan e sajuan gënjeshtra të pa thëna, e mangësi diskredituese për ata që i urryen padrejtësisht, në anën tjetër. Kjo "normë e re" që promovohet si një standard i mirëqenë, na vije si produkt dhe pasojë e pritshme e një tendence relativizuese dhe nënvlerësuese ndaj imamëve muxhtehidë-themeluesve të shkollave juridike dhe atyre që erdhën pas tyre. U barabartësuan të pabarabartët dhe u përbuzë mizorisht principi i afërsisë kohore me Muhamedin a.s., të cilën afërsi e vendosi si kriter selektiv edhe vetë ai kur tha: "Brezi më i mirë është ai që unë po jetoj me ta, pastaj ai që vije pas tyre, e pastaj ai që vije pas tyre." (El Buhari, 6695). Imam Ebu Hanifeja (Zoti e pastë mëshiruar), me gjithë faktin se hynte te brezi i dytë i përshkruar si më i miri nga ky hadith, meqë ishte tabiin, prapë me modesti kur rrëfente ndonjë mendim të tij, deklaronte: "Ky është mendimi im më i mirë që unë mund ta nxirrja, e kushdo që sjellë ndonjë mendim më të mirë se ky, ne e pranojmë atë." (Ibën Abidin, 63/1). Ndërkaq, gjejmë sot të tillë që distancën kohore me shekujt-brezat më të mirë e kanë mijëvjeçarësh, ndonëse jo rrallë pretendojnë se janë më të denjë për t'u pasuar dhe pozita e tyre me imamët e hershëm duhet barabartësuar. Të bindur në pretendimet e tilla, ndjekësit miopë nxitimthi vendosën "dijetarin e preferuar" si peshojë matëse e barometër të së vërtetës, duke pandehur se e vërteta është vetëm ajo që përputhet me mendimet, metodologjinë, e doktrinën e atij që është në frekuencë të njëjtë me të, dhe se numri i atyre që e thanë atë gjatë gjithë historisë islame nuk guxon të tejkalojë atë të gishtërinjve të njërës dorë. Ky standard, në fakt përmbys si mos më keq konceptin universal të drejtësisë për të cilin Allahu thotë: "... *dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli (dikujt) e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë se ajo është më afër devotshmërisë. Kini dronë Allahun se Allahu di hollësisht atë që vepronі.*" (El Maide, 8).

Përtej zhurmave që mund të shpërndajnë konfuzion në kokën e atyre që keqlexojnë mësimet islame, epiteti i dijetarit, nuk duhet të burojë nga mbivlerësimi që fanatizmi i verbër ia ka atribuuar, por nga virtytshmëria, thellësia në dituri, dhe qëndrimet e tij parimore, të cilat rrëfejnë më së miri se "ai nuk ka frikën e askujt gjatë përpjekjes për ta ndriçuar rrugën e Zotit". Ky standard mund të mos jetë sot edhe ai më me renome, por kjo s'i bie që ai nuk është i vërteti.

Mr. Driton Arifi

Rëndësia e mbrojtjes së imazhit të Islamit

EFEKTI I POLARIZIMIT DHE PËRÇARJES SË MYSLIMANËVE NË FOKUS

Evzal Sinani

IMAZHI I NJË KOMUNITETI NË SYTË E TJETRIT

Njeriu është i krijuar si qenie sociale, ekzistenca dhe mirëqenia e së cilës është e lidhur ngushtë dhe në mënyrë thelbësore me tjetrin dhe interaksionin me të. Studimet e bëra me fëmijë të privuar nga kontakti social vërtetojnë se njeriu nuk mund të zhvillohet e të mbijetojë si qenie pa ndërveprim me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. Ai ngec në zhvillimin e personalitetit, vetëdijes dhe tipareve të tjera themelore të tij, karakteristika këto që mund të zhvillohen vetëm brenda organizmit social.[1] Së këndejmi, në bashkëjetesën me tjerët, njeriu gjen përmbushjen e vet dhe aktualizimin e tij si krijesë. Kjo e detyroi atë që të organizohet në grupe dhe komunitete në varësi të interesave dhe përkatësisë. Për të qenë sa më e suksesshme përmbushja dhe aktualizimi i tij si pjesëtar i grupit dhe për të siguruar bashkëpunim të shëndetshëm, duhet që perceptimi i pjesëtarëve të tjerë të grupit mbi të, të jetë sa më i mirë i mundshëm. Këtë perceptim të tjetrit mbi ne, qoftë individ apo grup, do ta quajmë imazh në këtë trajtesë.

Ruajtja e një imazhi të mirë siguron një nivel të besimit tek individi dhe ndjenjën e respektit të tjerëve ndaj tij. Ndërsa ruajtja e imazhit të komunitetit si tërësi ndikon në marrëdhëniet me komunitetet e tjera në nivel më të gjerë, në moslejimin e krijimit të kushteve për lindjen e paragjykimeve dhe stereotipizimit të gjithë grupit, nxitjen e bashkëpunimit dhe rritjen e nivelit të besimit karshi krijimit të dyshimit dhe marrëdhënieve të penguara.[2] Pra, kuptohet qartë se krijimi dhe mbrojtja e imazhit të mirë del të jetë thelbësore për mbijetesën e grupit, rritjen e mëtejshme të tij dhe arritjen e synimeve të përcaktuara. Është një mekanizëm social, që lehtëson ose pengon funksionimin harmonik të marrëdhënieve dhe organizimit shoqëror.[3]

IMAZHI I MYSLIMANËVE NË FOKUS

Orientalizmi si shkencë nuk shihet me sy të mirë në qarqet shkencore sot, ngaqë bazohej mbi parimin "unë dhe tjetri", duke e karakterizuar popullatën e orientit si tjetri inferior. Botëkuptim ky që do zhvillonte bazën dhe mbështetjen ideologjike të sundimit dhe imponimit të kolonializmit mbi botën lindore që tanimë, me arsyetime "shkencore" llogaritej e paaftë për të sunduar veten në një formë të

> *"Të gjithë të vlerësojnë për atë që dukesh. Pak e kuptojnë se çfarë jeni."*
>
> (Makiaveli)

civilizuar, ani pse civilizimi rridhte nga këto vende dhe civilizimet më të mëdha që ekzistuan ndonjëherë ishin atje. Pra, ishte një ide e përdorur për qëllime politike, e bazuar mbi shpërfytyrimin e imazhit të atij që duhet të sundohej dhe të eksploatohej. Megjithatë përgjatë gjithë historisë së njerëzimit, gjithë tiranët dhe superfuqitë janë munduar t'i arsyetojnë ligësitë e tyre. Faraoni, për shembull, arsyetonte harbutërinë e tij për gjak karshi të bijve të Israilit me pretendimin se udhëheqësi i tyre do përhapte çrregullimin në tokë dhe do të ndryshonte fenë e bekuar të tyre që garantonte paqen dhe mirëqenien, edhe pse kjo paqe nënkuptonte vazhdimin e robërisë së të sunduarit. Në këtë formë veproi edhe Hitleri, dhe shumë tiranë të tjerë të kohës sonë. Në arritjen e këtij qëllimi përdoren mekanizma të ndryshëm, të veshur shpeshherë edhe me petkun e fesë. Në betejat e përgjakshme të historisë për të zbuluar të mirin dhe të keqin, është e gjallë lufta për të arsyetuar veten duke fajësuar tjetrin. Nëse i analizojmë shembujt e përmendur më herët, vërejmë tendencën për të përmirësuar imazhin personal duke shpërfytyruar imazhin e tjetrit, që jep të kuptojmë se më shumë se sa prishjen e imazhit të viktimës, shtypësi ka nevojë për përmirësimin e imazhit të vet. Përdorimi i magjistarëve, orientalizmit dhe sot mediave, përfaqësojnë mekanizmat klasikë të sulmit ndaj imazhit të myslimanëve. Investimi në paraqitjen e myslimanëve në mediume si të dhunshëm, fakt ky i vërtetuar nga shumë studime, dhe krijimi i stereotipit në mendjet e masave jomyslimane, është bërë me të vetmin synim që vrasjet e myslimanëve në vetëdijen e masave të tjera të mos shihet si krim i barabartë me vrasjen e një myslimani, fakt ky, që duhet reflektuar mbi të dhe pasojat afatgjata të neglizhimit të tij.

Krijimi dhe mbrojtja e imazhit të mirë del të jetë thelbësore për mbijetesën e grupit, rritjen e mëtejshme të tij dhe arritjen e synimeve të përcaktuara.

NEVOJA E ARSYETIMIT DHE RËNDËSIA E PRISHJES SË IMAZHIT TË TJETRIT

Është e rëndësishme të kuptohet se përpjekja që me çdo kusht të arrihet përcaktimi si i mirë nga tjerët, në shumicën e rasteve, nuk bëhet për hir të shenjtërisë dhe vlerësimit të lartë që e mira zë në zemrën e individit. Në rastin e udhëheqësve dhe luftërave në mes komuniteteve, shpeshherë bëhet për qëllime mjaft tokësore dhe politike. Në këto raste, thënia e Makiavelit: "Të gjithë të vlerësojnë për atë që dukesh, pak e kuptojnë se çfarë jeni", është plotësisht e përshtatshme. Legjitimiteti i pushtetit, kontrolli i narratives dhe manipulimi i opinionit publik, mbrojtja nga përgjegjësia morale, përfitimi politik dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i komfort zone ku do jenë të mbrojtur nga kritikat dhe telashet, përfaqësojnë arsyet kryesore përse është i rëndësishëm imazhi i mirë i një komuniteti dhe udhëheqësve të tij. Në të gjitha këto raste, arsyetimi i suksesshëm bëhet duke denigruar imazhin e tjetrit, pra, me mbajtjen gjallë të "orientalizmës" në narrativë, ku ne jemi të mirët, ngaqë tjetri është i keqi dhe tentativa për t'i paraqitur të gjitha veprimet çnjerëzore si thjesht reaksione ndaj një aksioni.

MYSLIMANI DHE RUAJTJA E UNITETIT

Përcillet se Muhamedi a.s., duke qenë në shtëpinë e tij u thirr nga dikush që të shkonte shpejt në treg, ngase disa ensarë, nga fisi Evs dhe Hazrexh, që po qëndronin së bashku në një vend afër tregut të Medinës (skenë kjo që prishi rehatinë e hebreut Shas bin Kajs dhe e bëri atë të dërgonte një të ri që të recitonte para tyre poezitë e betejës së famshme civile të Buathit, për të ringjallur armiqësitë e vjetra dhe për të gërryer plagën e njomë që sapo kishte filluar të shërohet), ishin grindur dhe me nxjerrjen e hasmërive shekullore përsëri në skenë, ishin marrë vesh që përsëri të ballafaqohen e të luftojnë. Nga frika e eskalimit të situatës dhe duke e kuptuar seriozitetin e rastit, Muhamedi a.s. doli duke vrapuar dhe i thërriste: "A edhe duke qenë unë në mesin tuaj?"[4], këtë e përsëriti disa herë me qëllim që t'i kthente në arsye e t'ua rikujtonte se nuk guxojnë asnjëherë të përçahen më, aq më pak duke e pasur atë në mesin e tyre. "Ngatërresa të kohës së paganizmit, të ktheheni prapa, pasi ju ka udhëzuar Allahu në Islam e ju ka nderuar me të?! Pasi që ju bashkoi si myslimanë, të ktheheni prapa në gjendjen në të cilën ishit si jomyslimanë?!"[5] Ensarët u kthyen në arsye menjëherë dhe e kuptuan pasojën e mungesës së kthjelltësisë për një çast të vetëm. Masat e gjera të popullatës do të jenë gjithmonë

ndjekës të elitave, të udhëheqësve që krijojnë mendësinë dhe orientojnë veprimin e popullatës. Ka studiues që thonë se për të pasur një ringritje të ymetit duhet të edukohet në bartjen e idealit 2.5 deri 3 përqindëshi i pjesëtarëve të ymetit dhe se aktualisht kemi arritur deri në 1.5 përqind. Padyshim se edukimi i mirëfilltë i kësaj përqindjeje zgjat një periudhë relativisht të gjatë dhe për myslimanët e përvuajtur të kohës sonë është në shekullin e dytë, periudhë kjo që në analet e historisë njerëzore dhe historisë së civilizimeve nuk është e gjatë. Është i pamohueshëm fakti se elitat e shoqërive myslimane të kohës sonë, në masë të madhe, kanë ngecur në atë mungesën e kthjelltësisë që i kaploi edhe ensarët. Por, për dallim nga ata, që u kthyen në arsye pas një periudhe të shkurtër, kllapia jonë vazhdon me shekuj. Neglizhimi i pasojave të mendimeve të polarizuara, verbëria karshi rezultatit final të mendimeve të sakta, retorika përjashtuese dhe inati agresiv në mbrojtjen e së vërtetës dhe nevoja për përhapjen e tij, pavarësisht pasojave dhe me çdo kusht, të bën të mendosh se ke të bësh me një elitë që doemos të kategorizohet o si naive, e paaftë për të parë pasojat e veprimeve të veta, apo një elitë e korruptuar për interesa të ngushta individuale ose të grupeve të vogla që zbaton agjenda të elitave reale që dirigjojnë të menduarit dhe veprimin e tyre. Sido të jetë, realiteti faktik i myslimanëve në terren, është dëshpërues. Një arenë e madhe e mendimeve të polarizuara, me thirrës që pretendojnë se e kanë gjetur të vërtetën absolute dhe se çdo mendim tjetër, nuk është thjesht i gabuar, është devijues dhe jo që vetëm nuk duhet pranuar, por duhet refuzuar, madje edhe luftuar. Një arenë ku çdokush sulmon çdokënd dhe nuk pranon askënd tjetër pos llojit të vet.

Masat e gjera të popullatës do të jenë gjithmonë ndjekës të elitave, të udhëheqësve që krijojnë mendësinë dhe orientojnë veprimin e popullatës.

ÇFARË I PËRÇAN MYSLIMANËT?

Nuk gjendet dot një mendimtar, hoxhë, teolog, sheh, apo dijetar që nuk e di se dobia e zbatimit të ndryshimeve në çështje që nuk janë bazike sipas mësimeve islame, është më e vogël se sa dëmi që sjell përçarja që vjen nga imponimi i tyre dhe mungesa e gatishmërisë për ta pranuar mendimin ndryshe. Myslimanët sot duhet të edukohen në atë mënyrë që më shumë se sa informacion, t'u jepet metodologji nëpërmjet të cilës do të dinë të forcojnë ymetin dhe të kthjellohen intelektualisht. Sasia e informacionit që disponojnë sot masat është shumë e madhe, por kjo nuk i ka bërë më të mençur, sepse nuk dinë çfarë të bëjnë me të, si rasti i një fëmije të cilit i jepet pasuri e madhe të cilën ai, me shumë gjasë, do ta shpërdorojë për shkak të mungesës së aftësisë së menaxhimit.

Pra, meqë përçarja e myslimanëve nuk qenka për çështje themelore të të besuarit, bëhet e qartë se myslimanët nuk i përçaka dallimi rrënjësor në të menduar, por i përçaka vetë “myslimani”, andaj kërkohet, më shumë se kurrë, kthjelltësi dhe lexim i realitetit. Të kuptojmë se në mullirin e kujt shkon uji i përçarjes sonë, të shohim kush përfiton kur ne zihemi, kush është i lumtur kur ne jemi të hidhëruar dhe kjo do japë mesazhin e qartë dhe trokitjen që do na zgjojë nga kllapia, e do ta bëjë Muhamedin a.s. dhe mësimet e tija ende prezente në mesin tonë, siç ishte për ensarët.

PËRSE PËRÇAHEN MYSLIMANËT?

Si pasojë e mungesës së kthjelltësisë kolektive, myslimanët përçahen ngase (Shas bin Kajsat) janë bërë aq të sofistikuar saqë është bërë shumë e vështirë t'i identifikosh strategjitë e tyre, por jo e pamundshme. Si pjesë e këtyre agjendave, myslimanët duhet të jenë vazhdimisht të ngarkuar me veten dhe për këtë qëllim financohen dhe stimulohen mendimtarë nga vetë gjiri i shoqërisë myslimanë që do të nxjerrin ide të pakuptimta dhe të paprecedentë, që do mbizotërojnë hapësirën e debateve sociale dhe shkencore të shoqërisë, për të pamundësuar marrjen me qëllimin e vërtetë të Islamit dhe myslimanëve. Prandaj, bartësit e këtyre ideve të shthurura, nëpërmjet instrumentalizimit të hapësirës mediatike, konsiderohen si mendjendritur, që duan të përparojnë vetë Islamin dhe të emancipojnë vetë myslimanët! Të qenit të vetëdijshëm për këtë realitet, do shkrijë një numër të madh të arsyeve që na bëjnë të mos pranojmë tjetrin.

A ËSHTË MENDIMI NDRYSHE BURIM I PËRÇARJES?

Nëse i analizojmë mendimet prezente, që llogariten sot shkak i përçarjeve mes myslimanëve, vërejmë lehtë se shumica e tyre kanë qenë prezentë përgjatë gjithë historisë së myslimanëve, edhe në kohët kur shoqëritë myslimane lulëzonin në bashkëjetesë. Kjo jep të kuptojmë se të menduarit ndryshe, një divergjencë e krijuar dhe e afirmuar nga Vetë Allahu xh.sh. në Kuran, nuk është detyrimisht shkak i përçarjes, por shkak i saj është paaftësia e të pranuarit të mendimit ndryshe, mungesa e zemërgjerësisë së pranimit të tjetrit edhe nëse mendojmë ndryshe nga ai dhe mungesa e gatishmërisë për tolerancë, krahas politikave të mëdha shtetërore që e ushqejnë ndarjen për qëllime të elitave të korruptuara politike.

Dobia e zbatimit të ndryshimeve në çështje që nuk janë bazike sipas mësimeve islame, është më e vogël se sa dëmi që sjell përçarja që vjen nga imponimi i tyre dhe mungesa e gatishmërisë për ta pranuar mendimin ndryshe.

VUAJTJET E MYSLIMANËVE NGA JOMYSLIMANËT SI PASOJË E PËRÇARJEVE MES MYSLIMANËVE

Pasojat e përçarjes nuk kanalizohen vetëm brenda vetë komunitetit, por gati se gjithmonë, thyejnë barrierat kufitare për të arritur deri te perceptimi që komunitetet e tjera kanë për një komunitet. Në rastin e Islamit, përçarjet që kanë ardhur si pasojë e polarizimit të mendimeve dhe shtimit të fanatizmit ideor nga vetë thirrësit e çlirimit nga fanatizmat, kanë përshpejtuar arritjen e rezultateve të armiqve që tentojnë të shpërfytyrojnë imazhin e myslimanit te jomyslimanët. Thënë ndryshe, me skenat e mungesës së tolerancës nga myslimanët, është ofruar argument për të gjitha tezat e shtruara nga krijuesit e stereotipave për komunitetin mysliman dhe lexuesi i thjeshtë, pa pasur as motiv as formë të lehtë të verifikimit të informacionit, e ka pranuar, mbase edhe pa vetëdije, këtë stigmatizim. Kjo mund të duket thjesht teori, por përkthimi i kësaj është mjaft i dhimbshëm.

Mbetet e pakontestueshme, se pa prezencën e imazhit të shtrembëruar të Islamit dhe myslimanëve, nuk do të ishte prezent gjithë ky guxim në ndërmarrjen e gjithë atyre veprimeve. Konfliktet e brendshme perceptohen nga të tjerët si shenjë dobësie, përçarjet thellojnë edhe më shumë ndarjet dhe kjo ndikon në krijimin e barrierave për bashkëpunim social dhe ekonomik.

E gjitha kjo na bën të kuptojmë rëndësinë dhe theksin e veçantë që Islami i kushton bashkimit dhe unitetit mes anëtarëve të ymetit, duke i llogaritur si një trup i vetëm, si dhëmbët e një krehri, vëllezër, ngaqë është e lidhur ngushtë jo vetëm me funksionimin tonë si tërësi, por edhe me parimet dhe kufijtë që ua vendosim të tjerëve në raportet me ne. Një zinxhir i veprimeve dhe pasojave që reflektojnë mrekullisht, ngaqë burojnë janë nga Krijuesi i njeriut dhe e bëjnë të qartë nevojën për nënshtrim dhe bindje ndaj urdhrave të Tij, për zbatim të rolit të ndërtuesit që kemi në këtë jetë dhe arritjen e suksesit, jo vetëm si individ, por si komunitet, si ymet.

---

1 Hossain, F. M. Anayet, dhe Md. Korban Ali. "Relation between Individual and Society." **Open Journal of Social Sciences**, 2, nr. 8 (2014): aksesueshëm në 27 gusht 2014. DOI: 10.4236/jss.2014.28019. Disponueshëm në: https://www.scrip.org/pdf/JSS 201482714583000.pdf

2 Sun, Binghai, et al. "The Effect of Social Perspective-Taking on Interpersonal Trust Under the Cooperative and Competitive Contexts: The Mediating Role of Benevolence." **Psychology Research and Behavior Management 14** (2021): 817-826./*

3 Suzuki, Shinsuke, dhe Eizo Akiyama. "Reputation and the evolution of cooperation in sizable groups." **Proceedings of the Royal Society B 272** (2005): 1373-1377.

4 Muhammed Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari.* (Damask, Ibën Kethir Publishing, 1993), v. 6, f. 2623.

5 El Mubarekfuri, Safi el Rahman. **Es Sireh en Nebeuijjeh (Er Reḥik el Mekhtum)**. Redaktuar nga Dr. Alaa al Din Mahmoud Zaatari dhe Ghassan Muhammad Rashid al Hamwi. Damask, Siri: Dar el'Isma, 2007, f.170.

Pejgamberi i udhëzimit dhe i dritës për të gjithë njerëzimin

Mimoza Sinani

Ditën që lindi Muhamedi a.s., e gjithë bota u mbush me dritë, udhëzim dhe dituri, sepse atë ditë lindi Pejgamberi i udhëzimit dhe i dritës për të gjithë njerëzimin. Melaqet nxituan në turmë për ta përshëndetur dhe horizonti u mbush me shenja gëzimi për ardhjen e tij.

Lindja e tij u bekua me Nderimin Hyjnor dhe u mbikëqyr nga Profania e Shenjtë. Pas lindjes së tij a.s., Allahu xh.sh. shfaqi shumë çudira dhe mrekulli, si paralajmërim për pejgamberinë e tij, si një shenjë për rangun e tij të jashtëzakonshëm dhe si një tregues se ai a.s., mbante një status të lartësuar.

Një manifestim i kësaj ishte drita që shkëlqeu në momentin e lindjes së tij a.s., një dritë që ndriçoi pallatet e Lindjes së Afërme. Shfaqja e kësaj drite në momentin e lindjes së tij a.s. ishte një shenjë e asaj që do të vinte më vonë; drita që do të udhëhiqte botën dhe do t'i jepte fund errësirës së mosbesimit, drita e madhështisë së tij që do të ndriçonte horizontin e jetës njerëzore.

Allahu e zgjodhi Muhamedin a.s. prej fiseve më të ndershme dhe familjeve më të mira. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Xhibrili **më tha:** "E kontrollova tokën nga Lindja në Perëndim dhe nuk gjeta njeri më të mirë sesa Muhamedi a.s.; dhe e kontrollova tokën nga Lindja në Perëndim dhe nuk gjeta farefis më të mirë sesa bijtë e Hashimit."[1]

Po ashtu ai a.s. ka thënë: "Unë jam Muhamedi, i biri i Abdullahut, i biri i Abdul Muttalibit. Allahu i krijoi të gjitha krijesat dhe më nxori nga krijesat më të mira të Tij; Ai i bëri ato në dy degë dhe më bëri mua nga dega më e mirë; Ai i krijoi fiset dhe më nxori mua nga fisi më i mir**ë**. Unë kam dalë nga lidhjet e martesës dhe jo nga lidhjet e jashtëligjshme, që nga Ademi e deri te babai dhe nëna ime. Unë jam më i miri nga ju si person dhe më i miri nga ju për nga prejardhja."[2]

Lindja e Muhamedit a.s. solli dritë dhe udhëzim për njerëzimin, si shenjë e misionit hyjnor që do të ndriçonte jetën dhe do t'i jepte fund errësirës së mosbesimit.

Kjo krijesë, më e pastra dhe më fisnikja e qenieve njerëzore, shpalosi cilësi të veçanta qysh në fëmijërinë e njomë. Ai ishte një krijesë, substanca e të cilit ishte e pastër dhe i lirë prej të gjitha të metave, i panjollosur prej të gjitha mospërkryerjeve.

Jeta e tij para pranimit të Shpalljes ishte pjesë integrale e këtij shembulli apo modeli. Ajo zë një vend të rëndësishëm në biografinë e Muhamedit a.s., ngase ishte fazë e përgatitjes dhe e ushtrimit për pranimin e Mesazhit Hyjnor. Ai a.s. u rrit në strehën, mbrojtjen dhe kujdesin e Allahut xh.sh., i cili i dha atij edukimin më të mirë, kjo sepse një ditë do ta nderonte dhe do ta lartësonte rangun e tij në atë të një Pejgamberi.

Formimin dhe edukimin e Muhamedit a.s. e kishte marrë përsipër Allahu i Lartmadhëruar. Jeta e tij ishte vazhdimisht nën mbikëqyrjen hyjnore.

Po të hedhim vështrimin mbi karakterin e Pejgamberit të zgjedhur a.s., do të shohim bukurinë e shkëlqyer; po ta hapim zemrën për të fshehtat e atributeve të tij, do të shohim pranverën e jetës në lulëzim; po ta zhytim shpirtin në dritën e përkujtimit të tij, ai a.s., do të bëhet për ne një i dashur dhe ndërmjetësues; po t'ia kushtojmë atij gjithçka tonën, gjoksi ynë do mbushet me besim dhe cilësi fisnike, zemra jonë do të fitojë jetë nëpërmjet tij, shpirti ynë do të gjejë paqe nëpërmjet tij dhe zemra jonë do të gjejë qetësi nëpërmjet tij.

Muhamedi a.s. ishte shembulli më i përsosur i bukurisë dhe fisnikërisë, me fytyrë ndriçuese dhe aromë më të këndshme se misku.

MUHAMEDI A.S. ISHTE MISHËRIM I BUKURISË DHE I MADHËSHTISË

Allahu xh.sh. e krijoi zotërinë tonë Muhamedin a.s. në më të bukurën prej shëmbëlltyrave njerëzore dhe në më të përsosurën prej formave ademike. Muhamedi a.s. ishte mishërim i bukurisë, i madhështisë, i mirësisë dhe i përsosmërisë fizike dhe morale. Ai kishte pamjen më të bukur dhe më të ndritshme njerëzore, në saje të hirit hyjnor dhe dhuntisë qiellore. Bukuria e tij i frymëzoi objektet e pajeta të flasin dhe trungu i palmës qau për shkak të dashurisë ndaj tij.

Të gjithë që e kanë parë atë janë pajtuar se nuk kanë parë kurrë ndokënd si ai. Ata që e kanë përshkruar të Dërguarin e Allahut a.s. pajtohen se fytyra e tij ishte e ndritshme dhe rrëzëlluese dhe ndriçonte me dritë të shkëlqyeshme. Disa prej tyre e krahasonin shndritjen e dritës së tij me Diellin, të tjerët me Hënën. E gjithë kjo na konfirmon rrëzëllimin e qartë të fytyrës së tij dhe shkëlqimin e tij verbues..

Një tjetër prej cilësive të tij, ishte se ai kishte aromë të këndshme, madje edhe pa përdorur parfum, megjithatë ai e përdorte shpesh parfumin. Një nga dëshmitë për aromën e këndshme të tij, është hadithi që transmetohet nga Muslimi sipas Enesit r.a., i cili ka thënë: "I Dërguari i Allahut a.s. ishte rrezatues në fytyrë dhe sumbullat e djersës së tij ishin si perla. Unë kurrë nuk kam prekur ndonjë brokadë apo mëndafsh më të butë se pëllëmba e të Dërguarit të Allahut a.s., as nuk kam ndier erë misku ose erë tjetër më të këndshme se aroma e të Dërguarit të Allahut a.s.."[3]

SHEMBULL I PËRKRYER I QENIES NJERËZORE

Zhvillimet në jetën e tij ishin të programuara nga Krijuesi i botëve. Përkrahja hyjnore i kishte dhuruar aftësinë për t'i duruar vështirësitë, pasi ai ishte caktuar që të bëhej pejgamberi i mbarë njerëzimit. Ato ishin sprova për kalitjen e tij, në mënyrë që ai të

Çdokush prej nesh duhet ta marrë si model përsosmërinë e karakteristikave të tij në mënyrë që shpirti ynë të kënaqet dhe t'i kërkojë Allahut ndriçim dhe udhëzim.

zotëronte një vullnet të çeliktë që të mund të barte mbi supet e tij barrën e rëndë të Mesazhit Hyjnor.

Kur ishte i ri, gjoksi i tij fisnik u hap dhe zemra e tij a.s. u pastrua dhe u shenjtërua, kështu që ai nuk do të joshej kurrë nga ndonjë prej gjërave që i njollosin njerëzit. Për këtë arsye, zemra e tij a.s. ishte më e mrekullueshmja e zemrave, më e pastra, më e devotshmja, më e virtytshmja, më e dhembshura, më fisnikja dhe më e fuqishmja e zemrave. Urtësia e kësaj hapjeje ishte përgatitja për momentin kur ai do të qëndronte përpara Allahut xh.sh. dhe do të bënte një bisedë të afërt me Të dhe do të ishte dëshmitar i dritave të shkëlqyeshme, i sekreteve të privilegjuara dhe i teofanisë së bukurisë dhe të madhështisë.

Hapja e gjoksit dhe nxjerrja e zemrës dhe të gjitha ngjarjet e tjera të jashtëzakonshme duhen të pranohen pa asnjë përpjekje për t'i larguar ato nga realiteti i mirëfilltë, sepse pushteti i gjithëfuqishëm i Allahut është në gjendje që t'i kryejë të gjitha këto.

Kështu ai a.s. u bë njeri madhështor dhe i virtytshëm, më fisniku i popullit të tij, më i edukuari, më i respektuari, më i dashuri, më i duruari, më i sinqerti, më i besueshmi, më dashamirësi dhe më dinjitozi. Gjatë gjithë kësaj periudhe, ai shpalosi pastërti karakteri, ndjenjë ndershmërie dhe besueshmërie. Populli i tij e quante atë a.s.: "Më i ndershmi dhe më i besueshmi" (*El Sadik el Emin*).

Populli e njihte prejardhjen e tij fisnike, prejardhje e cila sugjeronte drejtësi, ndershmëri dhe besim qysh shumë kohë para se t'i vinte detyra profetike, prandaj edhe e vlerësonte atë. Ai fitoi prestigj si anëtar i shquar i shoqërisë mekase, që respektohej si për aftësinë, ashtu edhe për ndjenjën e ndershmërisë dhe të drejtësisë.

Martesa me Hatixhen ishte e një rëndësie të madhe për të, sepse ajo i siguroi atij shoqëruesen tek e cila do të mbështetej plotësisht në periudhën më të vështirë të jetës së tij dhe e cila ishte pajisur me dhuntitë dhe virtytet e nevojshme morale e shpirtërore për të luajtur rolin e gruas së përsosur të krijesës më të përkryer të Zotit.

Allahu e ka lavdëruar të dashurin e Tij, Zotërinë tonë Muhamed a.s., për shkak të shkallës së lartë të moralit të tij, të sjelljes së tij të përsosur dhe të mirësisë së tij në të gjitha shkrimet e tjera hyjnore, në Tevrat, në Ungjill dhe në Kuranin fisnik. "*Vërtet ti je në një shkallë të lartë morali!*" (El Kalem, 4).

Ai ishte shembulli i përkryer i qenies njerëzore, që gjeneroi energji të re dhe një forcë jetësore të pashtershme për njerëzimin. Rrezet e dritave të tij shkëlqyese ndriçuan në zemrat e pasuesve të tij. Shembulli i tij është një burim diturie dhe një thesar pastërtie, një dritë udhëzuese për të gjithë ata që banojnë në tokë dhe në qiej.

Çdokush prej nesh duhet ta marrë si model përsosmërinë e karakteristikave të tij në mënyrë që shpirti ynë të kënaqet dhe t'i kërkojë Allahut ndriçim dhe udhëzim.

I lutemi Allahut të jemi prej atyre që qëndrojnë në hijen e freskët të pemës pejgamberike, që ndriçohen nga dritat e së vërtetës pejgamberike, që zhyten në oqeanin e dashurisë pejgamberike dhe që shijojnë frutat e pemës pejgamberike, në mënyrë që shpirtrat tanë të mbarten në banesën e gëzimit, të ngazëllehen në bukurinë e përsosur dhe të thithin aromën e xheneteve të Zotit Bujar.

---

1 Është transmetuar nga El Bejhekiu, El Hakimi, El Taberaniu dhe Ibën Asakiri. Shami ka thënë: "Hafidhi ka deklaruar në *Emali*-n e tij se ky tekst mbart të gjitha veçoritë e autenticitetit." (*Sireh*, vëll. 1, f. 276)

2 Është transmetuar nga Imam Ahmedi.

3 Për më gjerësisht shih librin "*Our Master Muhammad - The Messenger of Allah & His Sublime Character & Exalted Attributes*" të autorit Abdullah Siraxhuddin el Husejni.



Pejgamberi a.s., model i përkryer i jetës bashkëshortore dhe familjare (2)

Prof. ass. dr. Ilmije Kuqi

Pejgamberi a.s. nuk e ndalonte familjen e tij prej gjërave të cilat Zoti i Plotfuqishëm i ka lejuar. Përkundrazi, ai inkurajonte argëtimin dhe aktivitetet që sillnin gëzim dhe hare në familje.

MËSHIRA E PEJGAMBERIT A.S. NDAJ BASHKËSHORTEVE

Pejgamberi a.s. shfaqte një kujdes të veçantë ndaj bashkëshorteve të tij, veçanërisht kur ato ishin të pikëlluara apo të sëmura. Kjo mund të shihet në rastin e nënës së besimtarëve, Aishes r.a., kur asaj ju paraqit cikli gjersa po kryente haxhin, ajo u pikëllua dhe filloi të qante. Pejgamberi a.s. kur hyri tek ajo dhe e pa duke qarë, e pyeti: "Çfarë ke? A të është paraqitur cikli?" Ajo u përgjigj: "Po." Ai tha: "Kjo është diçka që Zoti e ka caktuar për bijat e Ademit. Bëj çdo gjë që bën haxhiu, përveç tavafit rreth Qabesë."[1]

Ky veprim i Pejgamberit a.s. është shembull i qartë i dhembshurisë dhe mirëkuptimit për gjendjen fizike dhe emocionale të gruas. Ai nuk e qortoi për ndjenjat e saj, por përkundrazi e qetësoi, ia sqaroi me butësi dhe e ndihmoi të përmbushë adhurimin e saj në mënyrën më të mirë.

Ndër gjërat të cilat burrat duhet t'i kenë në konsideratë ndaj bashkëshorteve të tyre, është mirëkuptimi për ndryshimet që ato përjetojnë në sjellje dhe gjendje shpirtërore, si pasojë e ciklit, lindjes dhe lehonisë. Këto janë periudha në të cilat gruan e shoqëron lodhja, shqetësimi dhe dhimbjet fizike dhe emocionale.

Kur bashkëshortet e tij sëmureshin, Pejgamberi a.s. lutej për to dhe i përshkonte me dorën e tij. Nga Aisheja r.a., transmetohet se kur ndonjëra prej grave të Pejgamberit a.s. sëmurej, ai i lexonte diç dhe e përshkonte me dorën e djathtë duke thënë: "O Zot, Zot i njerëzimit, largoja sëmundjen, shëroje atë, sepse Ti je Shëruesi. Nuk ka shërim tjetër përveç shërimit Tënd, jepja një shërim që nuk lë pas sëmundje."[2] Kur një burrë ndien

dhimbjen e gruas së tij dhe tregohet i kujdesshëm ndaj saj, kjo do të ketë një ndikim të madh në shpirtin e gruas, edhe pse dhimbja nuk zhduket ose sëmundja mbetet. Ajo e ndien se ai e kupton atë dhe kjo ndjesi është më e vlefshme për gruan sesa vetë ilaçi.

Një shembull tjetër i dhembshurisë së tij është rasti i nënës së besimtareve, Safije bint Hujej-it r.a.. Kur deveja e saj u sëmurë gjatë rrugës për në haxh, edhe pse ishte një nga devetë më të mira për hipje, ajo u pikëllua dhe filloi të qajë. Kur i Dërguari i Allahut a.s. u informua për këtë, ai erdhi dhe filloi t'ia fshinte lotët me dorën e tij.[3] Fshirja e lotëve nga burri është një gjest i thellë ngushëllimi dhe tregon vlerësim për ndjenjat dhe emocionet e gruas. Prandaj, ky gjest i Pejgamberit a.s. është model i përkryer për çdo bashkëshort që dëshiron të ndërtojë një marrëdhënie të mbështetur në dashuri, respekt dhe dhembshuri të ndërsjellë.[4]

Ky është një shembull i mëshirës, ndjeshmërisë dhe kujdesit të Pejgamberit a.s. për ndjenjat e bashkëshortes së tij, edhe për gjëra, që ndoshta të tjerët do t'i konsideronin të vogla ose të parëndësishme.

Gjatë udhëtimeve, i Dërguari i Allahut a.s. tregonte kujdes të veçantë për gratë që e shoqëronin. Ai kalonte kohë me to, shkëmbente biseda me to natën dhe u kushtonte vëmendje të veçantë nevojave të tyre.

DASHURIA DHE ARGËTIMI NË JETËN FAMILJARE TË PEJGAMBERIT A.S.

Pejgamberi a.s. nuk e ndalonte familjen e tij prej gjërave të cilat Zoti i Plotfuqishëm i ka lejuar. Përkundrazi, ai inkurajonte argëtimin dhe aktivitetet që sillnin gëzim dhe hare në familje. Autoriteti i tij nuk e pengoi të garonte me gruan e tij, Aishen r.a., edhe pse atëkohë ai ishte i Dërguari i Zotit për mbarë njerëzimin dhe zotëria i njerëzimit.

Aisheja r.a., tregon duke thënë: "I Dërguari i Allahut a.s. ishte ulur, ndërkohë dëgjuam një zhurmë dhe disa zëra fëmijësh. I Dërguari i Allahut a.s. u ngrit në këmbë dhe vërejti abisinasit duke luajtur me shtizat e tyre. Me këtë rast, ai tha: "Oj Aishe, eja dhe shiko!" Unë shkova dhe e vura mjekrën time mbi shpatullën e të Dërguarit të Allahut a.s. dhe vazhdova të shikoja përmes hapësirës mes shpatullës dhe kokës së tij. Pastaj, ai më tha: "A nuk u ngope? A nuk u ngope?" Vazhdova të thosha: "Jo", për të parë vlerën time tek ai".[5]

Kjo ngjarje tregon moralin e lartë të Pejgamberit a.s. dhe sjelljen e tij të bukur ndaj familjes së tij.[6]

Në lidhje me këtë hadith, Ibën Bettali ka thënë: "Në këtë hadith tregohet morali i mirë i Pejgamberit a.s., dhe se si duhet të jetë sjellja e një njeriu me familjen e tij, duke u dhënë përparësi dëshirave dhe gëzimeve të tyre, në ato gjëra ku nuk ka ndalim (fetar) për ta.[7]

Pejgamberi a.s. na ka lënë shembuj të shumtë të mirësjelljes së tij të lartë në marrëdhëniet e tij me gratë e tij. Ai bënte shaka me disa prej tyre, luante me disa prej tyre dhe qeshte me disa prej tyre. Prej këtyre rasteve është edhe hadithi i njohur i garës ndërmjet Pejgamberit a.s. dhe zonjën Aishe r.a., në të cilin ajo thotë: "Dola me Pejgamberin a.s. në një nga udhëtimet e tij. Isha e re, e hollë dhe nuk kisha shtuar peshë. Ai u tha njerëzve: "Ecni përpara." Kështu ata vazhduan. Pastaj ai më tha: "Eja të garojmë!" Garova me të dhe e fitova garën, e ai heshti. Kur shtova në peshë dhe harrova (garën e mëparshme), dola me të në një nga udhëtimet e tij. Ai u tha njerëzve: "Ecni përpara", dhe ata vazhduan. Pastaj më tha: "Eja të garojmë!" Garova me të dhe ai më mundi. Ai filloi të qeshte, dhe tha: "Kjo është për atë."[8]

Hadithi përmban disa pika të denja për meditim. Ndër to është se ai zgjodhi bashkëshorten e tij mes gjithë shokëve për ta ushtruar këtë lloj loje, edhe pse numri i shokëve të tij nuk ishte i vogël, pasi kjo ndodhi pas kthimit të tij nga Beteja e Benu el Mustalik. Pastaj, ai deshi që ky moment familjar argëtues të plotësohej me përgatitjen e vendit, kur u tha sahabëve r.a.: "Ecni përpara", për t'i dhënë më shumë liri në argëtimin e lejuar gruas së tij, zonjës Aishe r.a..[9]

Gjatë udhëtimeve, i Dërguari i Allahut a.s. tregonte kujdes të veçantë për gratë që e shoqëronin. Ai kalonte kohë me to, shkëmbente biseda me to natën dhe u kushtonte vëmendje të veçantë nevojave të tyre. Aisheja r.a. tregon: "Kur ishte nata, i Dërguari i Allahut a.s., ecte me të dhe bisedonte me të."[10]

Një shembull i bukur i përkujdesjes së tij për gratë gjatë udhëtimit është këshilla që i dha Enxheshes, ngasësit të deveve, duke i thënë të ngasë më ngadalë, për hir të grave. Nga Enes ibën Maliku r.a., transmetohet se: "I Dërguari i Allahut a.s. ishte në një nga udhëtimet e tij dhe i tha Enxheshes – që këndonte për t'i nxitur devetë të ecnin më shpejt: "O Enxheshe, ngadalëso ngasjen (e deveve). Kujdes ndaj gotave të qelqta!"[11]

Një metaforë e bukur që i krahasonte gratë me enët delikate të qelqit, që kërkojnë kujdes dhe trajtim të veçantë. Gratë janë quajtur "gota të qelqta" për shkak të ndjeshmërisë së tyre, duke u krahasuar me enët prej qelqi, të cilat thyhen shpejt dhe lehtë.

Qëllimi i Pejgamberit a.s. ishte të ecej me butësi dhe ngadalë, sepse devetë, kur dëgjojnë këndimin, fillojnë të ecin më shpejt dhe e shijojnë këtë gjë, por kjo e shqetëson dhe e lodh udhëtarin. Prandaj, ai e ndaloi atë ta bënte këtë, sepse gratë dobësohen kur lëvizin shumë dhe ekziston frika se mos dëmtohen ose bien.[12]

A ka krahasim më të bukur e me të thellë që mund të bëhet se sa ky? Të gjithë e dinë se qelqi kërkon kujdes dhe trajtim të veçantë. Nëse qelqi gërvishtet ose dëmtohet, ai humbë shkëlqimin e tij, dhe nëse thyhet, nuk mund të kthehet më siç ka qenë më parë.

Kjo është gjendja e bashkëshortes, e cila kërkon një trajtim të veçantë njësoj si më një shishe të qelqtë. Sjellje e butë me të, duke shmangur shikimet dhe gjuhët që mund ta gërvishtin bukurinë e saj.

THJESHTËSIA DHE PËRKUSHTIMI I PEJGAMBERIT A.S. NË JETËN SHTËPIAKE

Pejgamberi a.s. na ka dhënë një shembull të shkëlqyer të jetës familjare përmes sjelljes së tij të përkryer në shtëpi. Trajtimi i tij i mrekullueshëm ndaj grave të tij arriti në një shkallë të tillë sa ai t'i ndihmonte ato në punët e shtëpisë. Ai kujdesej për gratë e tij dhe nuk i lodhte me nevojat e tij personale. Ai ishte i butë, i thjeshtë dhe i ndihmonte në punët e shtëpisë.

Kur e pyesin njerëzit Aishen r.a.: "Cila ishte sjellja e Pejgamberit a.s. me gratë e tij? Si e trajtonte Pejgamberi a.s. familjen e tij? Dhe çfarë bënte ai në shtëpinë e tij?" Ajo u përgjigjej me një përshkrim të shkurtër dhe elokuent:

"I Dërguari i Zotit a.s., ishte më i buti dhe bujari i njerëzve. Ai ishte një burrë si burrat tuaj, përveç se ishte shumë i buzëqeshur dhe i qeshur.[13] Ai ishte një njeri si gjithë njerëzit. Ai pastronte rrobat e tij, milte delen e tij dhe i shërbente vetes.[14] Ai qepte rrobën e tij, arnonte sandalet e tij dhe bënte atë që bëjnë burrat në shtëpitë e tyre.[15] Ai ishte në shërbim të familjes së tij. Kur vinte koha e namazit, ai dilte për namaz."[16]

Nëna e besimtarëve e përshkroi më pak fjalë, por me thellësi të jashtëzakonshme. Përmes këtyre përshkrimeve, ajo na hap një dritare të veçantë në shtëpinë e Profetësisë, duke na mundësuar të shohim se si ishte në jetën private, me familjen e tij, veçanërisht brenda mureve të shtëpisë së tij – aty ku vërtet matet morali i një njeriu. Ajo e përshkroi atë në këtë mënyrë koncize dhe elokuente. Kjo na mëson shumë gjëra për jetën familjare profetike: butësi në sjellje, buzëqeshje e vazhdueshme, pjesëmarrje aktive në punët e shtëpisë, modesti dhe thjeshtësi e skajshme, si dhe ndërgjegje e lartë për kohën e adhurimit, pa e neglizhuar jetën familjare.

Ky shembull i të Dërguarit të Allahut a.s. na mëson se përkushtimi ndaj familjes dhe ndihma në punët e shtëpisë janë shenja të karakterit të mirë dhe të moralit të lartë. Edhe ndihma më e vogël sjell gëzim në shtëpi dhe i bën gratë të ndihen të vlerësuara. Pejgamberi a.s., edhe pse ishte i zënë me drejtimin e shtetit dhe me misionin hyjnor, nuk e shihte të ulët të merrte pjesë në punët e shtëpisë dhe të ndihmonte gratë e tij. Ai me këtë na tregoi se përgjegjësitë e mëdha jashtë shtëpisë nuk duhet të jenë kurrë justifikim për të neglizhuar detyrat familjare.

PËRFUNDIMI

I Dërguari i Zotit a.s. jetoi me gratë e tij një jetë të lumtur, një jetë që ishte zbatim praktik dhe i përpiktë i fjalëve të Zotit të Plotfuqishëm: *"Dhe jetoni me to në mirësi."*(En Nisa, 19).

Këtë urdhër hyjnor Pejgamberi a.s. e zbatoi në formë të përkryer në jetën e tij familjare. Ai dha shembullin më të mrekullueshëm të marrëdhënieve bashkëshortore. Ai ishte vërtet bashkëshorti më i mirë për gruan e tij dhe më i miri i njerëzve për familjen e tij. Pse jo, kur vetë ai e bëri kriter të vlerësimit të burrave të mirë, sjelljen e mirë më bashkëshortet, siç tha: "Më i miri prej jush është ai që është më i miri ndaj familjes së tij, dhe unë jam më i miri prej jush ndaj familjes sime." Sjellja e tij ndaj tyre ishte sjellje profetike fisnike, e mbushur me respekt, mirësjellje dhe ndjeshmëri. Kurrë, asnjëherë, ai nuk e goditi askënd me dorën e tij të pastër dhe të ndershme. Ai a.s. ishte i sjellshëm me to, gjithmonë i buzëqeshur, i dashur në sjellje dhe i butë, i trajtonte me edukatë dhe moral të lartë, me dashuri, drejtësi, mëshirë dhe besnikëri, dhe gjithçka tjetër që kërkon jeta bashkëshortore në të gjitha rrethanat e saj.

Kjo që kemi përmendur më sipër është vetëm një pikë nga oqeani, shembuj të paktë që shpjegojnë se si Pejgamberi a.s., kujdesej për gratë e tij. Përmes sjelljes së tij ai e udhëzoi umetin e tij drejt asaj se si duhet të jetë edukimi dhe shoqëria e mirë familjare përmes fjalëve dhe veprimeve të tij.

1 El Buhari, nr: 294, 1/66, Muslimi, nr: 1211, 2/873.
2 El Buhari, nr: 5675, 7/121, Muslimi, nr: 2191, 4/1722.
3 Ahmedi, nr: 26866, 44/435. Dijaudin el Makdesi, në "*El Ehadith el Muhtare*", 5/106, ka thënë: "*Senedi i tij është i mirë*".
4 Kejfe amelehum salallahu alejhi ve selem, f. 61.
5 Et Tirmidhi, nr: 3691, 6/62-63, dhe thotë: "*Ky hadith është i mirë sahih*".
6 Umdetu el Karij, 4/221.
7 Sherh Sahih el Buhari, 2/548.
8 Ahmedi, nr: 26277, 43/313, Shejh Shuajbi thotë: "*Senedi i tij është i mirë*".
9 Ahlakijatu et Teamul el Useri, f. 94.
10 El Buhari, nr: 5211, 7/33, Muslimi, nr: 2445, 4/1894.
11 El Buhari, nr: 6161, 8/38, Muslimi, nr: 2323, 4/1811.
12 Sherh en Nevevi ala Sahihi el Muslim, 15/81.
13 Musned Is'hak bin Rrahivijeh, nr: 1750, 3/1008, Mekarim el Ahlak i Ibën Ebi Dunjas, fq.120. El Menavi, në "*Et Tesir bi sherhi el Xhami es Sagir*", 2/246-247, thotë: "*Senedi i tij është i dobët*".
14 Ahmedi, nr: 26194, 43/263, Shejh Shuajbi thotë: "*Hadithi është sahih*".
15 Ibën Hibani, nr: 5677, 12/490-491, Shejh Shuajbi thotë: "*Senedi i tij është sahih sipas kritereve të dy shejhave*".
16 El Buhari, nr: 676, 1/136.



Devotshmëria, tipar i dijetarëve të gjeneratave të së kaluarës

Hfz. Arif Emini

KUPTIMI DHE RËNDËSIA E DEVOTSHMËRISË (TAKVASË)

Nëse vështrojmë sado pak Kuranin famëlartë, me siguri se për një kohë të shkurtër do të gjejmë një sërë ajetesh, të cilat flasin për devotshmërinë. Le të shohim disa në vijim: "*O besimtarë kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë mysliman.*" (Ali Imran, 102); "*O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejta të ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.*" (En Nisa, 1); "*O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t'jua bekojë veprat tuaja dhe do t'jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.*" (El Ahzab, 70-71).

Për studiuesin e Kuranit dhe hadithit të Muhamedit a.s., është e qartë se nuk mund të kalosh pranë këtyre ajeteve dhe haditheve, që flasin për devotshmërinë e të mos mbeten gjurmë të thella në zemrat dhe në shpirtrat e tyre të kalitur me fjalën dhe udhëzimet e Zotit.

Në fillim le të definojmë kuptimin e devotshmërisë – takvasë. Në ajetin e lartpërmendur të sures Ali Imran, ku Allahu xh.sh., kërkon prej besimtarëve që t'ia kenë dronë ashtu siç i takon Atij, domethënë që besimtarët të kujdesen për veten në raport me Zotin në veprimtaritë e tyre. Fjala "*uekaa*" d.m.th., kujdes, mbrojtje. Ashtu siç është qëllimi i gjithë Kuranit në ngritjen e niveleve të besimtarëve, po ashtu bëhet edhe e qartë si bëhet lëvizja e besimtarit dhe besimtares nëpër këto nivele. Islami i besimtarit nënkupton nënshtrimin e tij ndaj urdhrave të Allahut xh.sh., imani i tij vjen si rezultat i qëndrueshmërisë së besimtarit në fazat e nënshtrimit dhe ky bëhet niveli i dytë i zhvillimit të karakterit të tij. Pasi që ky iman të ketë hyrë në zemrën e tij dhe t'i ketë dhënë frytet e tij, çdo veprimi i jep shije dhe përpjekje përsosurie derisa ndërgjegjja dhe vetëdija të ngritët në nivelin e

Takvallëku është metodë për edukimin e njerëzimit, mënyrë jetese, mënyrë qeverisjeje, mënyrë e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror dhe besim i vërtetë dhe i sinqertë i mbikëqyrjes së Zotit në jetën dhe veprimtarinë tonë në publik ose kur jemi vetëm.

ihsanit, apo ashtu siç e ka përmendur i Dërguari i Allahut a.s.: “Ta adhurosh Zotin sikurse e sheh Atë, edhe pse ti nuk e sheh, Ai ty të sheh,”. Kjo gjendje në kontinuitet sjell nivelin e devotshmërisë që nënkupton mbikëqyrjen e nefsit dhe drejtimin e tij.

Ibën Mesudi ka thënë: “Devotshmëri domethënë të jesh i nënshtruar ndaj Allahut dhe të mos gabosh ndaj Tij, ta kujtosh atë dhe të mos e harrosh, t’i jesh mirënjohës dhe të mos jesh mospërfillës.”

Pra, takvallëku është metodë për edukimin e njerëzimit, mënyrë jetese, mënyrë qeverisjeje, mënyrë e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror dhe besim i vërtetë dhe i sinqertë i mbikëqyrjes së Zotit në jetën dhe veprimtarinë tonë në publik ose kur jemi vetëm. Ajo që e bën takvanë edhe më thelbësore është edhe porosia e Muhamedit a.s., me theks të veçantë drejtuar gjithë ymetit.

Irbad bin Sarji thotë: “Kemi qenë duke falur namazin e sabahut me të Dërguarin e Allahut a.s., i cili ligjëroi një fjalim ta qartë nga i cili lotuan sytë dhe u dridhen zemrat. Një njeri tha: “Sikur ky fjalim është fjalim lamtumirës, ndaj çfarë na porosit o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “Iu porosis t’ia keni dronë Zotit, të dëgjoni dhe t’i nënshtroheni...” (Tirmidhiu)

DEVOTSHMËRIA, POROSI E TË PARËVE TË DREJTË

“Të porosis të jesh i devotshëm, veprim ky i cili do të jetë i pranuar tek Allahu Fuqiplotë, Ai nuk do ta mëshirojë askënd që nuk e posedon atë, dhe askush nuk do të shpërblehet për asgjë si për të.

(Omer ibën Abdulazizi)

Nga thesaret e historisë islame janë nxjerrë shembuj dhe modele të cilët i dhuruan shumëçka mendjes dhe të arriturave njerëzore. Dijetarë nga të gjitha skajet e sundimit të Islamit dhe myslimanëve kanë lënë gjurmë të pashlyeshme për të gjitha gjeneratat e së ardhmes. Të studiohen jetët e tyre, me theks të veçantë ata që u dalluan me dituritë e tyre, me modestinë e devotshmërinë, me çiltërsinë dhe sinqeritetin e tyre, gjithmonë ka qenë dhe mbetet një nder i veçantë për pasuesit e Islamit.

Gjenerata të tëra nga besimtarët e parë dhe ata që pasuan pas tyre u edukuan dhe u kalitën me fjalën “takva”, duke u nisur nga ajetet kuranore, disa prej të cilave i përmendëm, haditheve të Muhamedit, a.s., e kështu me radhë, derisa këshilla për devotshmërinë vazhdoi edhe te sahabët, tabiinët, e më pas te të gjithë ata që niseshin dhe merrnin rrugën e diturisë për të përcjellë mesazhet hyjnore.

Ebu Bekri r.a., si në shumë fjalime të tij, edhe në një prej tyre ka thënë: “E më pas, vërtet iu porosis të jeni të devotshëm...”

Omeri r.a., i ka shkruar djalit të tij Abdullahut: “Pastaj po të them dhe të porosis që vetëm Allahut Fuqiplotë t’ia kesh dronë...”

Omer ibën Abdulazizi, mes të tjerash ka shkruar një letër: “Të porosis të jesh i devotshëm, veprim ky i cili do të jetë i pranuar

tek Allahu Fuqiplotë, Ai nuk do ta mëshirojë askënd që nuk e posedon atë, dhe askush nuk do të shpërblehet për asgjë si për të. Vërtet shumë këshillues flasin për të, ndërsa ata që veprojnë sipas saj janë pak. I lutem Allahut që ne dhe ty të na bëjë nga të devotshmit!"[1]

Abdullah ibën Mesudi, duke i përshkruar vetitë e të devotshmëve që njohin dhe mësojnë fjalën e Zotit, ka thënë: "Hafëzi i Kuranit duhet të dallohet në mesin e njerëzve me adhurim nate derisa të tjerët flenë; me agjërim gjatë ditëve derisa të tjerët nuk agjërojnë; me dituri përderisa të tjerët atë e neglizhojnë; me pikëllim kur të tjerët dëfrehen; me të qarë përderisa të tjerët qeshen; me heshtje kur të tjerët hyjnë në konflikte; dhe me përulje kur të tjerët bëhen mendjemëdhenj."[2]

Abdullah el Mubareku, duke folur për të dijshmit e kohës së tij dhe për virtytet e tyre, thotë: "Në jetë kam takuar më të devotshmin, më të përulurin, më të diturin dhe në jurisprudencë më të fuqishmin: njeriu më i devotshëm ishte Abdulaziz b. ebi Davudi, më i përulur ishte Fudajl ibën Ijadi, më i ditur ishte Sufjan eth Theuriu, më i fuqishëm në jurisprudencë ishte Ebu Hanife."

SHEMBUJ TË DEVOTSHMËRISË NGA DIJETARËT E ISLAMIT

Përcillet nga Abdullah el Mubareku se ka thënë: "Kur kam arritur në Kufe, kam pyetur për njeriun më të devotshëm, dhe njerëzit mu përgjigjën se ai ishte Ebu Hanife."[3]

"Kur kam arritur në Kufe, kam pyetur për njeriun më të devotshëm, dhe njerëzit mu përgjigjën se ai ishte Ebu Hanife."

(Abdullah el Mubareku)

Imam Maliku ka qenë një njeri madhështor dhe dinjitoz. Studentët e tij ia kanë pas dronë, saqë në tubimet e tij nëse ka hyrë dikush dhe i ka përshëndetur, askush nuk ka guxuar të përgjigjet përveç se me një shenjë a një gjest. Atë e kanë respektuar edhe qeveritarët dhe fëmijët e tyre. Tregohet se kalifi El Mehdiu e kishte ftuar Imam Malikun, kështu që ishin mbledhur aq shumë njerëz saqë nuk ka mbetur vend për t'u ulur, mirëpo kur arriti Imam Maliku, të gjithë njerëzit zhvendosen në një anë derisa arrij te kalifi, i cili edhe vetë ka lëvizur për t'i bërë vend imamit. Kështu imami ka pasur aq ndikim dhe ka qenë aq mbresëlënës pa pasur ndonjë pushtet.[4]

El Husejni bin Ali el Karabisi ka thënë: "Kam kaluar tetëdhjetë net me Shafiun. Ai në të tretën e natës lutej dhe nuk kalonte një ajet prej ajeteve të mëshirës dhe ai lutej për mëshirën e Allahut ndaj tij dhe ndaj të gjithë besimtarëve, dhe nuk kalonte një ajet prej ajeteve të ndëshkimit dhe ai lutej duke kërkuar strehimin dhe mbrojtjen e Zotit për të dhe për të gjithë besimtarët."[5]

Ahmed ibën Hanbeli ka qenë njeri shumë i devotshëm dhe ka qenë nga dijetarët e njohur për zuhdin e tij. Ai gjithë jetën ia ka kushtuar minberit të dijes, lutjeve dhe të gjitha adhurimeve obligative dhe vullnetare. Nga urtësitë e këshillave të tij gjatë ligjërimit është edhe kjo poezi:

Nëse një ditë do të mbetesh vetëm,

Mos thuaj 'jam vetëm', por më vëzhgojnë,

I neglizhuam ditët derisa mëkatet njëri-tjetrin ndoqën,

Eh sa do të doja që Zoti të më falë atë që ka kaluar,

E të më lejojë të pendohem, falje duke kërkuar,

Nëse shekulli në të cilin jeton ka kaluar,

Dhe ke lënë pas një brez, por në të ti je një i huaj.[6]

Gjithçka që ekziston ka vetitë e veta, ka cilësitë dhe vlerën e vet, kurse cilësia e devotshmërisë paraqet vlerën më të madhe të qenies njerëzore. Ai që ka rregulluar këtë raport me Zotin, gjithsesi se kjo do të pasqyrohet edhe në raportet e tij në mesin e njerëzve. Devotshmëria paraqet normën e vetme të vlerësimit dhe të dhënies përparësi një njeriu ndaj një tjetri. Këtë e pohon Kurani famëlartë, ku thotë: "*...më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...*" (El Huxhurat, 13).

Ishin këto pak fjalë duke hedhur pak dritë për vlerën e devotshmërisë në të kaluarën tonë të ndritshme, me shpresë për të marrë mësimin edhe në ditët tonë në të cilat jetojmë. I lutemi Allahut Fuqiplotë të na bëjë prej të devotshmëve!

---

1 Ibën Rexheb, "*Xhamiul ulumi vel Hikem*", I f. 405-406.

2 Imam Nevevi, "*Adabi ucenja Kurana*", f. 43.

3 Hatib el Bagdadi, "*Tarihu Bagdad*", f. 342-343.

4 Muhamed ebu Zehra, f. 101-102

5 Jahja bin Ibrahim ebu Zekerija, "*Menazil eimetil erbea*", f. 226

6 Mustafa el Shekaa, vëll. IV, f. 76.

Asketizmi - ilaçi i zemrës në kohën e garës për dynjanë

Blerim Musliu

"Dynjaja është shtëpia e atij që nuk ka shtëpi në ahiret, e grumbullojnë ata që nuk kanë mend, e mbi të xhelozojnë ata që nuk kanë dije, e për të lodhen ata që nuk kanë kuptim."

(Hasan el Basriu)

Në ditët e sotme, ne jemi bërë dëshmitarë të një gare të egër për pasuri, famë dhe pushtet. Shoqëritë janë bërë si tregu i madh, ku njeriu vlerësohet më shumë për atë që ka, sesa për atë që është në vetvete. Ky mentalitet ka sjellë një garë të madhe për gjërat materiale, shpeshherë duke harruar se jeta është e shkurtër dhe e përkohshme. Në këtë garë të egër njerëzit sakrifikojnë shëndetin, kohën, moralin, e madje edhe fenë e tyre, vetëm e vetëm për të fituar më shumë se të tjerët.

Në këtë realitet, praktikimi i asketizmit (zuhdit) është ilaçi shpirtëror. Ai ia rikthen njeriut ekuilibrin dhe e mëson atë ta shohë dynjanë me realitetin e saj, e ai është se kjo dynja është vetëm një arë ku punohet dhe fitohet ahireti, e jo si vend i përhershëm. Një njeri asket nuk është ai që nuk ka asgjë, por ai që nuk lejon që dynjaja ta sundojë zemrën e tij. Ai mund të posedojë pasuri, por nuk e robëron dot pasuria atë; mund të jetojë në mirëqenie, por nuk e harron dot llogarinë e Ditës së Gjykimit.

Atë që Allahu e dërgoi të jetë mësues i njerëzimit në koncepte dhe kuptime, në një hadith shumë të shkurtër na jep një përgjigje rreth kësaj dileme dhe mashtrimi që njerëzit i çon drejt joqëndrueshmërisë. Ai a.s., ka thënë: "Bëhu asket në këtë botë, Allahu do të të dojë! Bëhu asket ndaj asaj që kanë njerëzit, do të të duan ata!"[1]

Në këtë hadith, i Dërguari a.s., na mëson se e tërë çështja është te lidhja e zemrës, teksa vetëm zemrat e pastruara nga dynjaja dhe lakmia kanë gjetur dhe gjejnë rehatinë dhe kënaqësinë.

Modeli më i mirë i asketizmit është vetë Pejgamberi a.s., i cili jetoi thjesht, ani pse kishte mundësi të jetonte një jetë luksi. Ai shpeshherë flinte mbi hasra, ndonjëherë kalonte ditë pa ndezur zjarr në shtëpi, por zemra e tij ishte më e pasura mbi tokë. Edhe sahabët e tij, si: Ebu Bekri, Omeri, Othmani e Aliu r.a., ndonëse disa prej tyre ishin tregtarë të pasur, madje për kohën e tyre ishin "milionerë e ndoshta edhe miliarderë" të kohës, prapëseprapë nuk e lanë pasurinë t'i bënte robër, por e përdorën atë për hir të Allahut dhe u bënë model të ymetit.

Në një kohë kur njerëzit maten me makina, shtëpi, poste e rroba markash të ndryshme, asketizmi është një kujtesë së njeriu vlen për besimin, moralin dhe veprat e mira. Pasuria është e lejuar dhe e nevojshme, por nuk duhet të bëhet qëllim në vetvete. Hasan el Basriu në një thënie të tij ka thënë: "Dynjaja është shtëpia e atij që nuk ka shtëpi në ahiret, e grumbullojnë ata që nuk kanë mend, e mbi të xhelozojnë ata që nuk kanë dije, e për të lodhen ata që nuk kanë kuptim."

Megjithatë është shumë e nevojshme që ta bëjmë një rikujtim shumë të rëndësishëm të konceptit të asketizmit. Ai nuk do të thotë që të mos posedosh pasuri, por që të të mos të robërojë ajo. Jo rastësisht është thënë se dynjanë duhet ta heqësh nga zemra dhe ta mbash në duar, ngase përderisa e mban në

duar, ti e menaxhon atë, ndërsa po e mbajte në zemër, ajo të menaxhon ty.

Pra, asketizmi nuk është të heqësh dorë nga puna, përparimi apo mjetet e jetës, por është ta jetosh jetën me ndërgjegjen se çdo gjë është kalimtare dhe se qëllimi përfundimtar është kënaqësia e Allahut. Në kohën e kësaj gare të verbër për dynja, asketizmi është dritë që e shpëton njeriun nga robëria e pasurisë dhe e shpie atë drejt lirisë së shpirtit. Vetëm me këtë frymë mund të ndërtojmë një jetë me ekuilibër, ku dynjaja është në duart tona, e jo në zemrat tona.

Asketizmi është dy shkallësh: E para, të heqësh dorë nga stolitë e dynjasë. Ky është kuptimi i përgjithshëm, ashtu siç edhe Zoti i Madhëruar na ka mësuar në Kuranin fisnik: *"Dhe çdo gjë që ju është dhënë, është vetëm furnizim i jetës së kësaj bote dhe stoli e saj, por ajo që është tek Allahu është më e mirë dhe më e qëndrueshme."* (El Kasas, 60); ndërsa shkalla e dytë është, të heqësh dorë nga lavdërimet e njerëzve, fama dhe udhëheqja. Këtë shkallë nuk e arrin askush tjetër, veçse ai të cilit Allahu ia pastron zemrën për botën tjetër. Jusuf ibën Esbati ka thënë: "Asketizmi (zuhdi) nga udhëheqja është më i vështirë sesa asketizmi nga dynjaja."[2]

Disa të devotshëm heqin dorë nga stolitë e dynjasë, por nuk heqin dorë nga fama për shkak të dobësisë në sinqeritetin e tyre dhe mangësisë në bindje. Kjo është një dëshirë e fshehur, që i sprovon disa prej dijetarëve dhe thirrësve. Sufjan Theuriu ka thënë: "Nuk kam parë më pak asketizëm në diçka sesa në udhëheqje. E sheh njeriun të heqë dorë nga ushqimi, pija, pasuria dhe rrobat, por nëse i cenohet pushteti, ai lufton dhe armiqësohet për të."[3]

"Nuk kam parë më pak asketizëm në diçka sesa në udhëheqje. E sheh njeriun të heqë dorë nga ushqimi, pija, pasuria dhe rrobat, por nëse i cenohet pushteti, ai lufton dhe armiqësohet për të."

(Sufjan Theuriu)

Imam Ahmedi ka thënë: "Zuhdi është tri shkallësh: Ta lësh të ndaluarën – ky është zuhdi i njerëzve të zakonshëm; T'i lësh gjërat e panevojshme nga e lejuara – ky është zuhdi i të zgjedhurve; T'i lësh gjërat që të largojnë nga Allahu – ky është zuhdi i të diturve."[4]

KUSH KONSIDEROHET ASKET I VËRTETË?

Asket (zahid) i vërtetë është ai që kur i vije dynjaja nuk i dorëzohet, por e refuzon dhe e zgjedh atë që është tek Allahu. Malik ibën Dinari ka thënë: "Njerëzit thonë se janë asket, por i vërteti ishte Omer ibën Abdulazizi, të cilit i erdhi dynjaja dhe ai e braktisi atë."[5]

Pejgamberi a.s. ishte më i madhi i asketëve. Ai a.s. kishte mundësi ta grumbullonte dynjanë, por ai e shpenzoi atë për bamirësi dhe e mbajti vetëm aq sa i duhej. Ai a.s. ka thënë: "Sikur të kisha ari sa mali Uhud, do të doja që të mos kalonin tri net e të kisha ruajtur diçka prej tij, përveçse për ta shlyer një borxh."[6]

Me një rast, Omeri r.a. u përlot kur pa Pejgamberin a.s. të shtrirë mbi një hasër, e cila i kishte lënë gjurmë në trupin e të Dërguarit a.s.. Pejgamberi a.s., kur e pa, i tha: "*A nuk të kënaq që për ne të jetë ahireti, e për ta të jetë dynjaja?*"[7]

Zoti i Madhëruar, në një ajet kuranor thotë: *"Dhe prej tyre bëmë prijës që udhëzonin me urdhrin Tonë, pasi duruan."* (Es Sexhde, 24).

DOBITË E ASKETIZMIT (ZUHDIT)

Asketizmi ka shumë dobi, ndërsa ne do t'i përmendim vetëm disa prej tyre: Pastron zemrën nga smira dhe urrejtja, duke sjellë dashuri ndërmjet njerëzve; E bën të lehtë durimin ndaj fatkeqësive; Sjell urtësi; Jep shijen e imanit; Është prehje për trupin dhe shpirtin; E largon njeriun nga gara me të tjerët për dynjanë; Nxitë dëshirën për takimin me Allahun; Sjell dashurinë e Allahut dhe të njerëzve etj..

1 Transmeton Ibën Maxheh.
2 Ibën Xheuzi, "*Talbis Iblis*".
3 Ibën ebi Dunja, "*Ez Zuhd*".
4 Ibën Rexhebi, "*Xhamiu-l Ulum vel Hikem*".
5 Ebu Nuajmi, "*Hiljetul Evlija*".
6 Transmetojnë Buhariu, 2389; dhe Muslimi, 992.
7 Transmetojnë Buhariu, 4913; dhe Muslimi, 1479.

Oshënaria – domosdoshmëri e kohës

Mr. Artan Musliu

Oshënaria[1] tregon për jetën e murgave apo të besimtarëve ortodoks që jetonin të vetmuar dhe me mundime, me qëllim të fitimit të hirit të Zotit. Pra, e tërë kjo bëhej me qëllim të ruajtjes së vetvetes dhe shpirtit nga përlyerja dhe rënia eventuale në mëkate, apo gabime të ndryshme.

Oshënarët ishin ata që kishin hequr dorë nga gëzimet e kësaj jete, kishin përzgjedhur që të jetonin në vetmi dhe në një asketizëm të skajshëm. E të tillët po ashtu janë quajtur edhe si *eremitë*,[2] fjalë kjo që vije nga latinishtja dhe që do të thotë “shkretëtirë”. Pra, vend i pabanueshëm, apo vështirë i banueshëm. Eremitët, sipas grekëve të lashtë, janë quajtur njerëzit që kanë jetuar të vetmuar, larg shoqërisë dhe të mirave të kësaj bote. Ndërsa, sipas besimit krishterë, kështu janë quajtur besimtarët apo murgët e krishterë të cilët, për të pastruar veten dhe shpirtin e tyre, kanë udhëtuar për dyzet vjet nëpër shkretëtirë duke jetuar të vetmuar, larg shoqërisë dhe gëzimeve të kësaj jete.

Oshënarët ishin ata që kishin hequr dorë nga gëzimet e kësaj jete, kishin përzgjedhur që të jetonin në vetmi dhe në një asketizëm të skajshëm. E të tillët po ashtu janë quajtur edhe si eremitë.

OSHËNARIA NGA KËNDVËSHTRIMI ISLAM

Padyshim se oshënaria apo distancimi nga shoqëria është e njohur në Islam. Një veprim i tillë ishte pothuajse traditë e të gjithë të dërguarve të Allahut xh.sh. para shpalljes së tyre. Por, kishte edhe prej atyre që ishin distancuar nga shoqëria edhe pas shpalljes së tyre. Shembull për këtë kemi rastin e Junusit a.s., i cili ishte larguar nga njerëzit e tij si shenjë proteste për mosdëgjueshmërinë dhe mos-përgjigjen e tyre ndaj thirrjes së tij.

Po ashtu, kemi dëshmi të shumta edhe nga vetë jeta e Muhamedit a.s., i cili largohej prej Mekës dhe mbyllej në shpellën Hira. Ai a.s. këtë e bënte për t’u larguar prej njerëzve për shkak të padrejtësive që bëheshin ndaj tij, për shkak të degjenerimit dhe nivelit të ulët që kishin banorët e Mekës së asaj kohe.

Por, edhe vetë shpallja e fundit kur kishte filluar, Pejgamberi a.s. kishte qenë i vetmuar në shpellën Hira.

GJYKIMI I ISLAMIT PËR OSHËNARINË APO TË DISTANCIMIT NGA SHOQËRIA

Oshënaria apo distancimi nga shoqëria kalon në tri predispozita juridike islame. Dhe, e tërë kjo ndërlidhet ngushtë me vetë individin, me kohën, vendin dhe rrethanat në të cilat është duke jetuar individi, apo për të cilat kërkohet një predispozitë apo gjykim fetar rreth kësaj çështje:

OSHËNARIA APO DISTANCIMI I NDALUR

Distancimi nga shoqëria konsiderohet i ndaluar në rast se shoqëria ka nevojë për atë individ. Siç mund të jenë rastet e nevojës për dijen, për përvojën, për punën e tij, etj.. Pra, në raste të tilla, individi nuk lejohet që të distancohet nga shoqëria, sepse do bartë përgjegjësinë e fshehjes së dijës së tij. Po ashtu, njeriut nuk i lejohet që të distancohet nga

prindërit, familjarët dhe farefisi i tij. Ai duhet që të mbajë lidhjet sidomos nëse ka të bëjë me raste të caktuara siç është pjesëmarrja në varrim te familjarët dhe të afërmit, apo në rast se familjarët dhe të afërmit kanë nevojë për ndihmën tënde, etj.. Por, këtu duhet që të kemi parasysh se duhet të peshohet në mes të dëmit dhe dobisë. Pra, nëse dëmi është më i madh në rast të pjesëmarrjes, atëherë nuk duhet që të marrim pjesë por, edhe e kundërta. Po ashtu, besimtari nuk i lejohet që të distancohet tërësisht siç është braktisja e namazit të xhumasë, e namazit me xhematë, etj..

OSHËNARIA APO DISTANCIMI I LEJUAR

Besimtarit i lejohet që të distancohet, duke i përjashtuar rastet e cekura më lartë, në rast se presioni, trysnia, sprovat dhe dëmet e të tjerëve karshi tij janë aq të rënda saqë e ka të pamundur që të përballoj një situatë të tillë. Po ashtu, në rast se shoqëria ka shkuar aq larg dhe është zhytur aq shumë në degjenerim, amoralitet, korrupsion, mashtrime, etj.. Pra, në raste kur besimtari vlerëson se prezenca e tij në atë rreth ia rrezikon fenë e tij dhe se mundësia e rënies në mëkat është më e madhe sesa e shpëtimit prej tij atëherë, duhet që të distancohet. E tërë kjo bëhet me qëllim të ruajtjes së vetvetes së tij në fenë e tij, familjen dhe pasurinë e tij.

OSHËNARIA E PREFERUAR

Besimtarit i preferohet që të izolohet, të heq dorë apo të distancohet nga shoqëria në rast se degjenerimi ka marrë përmasa dhe ka gjetur një shtrirje të madhe te shoqëria, mjedisi dhe njerëzit me të cilët ai jeton. Rast për këtë kemi rastin e Jusufit a.s., i cili e kishte përzgjedhur burgun para mëkatit. Pra, e kishte preferuar vetmin dhe distancimin nga shoqëria para rënies në mëkat.

Shejh Ibën Bazi, Allahu e mëshiroftë, kur ishte pyetur për distancimin nga shoqëria në kohën kur do të përhapet degjenerimi dhe të përhapet e keqja në shoqëri, pra, kur njeriu ka frikë se mund të humbas fenë e tij, vetveten e tij, familjen apo pasurinë e tij, ai ishte përgjigjur duke thënë se: "Ky është një veprim i pëlqyer në rast se njeriu frikësohet se mund ta humbas fenë e tij për shkak të sprovave, degjenerimit dhe ndryshimit të parimeve e të normave të moralit të një shoqërie. Pra, lejohet ikja nga e keqja dhe nga keqbërësit për të ruajtur vetveten dhe fenë."[2] Pra, besimtari nuk duhet të jetë prej atyre që kërkojnë të ekspozohen para masës së njerëzve, të kërkojnë famë dhe reputacion, por, përkundrazi preferohet që të veprojnë në heshtje, në qetësi, larg syve të njerëzve dhe shoqërisë. Tërë kjo, për shkak të frikës nga syfaqësia.

PËRFUNDIMI

Parimisht dhe në esencë duhet që ta kemi të qartë se njeriu është një qenie shoqërore. Pra, është i krijuar që të jetojë dhe të bashkëveprojë me shoqërinë dhe në shoqërinë ku ai jeton. Besimtari duhet që të ndërveprojë dhe të bashkëveprojë për

të mirën dhe interesin fetar dhe shoqëror. Për këtë, kemi si dëshmi fjalën e Pejgamberit a.s., i cili ka thënë: "Besimtari që bashkëvepron me të tjerët dhe tregon durim e maturi ndaj sprovave dhe të bëmave të tyre është më i mirë se një besimtarë që nuk bashkëvepron me të tjerët dhe nuk tregon durim ndaj sprovave dhe të bëmave të tyre."[3]

Pra, në rast se besimtari ka mundësi që të jetojë në mesin e njerëzve duke ua mësuar dhe shpjeguar atyre fenë, duke i këshilluar për të mirë dhe ndaluar nga e keqja, si dhe duke treguar maturi e durim ndaj sprovave dhe sfidave të tyre atëherë, padyshim se kjo është parimisht ajo për të cilën edhe jemi në këtë botë. Por, në rast të pamundësisë së përballimit të trysnisë, presionit, sprovave dhe të bëmave të keqbërësve, e mbi të gjitha në rast të frikës nga humbja, devijimi dhe lajthitja në fe atëherë, padyshim se për të tillët preferohet apo lejohet që të distancohen prej shoqërisë. E tërë kjo duhet që të bëhet me të vetmin qëllim që të ruhet feja e Allahut xh.sh., qoftë edhe në vetveten e tij si individ. E në moment të evitimit të kësaj frike dhe krijimit të kushteve apo rrethanave të reja, apo mundësisë së bashkëjetesës dhe bashkëveprimit në mesin e njerëzve atëherë, padyshim se duhet të kthehemi në parimet bazë dhe në esencën e arsyes dhe qëllimit të krijimit tonë. Pra, nuk lejohet më distancimi dhe qëndrimi larg njerëzve.

---

1. https://fjalorthi.com/oshënar, data e fundit e shfletimit 27.04.2025, 20:30h.
2. https://en.wikipedia.org/wiki/Hermit, data e fundit e shfletimit 27.04.2025, 20:45h.
3. Edh Dharijat, 51.
4. Këtë transmetim e shënon Imam Muslimi, nga Sad ibën Ebi Vekasi, në Sahihun e tij. Shih transmetimin numër 2965.
5. Këtë transmetim e shënon Imam Albani, nga Abdullah ibën Omeri, në Sahih el Xhamij. Shih transmetimin numër 6651.

Literatura dhe terminologjia shkencore e shkollës juridike hanefite

Mr. Ekrem Maqedonci

Literatura hanefite është e larmishme dhe përfshin vepra të natyrës bazike e deri te traktatet më të sofistikuara juridike. Ajo u zhvillua në disa nivele: nga tekstet për studentët fillestarë deri te veprat monumentale, që shërbenin si referencë për dijetarët e mëdhenj.

Shkolla juridike hanefite është një prej shkollave kryesore të jurisprudencës islame, e themeluar nga kolosi dhe imami Ebu Hanife (80–150 h.), që ishte një prej dijetarëve më të shquar të kohës së tij. Ajo u formësua në një periudhë të hershme të historisë islame dhe luajti një rol të rëndësishëm në sistematizimin e mendimit juridik, duke ndikuar thellë në zhvillimin e fikhut në botën islame. Kjo shkollë u dallua jo vetëm për qasjen e saj të gjerë ndaj përdorimit të arsyes dhe analogjisë (kijasit), por edhe për një literaturë të pasur, e cila u shndërrua në trashëgimi të çmuar për brezat pasardhës.[1]

Literatura hanefite është e larmishme dhe përfshin vepra të natyrës bazike e deri te traktatet më të sofistikuara juridike. Ajo u zhvillua në disa nivele: nga tekstet për studentët fillestarë deri te veprat monumentale, që shërbenin si referencë për dijetarët e mëdhenj. Në këtë traditë përfshihen veprat e "matn-eve" (tekste themelore), komentimet ("shuruh"), përmbledhjet ("mukhtasar"), si dhe vepra të fatvave dhe të literaturës krahasuese. Këto shtresa të ndryshme të literaturës juridike i dhanë shkollës hanefite një koherencë të brendshme dhe një ndikim të jashtëzakonshëm në praktikën e përditshme fetare e shoqërore.

Studimi i literaturës dhe terminologjisë hanefite nuk është vetëm një angazhim akademik, por edhe një mënyrë për të kuptuar se si është zhvilluar mendimi islam juridik ndër shekuj, si është përshtatur me kontekste të ndryshme historike e kulturore dhe si vazhdon të mbetet i gjallë në botën bashkëkohore.[2]

Andaj, thelbi i kësaj teme ka të bëjë me "Literaturën dhe terminologjinë shkencore të shkollës juridike hanefite".



Trajtesa jonë synon të kristalizojë e të vë në pah një nga sfidat më të mëdha të shkollarëve tanë, e që është largimi, mosnjohja dhe anashkalimi i literaturës bazike dhe kapitale të medhhebit tonë, sfidë e cila vërtet vështirëson rrugën për të arritur deri te mësimet e mirëfillta të kësaj shkolle juridike.

Në këtë trajtesë do të përpiqem që të hedh dritë në pikat vijuese:

- Vlera dhe rëndësia e njohjes me literaturën bazike të shkollës juridike hanefite.
- Periudhat kohore në të cilat janë shkruar shumica e literaturës kapitale hanefite.
- Forma dhe mënyra e klasifikimit të literaturës juridike hanefite.
- Shtjellim i shkurtër i terminologjisë së literaturës hanefite, dhe rëndësia e kësaj në hulumtimet juridike.
- Klasifikimi i dijetarëve të shkollës juridike hanefite.

VLERA DHE RËNDËSIA E NJOHJES ME LITERATURËN BAZIKE TË SHKOLLËS JURIDIKE HANEFITE

Si çdo shkencë që rregullat, parimet dhe që të vërtetat e veta i ka të evidentuara nëpër literatura bazike, e të cilat ruhen me kujdes, dhe në to bëhet referimi për çdo çështje të komplikuar, po ashtu duhet të themi se juristët klasikë islamë, kanë qenë të kujdesshëm që shkencën e fikhut ta ruajnë, e pastaj ta bartin për gjeneratat vijuese në formën më besnike dhe kredibile që mund të imagjinohet.

S'ka dilemë se, themelimi i shkencave islame, ka qenë një mision jo i lehtë, por të cilin dijetarët tanë të brezave të ndritshëm e kanë kryer me përkushtim dhe kujdes të skajshëm. Ata, me mundin e tyre vetëmohues, kanë arritur që të vejnë themelet e pothuajse të gjitha shkencave islame, e në këtë rast gjithsesi edhe të shkencës së fikut.

Natyrshëm që çdo konkludim, hulumtim dhe trajtesë, që sot mund të bëhet nga hulumtuesit bashkëkohorë, qoftë me qasje krahasuese-komporative, qoftë vetëm si hulumtim brenda shkollës juridike hanefite, ka vlerë dhe krijon qëndrueshmëri shkencore, vetëm nëse mbështetet në literaturën bazike të kësaj shkence.

Andaj, për t'iu ofruar hulumtimeve të sotshme juridike islame kredibilitet dhe qëndrueshmëri shkencore në aspektin islam, është e domosdoshme që të njihemi me këtë literaturë. Për këtë arsye edhe dijetarët e mëhershëm kanë thënë: "Hulumtuesi nuk e ka të domosdoshme që të gjitha çështjet t'i njohë përmendsh-realisht, por prej tij kërkohet që të dijë referencat dhe burimet në të cilat ai mund të referohet e të njoftohet me to."[3]

I pari që ka shkruar libër nga dijetarët e medhhebit hanefit është vetë Imam Ebu Hanifeja, themeluesi i kësaj shkolle juridike. Libri që e ka shkruar Imam Ebu Hanifeja është "Fikhul-Ekber"

Për këtë arsye e shohim se rëndësia e njohjes së literaturës bazike, është e pakontestueshme, sepse vetëm përmes literaturës së tillë mund të njihen apo shtjellohen mirëfilli e shkencërisht çështjet e fikhut apo të jurisprudencës islame.

PERIUDHAT KOHORE NË TË CILAT JANË SHKRUAR SHUMICA E LITERATURËS KAPITALE HANEFITE

Njohja e periudhave kohore në të cilat është shkruar literatura bazike-kapitale hanefite ka vlerë të veçantë për shkak se vetëm kështu do të kemi mundësi që të bëjmë klasifikim real dhe të qëndrueshëm shkencor të kësaj literature më vonë.

I pari që ka shkruar libër nga dijetarët e medhhebit hanefit është vetë Imam Ebu Hanifeja, themeluesi i kësaj shkolle juridike. Libri që e ka shkruar Imam Ebu Hanifeja është "Fikhul-Ekber", por se ky libër nuk ka qëlluar të jetë i shkruar në shkencën e fikut, me gjithë faktin se është emërtuar "Fikhu më i rëndësishëm", e që tematika e tij ka të bëjë kryekëput me çështjet e akaidit. Gjithashtu nga Imam Ebu Hanifeja është ruajtur deri te ne edhe një lloj libërthi-shkrese, i ashtuquajturi "*Rrisaletu ilel Uthman Elbettij*", por edhe kjo shkresë me gjithë kontestimin se a është autoriale nga Imami ynë, s'ka të bëjë asgjë me shkencën e fikhut. Rrjedhimisht mund të theksojmë se, Imam Ebu Hanifeja me gjithë thellësinë e tij shkencore në shkencën e fikhut, nuk ka lënë asgjë të shkruar me dorën e tij, që ka të bëjë me këtë shkencë, por dijen, mendimet dhe konkluzat e tij të mprehta, i bartën për gjeneratat në vijim nxënësit e tij të vyeshëm.

Prandaj, mund të konstatohet prerazi se shkrimet e para, që në të vërtetë llogariten edhe ato më thelbësoret në shkollën juridike hanefite, janë përpiluar në periudhën kohore pas vdekjes së tij, respektivisht në gjysmën e dytë të shekullit II hixhrij, e kanë vazhduar kështu deri në fundshekullin e pestë po ashtu hixhrij. Kjo nuk nënkupton se pas kësaj periudhe kohore nuk kishte vepra shkencore - juridike, por se të tillat janë konsideruar si themel solid për të gjitha të tjerët që u shkruan më pas.

I pari që ka shkruar libër dhe ai të jetë në shkencën e fikhut nga dijetarët e medhhebit hanefit, pa dyshim se llogaritet Imam Jakub ibën Ibrahim Ebu Jusuf el Kadij (113-182 h) në Bagdad. Librat e tij të shkruara në shkencën e fikhut janë: "*Kitab el Haraxh*", "*Ihtilaf Ebi Hanife ve Ibën Ebi Elejla*", "*Erred ala sijer Elevzai*", *Kitabul Athar*".

Por duhet theksuar një specifikë të këtyre librave autoriale të Imam Ebu Jusufit, se ato nuk përbëjnë në tërësi bazën e literaturës juridike hanefite, ngase asnjëri prej tyre nuk përfshin tërë tematikat ose kapitujt e jurisprudencës islame, porse shtjellojnë ndonjë tematikë të veçantë pa u zgjeruar në kapituj të

tjerë. Këta libra disa janë të botuara (siç është "*El Haraxh*") e shumica e tyre nuk kanë arritur në duart tona. E pas librave të Imam Ebu Jusufit janë përpiluar librat e para bazike në shkollën juridike hanefite, nga Imam Muhamed bin Hasen Es Shejbani (132-189h.), e për vlerën e tyre flasim në vijim.[4]

FORMA DHE MËNYRA E KLASIFIKIMIT TË LITERATURËS JURIDIKE HANEFITE

Klasifikimi i literaturës juridike islame të shkollës hanefite ka vlerë të veçantë sepse, referimi i dijetarëve të mëvonshëm, doemos do të duhej të bëhej në ato libra që konsiderohen bazike dhe origjinale, e të cilat në mënyrë besnike kanë bartur deri te ne fikhun e Imam Ebu Hanifes.

Ky klasifikim e gjejmë se është bërë në disa kategori, e të cilat janë:

Librat e njohura me emërtimin ***"Kutubul Usul"*** – Literatura bazike hanefite dhe quhen po ashtu *"Kutub Dhahir Errivajeh"* – Literatura që përmbledh në vete mendimet më të fuqishme e të argumentuara. Këta libra janë quajtur si *"Kutub Dhahir Errivajeh"*, sepse janë transmetuar nga Imam Muhamed ibën Hasen esh Shejbani, nxënësi i Imam Ebu Hanifes, dhe atë nga transmetuesit e përpiktë e të besueshëm. Në këta libra, në të vërtetë janë evidentuar në formën më besnike mendimet e Imam Ebu Hanifes.

Librat "*Dhahir err Rrivajeh*" gjithsej janë gjashtë, e ato janë: "*El Mebsut*", "*Ez Zijadat*", "*El Xhami es Sagir*", "*El Xhami el Kebir*", "*Es Sijer es Sagir*", dhe "*Es Sijer el Kebir*".

Që të gjitha këta libra të Imam Muhamedit, i ka përmbledhur në një libër të vetëm e unik Imam el Hakim esh Shehid ebu Fadl Muhamed bin Ahmed el Mervezi (i cili ka vdekur ne vitin 334 h.) duke e emërtuar atë libër "*El Kafi*". Është emërtuar kështu "*El Kafi*" - *I mjaftueshëm*, ngase atij që i intereson hulumtimi në literaturën e hanefitëve ky libër në të vërtetë do t'i mjaftonte. Ndërsa sqarimin e tij më përmbledhës e ka bërë në formë të shkëlqyer Imam Muhamed ibën Ahmed Ebu Bekër Shemsul Eimmeh es Serah'sij (490 h.), në librin e tij të ashtuquajtur "*El Mebsut*", libër të cilën ua diktoi nxënësve të tij sa ishte në burg (në qytetin e Ozgjenit, një nga qytetet persiane të atëhershme), dhe e përfundoi në vitin (477 h.). Duke ditur se ky libër i përfshin të gjitha librat e mëhershme, atëherë mund të themi si është prej librave kryesore, bazike dhe shkencore të medhhebit hanefi.[5]

2. Literaturat ose meseletë e njohura me emërtimin "*En Nevadir*", e që shumica e tyre janë të shkruara po ashtu nga Imam Muhamedi, apo nga Hasen ibën Zijadi. Këto mesele njihen edhe si: "*El Harunijaat, El Kejsanijat dhe El Xhurhanijaat*". Në këto shkrime i gjejmë mendimet e imamëve tanë, e të cilat nuk janë të përmendura në literaturën paraprake të librave "*Dhahir err Rrivajeh*".

3. Librat e ashtuquajtura "*Kutub el Fetava*", por quhen edhe "*Kutub el Vaakiaat*" - Librat e ndodhive. Në këta libra i gjejmë fetvatë e muxhtehidëve të mëvonshëm, të cilët kur janë pyetur për çështje të ndryshme dhe ndodhi të ndryshme, nuk kanë gjetur ndonjë citat nga transmetimet e dijetarëve të mëhershëm, dhe kanë dhënë përgjigjeje ose fetva. Autorët e këtyre librave ndodhë që fetvatë e tyre të mos përputhen me mendimet e dijetarëve eminentë të medhhebit (nxënësve të Ebu Hanifes), për ndonjë arsye që ata e kishin kuptuar ose marrë parasysh në kohën e tyre. Libri i parë që ka përmbledhur këto përgjigje të pyetjeve dhe ndodhive është libri "*En Nevaazil*" nga dijetari i shquar hanefit Ebu Lejth es Semerkandi, i cili ka vdekur në vitin 373 h.

4. Libra që mund t'i konsiderojmë bazike dhe kredibile në medhheb janë edhe disa prej *"mutuneve"* - tekste bazike, që janë përpiluar nga dijetarët e mëvonshëm ose të mëhershëm të shkollës juridike hanefite.

"*Mutunet*" e dijetarëve të mëhershëm mund të përmendim: Metni i Tahaviut (321 h), Metni i Kerhiut (340 h.), Metni i El Xhasasit (370 h), Metni i Imam el Hakimit (334 h) etj..

Ndërsa "Mutunet" e dijetarëve të mëvonshëm mund të përmendim: "*Tuhfetul fukaha*" e Imam Alaudin es Samerkandit (i cili vdiq në vitin 538 h), libër të cilën më vonë e komentoi Imam Alaudin el Kasani (i cili vdiq në v. 587 h) dhe e quajti "*Badai Esenai fi tertiib Esherai*", pastaj Metni i quajtur "*El Hidajeh*" i imam Merginanit (593 h.), Metni i Imam Kudurit (428 h.), Metni i Imam Mevsiliut (683 h.) i quajtur "*El Muhtar*", pastaj "*El Kenzi*" i Imam Nesefiut (710 h.), "*El Multekaa*" e Imam Halebiut (956 h.) etj..[6]

TERMINOLOGJI E LITERATURËS HANEFITE DHE RËNDËSIA QË K NË HULUMTIMET JURIDIKE

Hulumtuesi që dëshiron të ketë qasje korrekte dhe të krijojë bazë të fuqishme shkencore në medhhebin hanefi, doemos duhet t'i ketë të qarta edhe disa prej termeve që janë përdorur ekskluzivisht nga dijetarët e hershëm të medhhebit tonë. Të tillat terme-nocione nëse kuptohen drejt do të lehtësohej puna e juristit-fekihut në nxjerrjen e dispozitave sheriatike islame në frymën e shkollës juridike hanefite.

Termet që është e udhës t'iu bëjmë një sqarim të shkurtër janë më sa vijon:

Imam: Është për qëllim themeluesi i medhhebit Imam Ebu Hanifeja.

Shejhaan: Janë Imam Ebu Hanifeja dhe Imam Ebu Jusufi.

Sahibaan: Janë për qëllim dy nxënësit e Imam Ebu Hanifes, Ebu Jusufi edhe Imam Muhamedi.

Tre imamët: Janë për qëllim tre imamët kryesor të medhhebit, Imam Ebu Hanifeja, Ebu Jusufi dhe Imam Muhamedi.

Et Tarefan - Dy palët: Janë për qëllim Imam Ebu Hanifeja në njërën anë dhe Imam Muhamedi në anën tjetër.

Imam Er Rrabani: Nëse ky term theksohet në librat e hanefitëve, zakonisht është për qëllim Muhamed ibën Hasen esh Shejbani.

El Hasen: Nëse ky emër theksohet në librat e medhhebit, për qëllim është El Hasen ibën Zijad El Luluij, nxënësi i Imam Ebu Hanifes, i cili edhe pse është shumë meritor në përhapjen e medhhebit hanefi, rrallëherë përmendet në literaturat e medhhebit.

El Meshajih: Janë imamët, të cilët nuk e kanë takuar Imam Ebu Hanifen, dhe kur përmendet meshajihul-medhheb, dihet se nuk është për qëllim Ebu Hanifeja me tre nxënësit e tij të lartpërmendur.

Es Selef: Kur përmenden në medhhebin hanefi, është për qëllim tre imamët kryesor të medhhebit, Imam Ebu Hanifeja, Imam Ebu Jusufi dhe Imam Muhamedi.

El Halef: Në literaturën hanefite, sa herë që përmendet termi El Halef, janë për qëllim juristët prej Imam Muhamed esh Shejbanit e deri tek Imam Shemsul Eimeti el Halvani, i cili ka vdekur në vitin (450 h).

Elmute eh'irun: Janë dijetarët e mëvonshëm të medhhebit, nga Imam el Halvani e deri te dijetari i famshëm hanefit Hafidhudin Muhamed bin Muhamed el Buhari, i cili ka vdekur në vitin (630 h).

Shemsul Eimeh: Janë të shquar me këtë pseudonim dy nga imamët e medhhebit, Imam Serahsiu dhe Imam Hilvani.[7]

KLASIFIKIMI I DIJETARËVE TË SHKOLLËS JURIDIKE HANEFITE

Dijetarët e medhhebit hanefi ndahen dhe klasifikohen në disa kategori:

- Rangu i muxhtehidëve ose hulumtuesve *të fesë islame në përgjithësi.* Rëndom këta janë dijetarët e thellë, të cilët kanë mundësi dhe kapacitete të bëjnë hulumtime të pavarura në çështjet islame në përgjithësi. Këta janë dijetarë me renome botërore, si p.sh. themeluesi i medhhebit: Imam Ebu Hanifeja, e disa muxhtehidë të tjerë, themeluesit e tri medhhebeve të tjera.
- Rangu i muxhtehidëve ose hulumtuesve *të medhhebit.* Këta konsiderohen hulumtues, studiues apo mexhtehidë të pavarur vetëm për medhhebin hanefi, siç është Imam Ebu Jusufi, Muhamed esh Shejbani, e nxënësit e tjerë të Ebu Hanifes, të cilët fevatë e tyre konsiderohen si referencë vetëm brena medhhebit hanefi.
- Rangu i muxhtehidëve ose dijetarëve *të atyre meseleve, të cilat nuk gjejmë ndonjë mendim të Imam Ebu Hanifes në to,* siç janë: El Hisaf, Et Tahavi, El Kerhi, Es Serahsij, El Halvani, El Bezdevij, Kadi Han, etj.. Vlen të theksohet se këta dijetarë nuk e kundërshtojnë Imam Ebu Hanifen ne mesele, mirëpo kanë dhënë fetva dhe mendime, e kanë bërë ixhtihad në ato mesele, të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e Imam Ebu Hanifes, ose nuk ka dhënë fetva për to.
- Rangu ose kategoria e muxhtehidëve ose dijetarëve *të shpjegimit ose detajizimit të meseleve të medhhebit.* Këta dijetarë në esencë nuk kanë bërë ixhtihad për të dhënë fetva të pavarura, por në realitet vetëm i kanë detajizuar meseletë ose fetvatë e mëhershme të medhhebit. Ndër këta dijetarë janë: Imam err Rrazi, e disa të tjerë të ngjashëm me të.
- Rangu ose kategoria e atyre muxhtehidëve ose dijetarëve të cilët bëjnë ***zgjedhjen e meseleve të sakta nga ato që janë më të pasakta (Erraxhih minel merrxhuh)***. Të kësaj kategorie janë: Imam Kuduri, Imam Merginani etj..
- Kategoria e atyre dijetarëve ose muxhtehidëve, të cilët bëjnë dallimin mes dy meseleve të sakta se cila është më e fortë në saktësi dhe më e përshtatshme për vendin dhe kohë.

Dhe kategoria e fundit e dijetarëve të medhhebit, janë ata të cilët nuk bëjnë kurrfarë dallimi, por vetëm janë në gjendje t'i tubojnë, apo theksojnë fetvatë dhe meseletë e medhhebit, duke e ditur burimin (librin dhe emrin e muxhtehidit) të atyre meseleve.[8]

PËRFUNDIM

Këto janë disa nga termet kryesore me të cilat njihen literatura, imamët, juristët dhe dijetarët e shkollës juridike hanefite, por ka edhe shumë terme të tjera, të cilat për shkak të mos zgjatjes nuk i kemi përmendur të gjitha.

Një gjë duhet theksuar për fund se, sipas shkollës juridike hanefite janë shkruar edhe libra të pasura e me vlerë shkencore dhe në kohën bashkëkohore, por nuk jemi ndalur te të tillat, ngase sfida për shkollarët e këtij fahu nuk është kjo kategori e këtyre librave, por janë ato libra bazike të medhhebit, të cilat nëse kuptohen drejt, janë të qarta për studiuesin, më pas qasja ndaj çfarëdo libri të mëvonshëm a bashkëkohorë do të ishte e lehtë. Madje ne mendojmë se varshmëria e studiuesve ose preferenca e tyre vetëm në literaturën bashkëkohore juridike është një prej elementeve kyçe që ndikon në varfërimin dhe ngushtimin e horizonteve analitike të një studiuesi të mirëfilltë.

---

1 Për më hollësisht për biografinë e Imam Ebu Hanifes dhe mendimet e tij juridike mund të shikosh: Ebu Zehre, "Ebu Hanife, Hajatuhu ve asruhu ve Arauhu fikhijeh", Darul Fikr el Arabij.

2 Pr. dr. Muhamed Vehbi Zuhajli "Fikhul Islam ve ediletuhu" 1/41-69, Darul Fikr.

3 Imam Gazaliu, "*El Mustasfa*" f. 363, Daruth Thekafeh.

4 Për me gjerë shiko: Muhamed Rida Mensur Shems "*El med'hal ilel Medhhebi-l Hanefij*" (f. 30).

5 Shiko: Muhamed Abdulhak el Knevij, "*El Fevaid el behije fi teraxhim el hanefijeh*" (f. 270-271), Darul Erkam Bin Ebil Erkam.

6 Për me gjerë shiko: Dr. Ahmed Seid Hava, "*El Med'hal ile Medhheb Ebi Hanifete en Numan*" (f. 422-456), Darun Nahdah.

7 Për literaturat dhe terminologjinë shkencore të hanefitëve mund t'i referohemi edhe: "Hashijet Ibën Abidiin" ose "*Redul Muhtar ala ed Durril Muhtar*" (f. 31-33).

8 Më gjerësisht shiko kategoritë e dijetarëve të medhhebit hanefi ne librin "*El Med'hal ile Medhheb Ebi Hanifete e Numan*" (f. 405-421). Dr. Ahmed Seid Hava, Darul Andalus el Hadra



Hadithi në shkollën juridike hanefite

Myfti Muhamed Teki Uthmani

Kriteri i përcaktimit të autencitetit të ndonjë hadithi nuk është prezenca ose mos prezenca e tij te Buhariu ose Muslimi, por janë normat e përdorura nga vetë këta dy dijetarë të mëdhenj të hadithit.

UTENTICITETI I HADITHEVE DHE VLERA E FIKHUT HANEFI

Pretendimi se shkolla juridike hanefite i bazon fetvatë e veta në transmetime të dobëta të haditheve është injorancë e plotë. Reflektimi në mënyrë të paanshme mbi librat e fikhut hanefi nuk do t’i linte hapësirë një pohimi të tillë. Koleksionet në vazhdim të dëshmive për fikhun hanefi ilustrojnë nivelin e thellë dhe serioz të dijes mbi hadithet në mesin e pasuesve aktualë të shkollës hanefite:

1. Sherh Me’ani’l Athar – nga Imam Tahaviu;
2. Fet’hul Kadir – nga Shejh Ibën Humami;
3. Nasb’urr Rraje – nga Shejh Zejle’i;
4. El Xhevher’un Nekijj – nga Shejh Mardini;
5. Umdet’ul Kari’ – nga Shejh Ajni;
6. Fet’hul Mulhim – nga Shejh Shabbir Ahmed Uthmani;
7. Bedhl’ul Mexhhud – nga Shejh Halil Ahmed Seharenpuri;
8. Me’arifus Sunen – nga Shejh Binnuri;
9. Fejd’ul Bari – nga Shejh Shah Enver Kashmiri.

Ekzistojnë disa pika themelore që kanë nevojë për sqarim. Hadithet autentike nuk janë veçori veç e Buhariut dhe Muslimit. Ekzistojnë shumë libra të tjerë të hadithit, që përmbajnë me mijëra hadithe autentike. Baza për një hadith autentik është zinxhiri i transmetuesve të tij (senedi) dhe teksti (metni). Grumbulluesit e tjerë të haditheve, përveç Buhariut dhe Muslimit, kanë vendosur kritere në zinxhirin e transmetuesve po aq të forta sa edhe ato që gjenden në koleksionet e tyre respektive. Hadithet që nuk gjenden te Buhariu dhe Muslimi nuk janë të dobëta për shkak të mos prezencës së tyre në ato dy koleksione. Kjo do ta kthente shkencën e hadithit në hamendje të plotë. Hadithet e transmetuara nga transmetues të tjerë, përveç Buhariut dhe Muslimit, gjenden në disa libra të hadithit, që mund të jenë më të fortë në senedet e tyre, sesa edhe dy përpilimet më të fuqishme të haditheve. Për shembull, Ibni

Maxheh, i cili është i gjashti nga librat e njohura të hadithit, ka transmetuar hadithe që në disa pikëpamje janë më superiore nga ato të pararendësve të tij. Prandaj, kriteri i përcaktimit të autencitetit të ndonjë hadithi nuk është prezenca ose mos prezenca e tij te Buhariu ose Muslimi, por janë normat e përdorura nga vetë këta dy dijetarë të mëdhenj të hadithit. Nëse një hadith i caktuar i plotëson kriteret e njëjta si ato të Buhariut dhe Muslimit dhe nuk gjendet domosdoshmërish në dy koleksionet në fjalë, atëherë ai prapëseprapë do të konsiderohet si autentik (sahih). Të kuptuarit e këtij parimi të haditheve, do ta treste paksa kritikën e keq orientuar kundër fikhut hanefi menjëherë.

METODAT E MUXHTEHIDËVE NË PËRDORIMIN E HADITHEVE

Njëra nga arsyet më kryesore se pse ekzistojnë kaq shumë dallime mendimesh ndërmjet muxhtehidëve mbi detaje të posaçme të ligjit është ajo se metoda e analizimit, arsyetimit dhe deduksionit varion. Nëse ekziston një kundërshtim i jashtëm ndërmjet dy haditheve, një muxhtehid mund ta bazojë opinionin e tij në hadithin më të fortë nga ata të dy, edhe pse që të dy mund të jenë autentikë në transmetim. Megjithatë, muxhtehidi tjetër mund ta bazojë opinionin e tij në rregullin se asnjë hadith nuk duhet të mënjanohet, megjithëse ai mund të jetë i dobët në transmetim. Pastaj, muxhtehidi tjetër do të bëjë përpjekje që t'i koordinojë që të dyja hadithet duke e interpretuar njërin si bazë dhe tjetrin si pjesë të tij, pa marrë parasysh sesa autentik ose i dobët mund të jetë njëri nga dy hadithet. Ndërsa një muxhtehid tjetër mund ta bazojë opinionin e tij te hadithi në bazë të praktikës së sahabëve dhe pasuesve të tyre. Pra, secili muxhtehid do ta adoptojë metodën e vet të posaçme dhe asnjëri nuk mund ta kritikojë tjetrin për lënie të hadithit. Imam Ebu Hanife tentonte që t'i koordinonte hadithet kundërshtuese dhe përpiqej që ta përdorte secilin hadith përderisa ai të mos ishte i fabrikuar. Edhe hadithi i dobët është shfrytëzuar gjithashtu, kur nuk është gjetur asnjë hadith tjetër që do ta kundërshtonte atë, edhe pse ai mund të ishte kundër arsyetimit dhe analogjisë ligjore. Për shembull, çështjet për prishjen e abdesit nëse qeshim në namaz dhe zekatit për mjaltin, Imam Ebu Hanife i ka favorizuar, edhe pse hadithi që është burim i tyre është i dobët. Vendimi mbi autencitetin e hadithit është një proces ixhtihadi në vete. Kjo është arsyeja se pse kjo çështje gjithmonë është diskutuar në mesin e dijetarëve që i analizojnë

Ka raste ku Imam Ebu Hanife një hadith e ka konsideruar si të denjë për përdorim dhe i njëjti hadith është konside-ruar si i dyshimtë nga një muxhtehid tjetër. Imam Ebu Hanife ishte vetë muxhtehid, prandaj ai nuk varej nga vendimet e muxhtehidëve të tjerë.

transmetuesit e hadithit. Hadithi që konsiderohet si autentik dhe i mirë nga një imam hadithi, mund të konsiderohet si i dobët nga një tjetër. Ka raste ku Imam Ebu Hanife një hadith e ka konsideruar si të denjë për përdorim dhe i njëjti hadith është konsideruar si i dyshimtë nga një muxhtehid tjetër. Imam Ebu Hanife ishte vetë muxhtehid, prandaj ai nuk varej nga vendimet e muxhtehidëve të tjerë. Nganjëherë një hadith që i ishte transmetuar Imam Ebu Hanifes me transmetim autentik, bëhej i dobët në zinxhir të transmetimit pasi kalonte nga ai. Me fjalë të tjera, zinxhiri i transmetuesve deri tek Imam Ebu Hanife ishte i fortë, por zinxhiri nga Imami në fjalë te dijetarët e tjerë bëhej i dobët për shkak të futjes në të të ndonjë transmetuesi të dobët. Kjo vazhdimësi e ngjarjeve nuk e ka ndryshuar të arsyetuarit e Imam Ebu Hanifes. Ndonjëherë një hadith mund të transmetohet me zinxhir të dobët transmetuesish nga një imam, mirëpo hadithi i njëjtë mund të transmetohet me zinxhir të shëndoshë (autentik) nga një imam tjetër. Për shembull, hadithi që thotë se: "*Kushdo që ka një imam (në namaz), recitimi i imamit mjafton*", është transmetuar me zinxhir të dobët, pastaj ne kuptojmë se në transmetimet e Imam Tahaviut dhe Ahmed ibën Muni'iut ky hadith është shumë i fortë. Nganjëherë një hadith mund të jetë i dobët në zinxhirin e tij, por meqë ekzistojnë disa zinxhirë të ndryshëm, që e kanë transmetuar hadithin, dijetarët e pranojnë atë si të vlefshëm. Kjo kategori hadithesh njihet si "i mirë nga shkaku i të tjerëve". Ky lloj hadithi nuk është i dobët, prandaj është i vlefshëm për përdorim në fushat fikhore.

ROLI I HADITHEVE TË DOBËTA NË FIKHUN HANEFI

Nuk ka dyshim se disa hadithe në fakt janë të dobëta. Dobësia e hadithit përcaktohet nga transmetuesi i dobët që gjendet brenda senedit të tij. Megjithatë, nuk është e domosdoshme që secili transmetues i dobët të ketë transmetuar hadith të dobët sa herë që ka transmetuar. Për shembull, nëse ekziston një transmetim i dobët në një libër hadithesh, në bazë të së cilit kanë punuar sahabët dhe pasuesit e tyre, atëherë kjo praktikë demonstron atë se transmetuesi i dobët në të vërtetë ka transmetuar në mënyrë korrekte. Kjo është arsyeja se pse hadithi: "*Nuk ka testament për tra-shëgimtarët (të cilët kanë hise të caktuar që përpara në trashëgimi)*", është pranuar nga të gjithë muxhtehidët, megjithëse hadithi konsiderohet të jetë i dobët në transmetim.

Në rastin e të dëshmuarit kolaborues dhe mbështetës për përforcimin e një hadithi të dobët, një hadith i tillë do të pranohet dhe përdoret. Në fakt, ky proces mund t'i japë përparësi një hadithi të dobët ndaj një të forti. Për shembull, vajza e Pejgamberit a.s., Zejnebja, *Zoti qoftë i kënaqur me të*, ishte martuar me Ebul Asin, i cili nuk e kishte pranuar Islamin menjëherë, por më vonë. Pyetja në mesin e dijetarëve është se nëse Pejgamberi a.s. e kishte ripërtërirë kontratën e tyre martesore (nikahun), apo i kishte lejuar që të bashkëjetonin si burrë e grua pa e bërë një gjë të tillë. Transmetimi i Abdullah ibën Umerit r.a., thotë se kontrata ishte ripërtërirë me mehr të ri, ndërsa transmetimi i Abdullah ibën Abasit r.a., thotë të kundërtën. Transmetimi i Ibën Umerit r.a., është i dobët, ndërsa ai i Ibën Abbasit r.a. është autentik. Imam Tirmidhiu, i cili ishte mjeshtër i hadithit, i ka dhënë përparësi ligjore hadithit të dobët ndaj atij autentik për shkak të praktikës së sahabëve r.a..[1]

Kundërshtimi ndaj pikëpamjes hanefite është për shkak të mosdijes, rrallë për shkak të studimit të mirëfilltë, dhe në raste të caktuara madje edhe një mungesë përpjekjeje për ta kuptuar pikëpamjen hanefite. Disa dijetarë kanë rënë në këtë indiferencë. Për shembull, Meulana Selfi e ka kritikuar qëndrimin e Imam Ebu Hanifes mbi çështjen e faljes së namazit me kujdesin e nevojshëm dhe qetësinë e duhur: "Një njeriu Pejgamberi a.s. i kishte thënë tri herë që ta përsëriste namazin, pasi që ai nuk e kishte falur atë me qetësinë e duhur. Pejgamberi a.s. i kishte thënë: "Falu se nuk je falur!"

Kundërshtimi ndaj pikëpamjes hanefite është për shkak të mosdijes, rrallë për shkak të studimit të mirëfilltë, dhe në raste të caktuara madje edhe një mungesë përpjekjeje për ta kuptuar pikëpamjen hanefite.

Kjo nënkupton atë se namazi nuk ka vlerë ligjore, gjë që është opinion i shafive dhe i dijetarëve të hadithit. Dijetarët shafinj thonë se pasi dihet përkufizimi ligjor i rukusë dhe i sexhdes, ne nuk mund ta pranojmë interpretimin e hadithit, e as që mund të komentojmë nëse namazi është pranuar apo jo.[2]

DALLIMI MES FARZIT DHE VAXHIBIT NË PIKËPAMJEN HANEFITE

Hanefitë sigurisht se nuk e deklarojnë një gjë të tillë. Këta deklarojnë se namazi duhet të përsëritet nëse qetësia e duhur nuk është prezente gjatë rukusë dhe sexhdes, njëlloj siç lë të kuptohet hadithi. Problemi është ai se kritikuesi i respektuar ka dështuar në të kuptuarit e pikëpamjes hanefite. Imam Ebu Hanife bën dallimin në mes asaj që është farz (e domosdoshme dhe përbërëse esenciale e një veprimi) dhe vaxhib (që është e domosdoshme, por jo përbërëse esenciale e një veprimi). Muxhtehidët e tjerë nuk e pranojnë një ndarje të këtillë. Vendimi i Imam Ebu Hanifes thotë se ato komponente që janë farze duhet të jenë në mënyrë vendimtare të përcaktuara nga Kurani dhe Suneti, ndërsa ato që janë vaxhibe janë të përcaktuara përmes hadithit autentik, madje edhe përmes një transmetimi të vetëm (hadith ahad). Nëse dikush s'e kryen ose një farz (për shembull të recituarit e Kuranit) ose një vaxhib (për shembull të falurit e namazit jo me qetësi), namazi duhet që të përsëritet në të dyja rastet. Cilat janë shtrirjet ligjore të kësaj nuance tepër të hollë? Dallimi është ky: nëse dikush s'e kryen një farz do të konsiderohet si një që s'e ka kryer të tërë namazin. Të gjitha normat e ashpra të një personi që s'e kryen namazin, në një shtet islam, do t'i ngarkohen atij. Kjo është kështu për shkak se ai nuk e ka falur namazin ligjërisht dhe për këtë person nuk është në pyetje përsëritja e namazit, por është në pyetje falja e tij. Dikush që s'e kryen

një vaxhib nuk do të konsiderohet si një që s'e ka kryer namazin, ngaqë ai namazin e ka falur në mënyrë të ligjshme, mirëpo jo në mënyrë të plotë, andaj ai duhet që ta përsërisë atë. Kjo gjë faktikisht nënkuptohet nga vetë hadithi. Imam Tirmidhiu ka transmetuar se kur Pejgamberi a.s. i kishte thënë këtij personi që ta përsëriste namazin, sahabët r.a. e panë të vështirë që dikush, i cili e fal namazin në këtë mënyrë të shkujdesur, do të konsiderohej si një që e lë namazin. Kur Pejgamberi a.s. e theksoi rëndësinë e qetësisë gjatë namazit, për shkak të së cilës personi në fjalë e përsëriti namazin, tha: "Kur ta kesh bërë këtë gjë, atëherë e ke kompletuar namazin tënd. Nëse pakëson diçka nga kjo, ti do të kesh pakësuar nga namazi yt."

Rifahu, transmetuesi i hadithit shënoi: "Kjo deklaratë e Pejgamberit a.s. ishte shumë më e lehtë (për sahabët e tij për ta toleruar) sesa e para (kur tha se personi nuk e kishte falur namazin). Kjo deklaratë na jep shenjë se jo i gjithë namazi i është anuluar."[3]

Dijetarët (ulematë) hanefi e kanë përdorur hadithin në tërësinë e tij. Pjesën e parë duke konstatuar se moskryerja e një farzi do ta shndërrojë namazin në të paplotë dhe fikhu kërkon që namazi të përsëritet. Ndërsa pjesa e dytë përdoret për moskryerjen e një vaxhibi, kështu që namazi nuk do të konsiderohet, teknikisht, si i pakryer plotësisht. Shembuj të tillë ilustrojnë nivelin e thellë të diturisë që kërkohet për të kuptuar secilën fetva të fikhut hanefi. Elaborimi i pikave delikate nxjerr në shesh në mënyrë të qartë apatinë e disa qarqeve të caktuara për të kuptuar të arsyetuarit në lidhje me pikëpamjet e fikhut hanefi. Andaj, komenti: "Ne nuk mund ta pranojmë interpretimin e hadithit e as që mund të komentojmë se namazi është pranuar apo jo", është një shtrembërim i madh i pikëpamjes së shkollës juridike hanefite. Fatkeqësisht, nxjerrja e konkluzioneve të nxituara lidhur me pikëpamjen hanefite, pa bërë studimin e duhur mbi çështjen në fjalë, është bërë normë. Për të kuptuar të arsyetuarit ligjor islam, duhet që të studiohen parimet që janë konturuar më përpara në këtë libër, në mënyrë që të shmangen deklaratat e mbuluara që kanë lidhje me interpretimet ligjore hanefite dhe të shmanget të pretenduarit jo korrekt se po i jepet preferencë e paarsyeshme analogjisë ndaj hadithit. Që të dyja konkluzionet janë një padrejtësi e tmerrshme. Në të kaluarën ka pasur shumë dijetarë johanefi, të cilët e kanë mbrojtur qasjen hanefite ndaj ligjit.

MBROJTJA E IMAM EBU HANIFES NGA SHEJH ABDUL VEHHAB SHARANI

Shejh Abdul Vehhab Sharani, megjithëse pasues i shkollës shafite, ka dedikuar ekskluzivisht disa kapituj për t'i qortuar kritikuesit e opinioneve të Imam Ebu Hanifes:

"Ti duhesh të dish, i dashur vëlla, se në këta kapituj unë nuk do ta mbroj Imam Ebu Hanifen thjesht për shkaqe sentimentale ose nuk do ta quaj të pafajshëm për mungesë provash, por unë jam angazhuar në këtë përpjekje pas studimit dhe investigimit shumë të thellë në dëshmitë dhe të arsyetuarit legal. Shkolla e tij juridike ishte e para që u dokumentua dhe u organizua, si dhe siç është parashikuar nga disa dijetarë, ajo do të jetë e fundit që do të zhduket. Në librin tim "Dëshmitë e shkollave legale", unë kam shqyrtuar opinionet e tij dhe të studentëve të tij, dhe kam kuptuar se pikëpamjet e tyre janë bazuar te ndonjë ajet, hadith, citim të ndonjë sahabiu, apo në diçka të ngjashme me të, ose te ndonjë analogji korrekte, e cila vetë kishte precedent. Prandaj, kushdo që dëshiron të dijë më tepër rreth këtyre dëshmive duhet të referohet tek ai libër imi."[4]

Më tej, ai e hedh poshtë idenë se Imam Ebu Hanife i ka dhënë përparësi analogjisë ndaj hadithit: "Dije se ky pretendim është i bazuar në paragjykim, që atribuon në mënyrë të papërgjegjshme deklarata të mbuluara. Kurani thotë: "… se të dëgjuarit, të parit dhe zemra (e të menduarit), për të gjitha këto ka përgjegjësi." (El Isra, 36).

Pastaj, ai vazhdon ta tregojë një ngjarje në të cilën Sufjan Thevriu, Mukatil ibën Hajani, Hamad ibën Selemeh dhe Imam Xhafer es Sadiku (të cilët ishin dijetarë të mëdhenj të kohës së tyre), shkuan tek Imam Ebu Hanife për ta provuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nëse ai i jepte vërtet përparësi analogjisë ndaj hadithit apo jo. Imam Ebu Hanife u përgjigj se ai jo vetëm që e konsideronte Kuranin dhe Hadithin më të fortë sesa analogjinë, por përparësi ndaj analogjisë u jepte edhe opinioneve të sahabëve të nderuar gjithashtu. Ai pastaj vazhdoi t'ua dëshmonte dhe t'ua provonte pikëpamjen e tij për disa orë me radhë. Pesë dijetarët e mëdhenj u larguan nga ai duke kërkuar falje e duke i thënë: "Ti je prijatari i dijetarëve! Të lutemi që të na falësh për krijimin e supozimeve tona pa verifikim të duhur dhe nga injoranca."

Shejh Abdul Vehhab Sharani, vazhdon që ta përgënjeshtrojë pikëpamjen se dëshmitë e Imam Ebu Hanifes janë të dobëta dhe, krejt në fund, vjen te konkluzioni kategorik se: "Unë, elhamdulilah, e kam krehur shkollën e tij me një krehër të mirë dhe kam kuptuar se ajo është jashtëzakonisht e matur dhe madje dukshëm e virtytshme."

Këto komente nga Imam Sharani janë thjesht për të ilustruar në mënyrë të thellë se shkolla, ose medhhebi hanefi bazohet në Kuran dhe Sunet.[5]

Përktheu: Daim Abazi

---

1 Xhamiu i Tirmidhiut. Shembulli i cituar më lart është vetëm një shembull i normës së përmendur. Përndryshe, mendimi hanefit mbi këtë çështje është shumë i vështirë.

2 Tahriki Azadi Fikr, f. 32.

3 Tirmidhiu, kapitulli mbi përshkrimin e namazit.

4 "*El Mizanul Kubra*" nga Abdul Vehhab Sharani, f. 63/64, e shtypur në Egjipt nga Mustafa el Babi.

5 Për dëshmi të mëtutjeshme ju lutemi ta konsultoni librin e tij "*El Mizanul Kubra*".

Roli i hytbes së xhumasë në edukimin fetar

Blerim Ramabaja

Hytbeja është kusht i namazit të xhumasë pa të cilin nuk plotësohet xhumaja; Hytbeja duhet të jetë para namazit të xhumasë; Imami i mban dy hytbe, të cilat i ndan me një ulje.

Rëndësia e ligjërimit në përcjelljen e mesazhit fetar te besimtarët është e madhe. Për këtë shkak, përveç të tjerash, feja ka ligjësuar hytben e xhumasë si ligjërim javor në të cilin besimtarët marrin porositë dhe mesazhet për ta rregulluar jetën e tyre private dhe shoqërore.

KURANI DHE SUNETI PËR HYTBEN E XHUMASË

Hytbeja e xhumasë është përmendur në Kuran, në kaptinën El Xhumah. Allahu i Madhëruar thotë: *"O ju që besuat, kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhumasë, ecni shpejt për aty ku përmendet Allahu (dëgjojeni hutben, faleni namazin), e lini shitblerjen, kjo është më e dobishme për ju nëse jeni që e dini. E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut, por edhe përmendni shpeshherë Allahun, ashtu që të gjeni shpëtim. Po, kur ata shohin ndonjë tregti, ose ndonjë aheng mësyhen atje, kurse ty të lënë në këmbë. Thuaju: "Ajo që është tek Allahu është shumë më e mira se dëfrimi dhe tregtia, e Allahu është furnizuesi më i mirë!"* (El Xhumah, 9-11).

Në këto ajete kuranore aludohet përveç të tjerash edhe për hytben e xhumasë, ndërsa si dëshmi për këtë merret pjesa e ajetit: "...*kurse ty të lënë në këmbë...*", pra qëndrimi në këmbë është tregues për atë se Muhamedi a.s. ka qenë duke e mbajtur hytben dhe se një gjë e tillë sipas disa dijetarëve është dhe kusht-shart i saj.[1]

Edhe në hadithet e Pejgamberit a.s., është folur për hytben e xhumasë, madje më gjerësisht dhe më detajisht se në Kuranin fisnik. Sa për ilustrim po përmendim disa hadithe. Amari r.a., transmeton se Pejgamberi a.s., ka thënë: "Zgjatja e namazit dhe shkurtimi i hytbes janë tregues i dijes së njeriut, prandaj zgjateni namazin dhe shkurtojeni hytben. Vërtet në sqarime ka elokuencë (magji)."[2]

Hytbeja të jetë e shkurtër dhe jo e gjatë. Kjo konsiderohet edhe shenjë e dijes. Amari r.a., ka thënë: "I Dërguari i Allahut na ka urdhëruar për shkurtimin e hytbeve."[3]

Po kështu është përshkruar edhe qëndrimi i Pejgamberit a.s. gjatë hytbes: qëndrimi në këmbë, mbështetja në një hark apo shkop, falënderimi për Allahun e kështu me radhë.[4]

Ndërsa sa i përket etikës, Pejgamberi a.s. na ka mësuar që të mos flasim gjatë hytbes: "Nëse ditën e xhuma teksa imami mban hytben, ti i drejtohesh shokut tënd (që flet), duke i thënë: "Hesht dhe dëgjo!" atëherë ke bërë lagv."[5]Lagvi ka kuptimin se ke thënë fjalë jo të mira dhe se ke humbur një pjesë të shpërblimit të xhumasë.[6]

"Zgjatja e namazit dhe shkurtimi i hytbes janë tregues i dijes së njeriut, prandaj zgjateni namazin dhe shkurtojeni hytben. Vërtet në sqarime ka elokuencë (magji)."

HYTBEJA E XHUMASË NGA ASPEKTI NORMATIV

Me fjalën hytbe kuptojmë hytbet (ligjëratat) fetare në të cilat mësohet dhe shpjegohet feja islame, qofshin ato javore (për xhuma) e që është farz, apo gjatë festave fetare (për Bajram), apo edhe gjatë sezonit të haxhit. Hytbeja në shoqërinë islame praktikohet një herë në javë, sidomos në ditën e xhuma, e gjithashtu edhe në festat e bajrameve. Mirëpo, fjala hytbe ka kuptim edhe më të gjerë, ku në vete përfshinë tribunat, seminaret, simpoziumet etj., të cilat kanë për qëllim dhe synojnë arritjen e kënaqësisë së Allahut xh.sh., udhëzimin e njerëzve në rrugë të drejtë dhe thirrjen e njerëzve në fenë islame.

Hytbeja apo ligjërata fetare çfarë ne e njohim sot, daton që nga koha kur u fal edhe namazi i parë i xhumasë, hytben e të cilit namaz e mbajti vetë i Dërguari a.s., më 16 rebiul evvel të vitit 13, pas shpalljes së pejgamberisë, më gjegjësisht më 20 shtator 622m..

Rëndësia dhe synimi i saj arrihet atëherë kur ajo paraqitet në mënyrën më të bukur, duke zgjedhur shprehjet-nocionet, dhe duke u mbështetur gjithnjë në fjalën e Allahut dhe të Pejgamberit a.s.. Kësisoj, ajo shndërrohet në adhurim, qoftë ligjërimi apo edhe dëgjimi i saj.[7]

Duke qenë se në vendin tonë veprohet sipas medhhebit hanefi, atëherë ne, në këtë punim, do të përshkruajmë aspektin juridik të hytbes sipas medhhebit hanefi: Hytbeja është kusht i namazit të xhumasë pa të cilin nuk plotësohet xhumaja; Hytbeja duhet të jetë para namazit të xhumasë; Imami i mban dy hytbe, të cilat i ndan me një ulje; Hytben e mban në këmbë duke qenë me abdes, por këto nuk janë kushte; Hytben mund ta mbajë edhe ulur dhe duke mos pasur abdes, mirëpo një veprim i tillë është mekruh; Mjafton nëse përkufizohet vetëm në përmendjen e Allahut – dhikër. Ebu Jusufi dhe Muhamedi konsiderojnë se dhikri duhet të jetë i gjatë aq sa të mund të quhet hytbe;[8] Kur imami të fillojë hytben, xhemati nuk falin namaz nafile.[9]

ROLI EDUKATIV I HYTBES SË XHUMASË

Hytbeja e xhumasë ka një rëndësi të veçantë në edukimin e besimtarëve për shkak të pozitës që ka në fe. Ajo është kusht (ar. shart) i namazit të xhumasë, që d.t.th., se namazi i xhumasë nuk pranohet pa hytbe. Hytbeja mbahet në xhami, pra në Shtëpinë e Allahut dhe përsëritet çdo javë, pra mbahet në ditën më të rëndësishme të javës. Trajton çështje të ndryshme nga perspektiva e Kuranit dhe Sunetit, pra teksteve fetare, nga të cilat edhe fiton tretman të lartë. Hytbeja është një prej riteve të kësaj feje, që flet për largpamësinë e saj, dhe si e tillë është mjet edukativ ripërtëritës, pasi që çdo javë sjell zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohen besimtarët. Dëgjimi duhet të bëhet me vëmendje dhe vigjilencë dhe në të prezantojnë një numër i madh i njerëzve. Kjo e shndërron hytben në njërin prej mjeteve më të rëndësishme të kumtimit të Islamit dhe përhapjes së tij ndërmjet njerëzve. Po kështu, hytbes i jep fuqi që për nga ndikimi sfidon mjetet e reja komunikuese.

Në suksesin ose jo të hytbes rol përcaktues kanë këto gjëra: Aspekti përmbajtjesor i hytbes dhe aspekti performues. Mungesa e secilit prej këtyre dy aspekteve, nënkupton apriori dështim të hytbes.

Ibën Kajimi në librin e tij "*Zad el Mead*", duke përshkruar hytbet e Pejgamberit a.s., shpjegon se karakteristikë e tyre ka qenë përmbajtja sipas nevojës dhe rrethanave dhe performimi përmbledhës e i shkurtër: "I urdhëronte sipas gjendjes së krijuar. Nëse shihte se varfëria kishte kapluar shoqërinë, i urdhëronte dhe niste për lëmoshë..."

Studiues dhe autorë të shumtë përmendin se përcaktimi i suksesshëm për temën, respektivisht trajtimi i ndonjë prej problemeve me të cilat ballafaqohet shoqëria, nënkupton hytbe të suksesshme. Ndërsa sa i përket aspektit performues, Ibën Kajimi përmend kujdesin e Pejgamberit a.s., për gjuhën, tonin dhe përmbledhjen e hytbes. Duke iu referuar hadithit të regjistruar nga Imam Muslimi se: "*Shenjë e dijes së njeriut është që ta shkurtojë hytben dhe ta zgjatë namazin*", ai nënvizon se hytbet e Pejgamberit a.s., ishin të shkurtra. Tema e gjatë nënkupton përfshirjen e detajeve të shumta në të cilat janë të panevojshme dhe rrjedhimisht irrituese për xhematin.

Imam Neveviu, në shpjegim të hadithit ku qëndron se: "I Dërguari i Allahut kur mbante hytben, i skuqeshin sytë, e ngrite zërin dhe zemërimi i rritej...", thotë: "Të folurit (ngritja dhe ulja e zërit, ashpërsia dhe butësia) duhet të përputhen me temën të cilën e trajton." Sa i përket performancës, studiuesit kanë përmendur se hytbeja, krahas parashtrimi logjik të përmbajtjes dhe argumenteve të saj, duhet të dallohet edhe për anën joshëse dhe nxitëse të saj. Më saktë, nuk mjafton ta bindësh xhematin por dhe t'i bësh ta përqafojnë dhe përvetësojnë idenë tënde dhe t'i përgjigjen me tërë ndjenjat e tyre. Në fakt kjo e dallon hytben prej ligjërimeve të tjera, pasi në të, theksi vihet tek jo vetëm konfirmimi i të vërtetave, por edhe provokimi i ndjenjave dhe emocioneve, meqë në thelb hytbeja është këshillë. Nëse merren këto elemente parasysh, atëherë hytbeja kalon në mjet efikas të edukimit. Ali Mahfudhi, duke folur për ndikimin edukativ të hytbes, thotë: "Një ligjërues i suksesshëm mund t'i shërojë zemrat, t'i zgjojë mendjet, t'i pastrojë shpirtrat, t'ua ndriçojë njerëzve rrugën e udhëzimit dhe t'i fisnikërojë ata me virtyte dhe edukatë të lartë."

"Një ligjërues i suksesshëm mund t'i shërojë zemrat, t'i zgjojë mendjet, t'i pastrojë shpirtrat, t'ua ndriçojë njerëzve rrugën e udhëzimit dhe t'i fisnikërojë ata me virtyte dhe edukatë të lartë."

(Ali Mahfudh)

Ekzistojnë disa gjëra të cilat kanë çuar në minimizimin e rolit të hytbes së xhumasë në shoqëri. Prej tyre, ajo që dallohet më së shumti është zgjatja e hytbes. Në fakt, dr. Tahir Xhemali, këtë e konsideron njëherësh si një prej gjërave që më së shumti shpërputhet me udhëzimin e Pejgamberit a.s. dhe praktikën e tij për hytben.

---

1 Abdurrahman bin Muhammed el Hamad, *Hutbetu el xhumuati fi el Kitabi ve es Sunneh*, (P.v.b.: p.sh.b., p.v.b.) f. 10.

2 Muslimi, 869.

3 Sahihu Ebi Davud, 1106.

4 Shih: Musnedi i Ahemdit, nr. 17856.

5 Buhariu, nr. 892; Muslimi, nr. 851.

6 Abdurrahman bin Muhammed el Hamad, *Hutbetu el xhumuati fi el Kitabi ve es Sunneh*, vep. cit., f. 15-16.

7 Mr. sci. Jakup Çunaku, "*Metodologjia e thirrjes në islam-dave*", Prishtinë, 2009.

8 Shih: Ahmed bin Muhamed bin Ahmed bin Xhafer bin Hamdan, *Muhtesar el Kuduri fi el fikhi el hanefij*, ver. Kamil Muhamed Muhamed Uvejdah, (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmije, 1997), f. 39-40; Ali bin Ebi Bekir el Merginani, *Metnu Bidajetu el mubtediu fi fikhi el Imami Ebi Hanife*, (Kajro: Matbaatu Muhamed Ali Subh), f. 26; Uthman bin Ali ez Zejlei, *Tebjinu el hakaik sherhu Kenzi eddekaik*, (Kajro: El Matbaatu el Kubra el Emirije, 1313 h.), 1/219-220; Ali bin Ebi Bekir el Merginani, *El hidajetu fi sherhi Bidajeti el mubtedi*, (Bejrut: Dar Ihjai et Turath el Arabij, 1/263-268; Alauddin Kasani, *Bedaiu essanai fi tertibi esh sheriai*, (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmije, 1986, ed. 2), f. 82-83.

9 Ali bin Ebi Bekir el Merginani, *Metnu Bidajetu el mubtediu fi fikhi el Imami Ebi Hanife*, (Kajro: Matbaatu Muhamed Ali Subh), f. 12.



Dehumanizimi dhe kriza e njeriut me hyjnoren

"*Vetëm një Zot mund të na shpëtojë.*"
Martin Heidegger

Dr. Adnan Shala

HYRJE

Në historinë e mendimit filozofik, e po ashtu edhe në atë teologjik, përkufizimi i njeriut është ngushtësisht i lidhur me marrëdhënien e tij me transcendencën. Disa nga filozofët e shohin njeriun si qenie politike dhe morale, ndërsa traditat fetare e përcaktojnë si bartës të imazhit të Zotit (Krishterimi) ose si halife të Zotit në tokë (Islami). Moderniteti, megjithatë, e ka zëvendësuar këtë kuptim me një vizion të reduktuar, ku njeriu trajtohet si instrument teknik, resurs ekonomik apo konsumues. Njeriu në modernitet, pra i shkëputur nga hyjnorja, përqendrohet tek ekzistenca e vet. Kjo është ajo që shumë autorë bashkëkohorë e quajnë dehumanizim, pra humbja e dinjitetit dhe identitetit njerëzor. Largimi nga Zoti, qoftë nëpërmjet ateizmit, qoftë përmes formave më të zbutura si deizmi dhe agnosticizmi, nuk është neutral. Në të gjitha rastet, njeriu humb lidhjen me atë që e bën vërtet njeri dhe reduktohet në një qenie të zbrazët.

LIRIA ABSOLUTE DHE NJERIU

Aristoteli, në librin e tij "Politika", duke e trajtuar natyrën njerëzore e përcakton njeriun si "*zoon politikon*", pra *qenie që realizon natyrën e vet në bashkësi*. Sipas tij, njeriu për nga natyra është i determinuar të jetojë me të tjerët. Ai po ashtu argumenton se një njeri që jeton i izoluar dhe vetëm, është ose më shumë se njeri (një hyjni), ose më pak se njeri (një kafshë). Kjo nënkupton se njeriu nuk është vetëm mendje racionale, por qenie e marrëdhënies me tjetrin. Nëse marrëdhëniet e tij ngushtohen vetëm në horizontin horizontal, pa një dimension vertikal me Zotin, atëherë njeriu humb përkufizimin e tij të plotë. Njeriu

Njeriu në modernitet, pra i shkëputur nga hyjnorja, përqendrohet tek ekzistenca e vet. Kjo është ajo që shumë autorë bashkëkohorë e quajnë dehumanizim, pra humbja e dinjitetit dhe identitetit njerëzor.

shpeshherë e ka kontestuar lirinë e tij në raport me hyjnoren dhe ka pretenduar në një liri absolute. Në vizionin tradicional, liria absolute i takon vetëm Allahut. Njeriu është i lirë aq sa i bindet ligjit hyjnor. Në perspektivën tradicionale islame, njeriu është një urë ndërmjet Allahut dhe natyrës. Ai bart mbi vete shenjat e Krijuesit dhe është pasqyrim i përsosmërisë së Tij. Ky është vizioni i njeriut-halife, që gjen kuptim vetëm në marrëdhënie me Zotin. Në kontrast, njeriu modern, i zhveshur nga dimensioni i shenjtë, rrezikon të humbasë vetveten dhe të dehumanizohet. Në traditën islame, çdo njeri është krijuar me fitre, një natyrë të pastër e të prirë drejt Zotit. Njeriu është krijuar për të bartur përgjegjësinë e të qenit halife në tokë (El Bekare, 30), pra kujdestar dhe përfaqësues i urtësisë hyjnore. Ai është një mikrokozmos ku reflektohen emrat dhe atributet e Zotit. Kjo do të thotë se njeriu e fiton dinjitetin e tij vetëm kur qëndron në lidhje të gjallë me Zotin.

Të gjitha përkufizimet për njeriun përfaqësojnë një nivel bazik, pra një fillimshmëri të humanitetit apo njerëzores. Të thuash se njeriu është qenie që mendon, është të tregosh pikën e parë të dallimit nga kafshët, por jo realizimin e plotë të potencialit të tij. Nga perspektiva islame, mendimi është fillimi i të qenit njeri, por jo maja e tij. Humaniteti arrin përmbushjen e vet të plotë vetëm kur njeriu shndërrohet në "*insan-i kamil*", njeriu i përsosur që pasqyron atributet hyjnore si mëshira, dashuria, drejtësia dhe urtësia. Ky është modeli i Pejgamberit, por njëkohësisht edhe potenciali i çdo besimtari që pastron shpirtin dhe ecën në rrugën e Zotit. Pra, racionaliteti është kusht i domosdoshëm për të hyrë në humanitet, por jo i mjaftueshëm. Nëse mbetet vetëm në nivelin e mendimit, njeriu rrezikon të kufizohet dhe të përdorë arsyen edhe për shkatërrim, siç e pohon edhe Heidegger te kriza e teknologjisë. Vetëm kur mendimi bashkohet me moralin dhe shpirtin, dhe kur orientohet drejt Zotit, njeriu arrin përmbushjen e tij të plotë si njeri i përmbushur.



DEIZMI DHE AGNOSTICIZMI SI FORMA TË DEHUMANIZIMIT

Njeriu modern, në kuptimin e plotë të fjalës, është produkt i modernizmit, i cili u shfaq që në epokën e Rilindjes. Për këtë arsye, shpesh ai identifikohet si "Njeriu i Rilindjes". Në këtë figurë historike shfaqet për herë të parë shkëputja e qartë nga e shenjta dhe nga Zoti, duke e vendosur njeriun në qendër të gjithësisë.

Në modernitet, antropocentrizmi ka zëvendësuar theocentrizmin dhe njeriu e sheh veten si qendër të gjithësisë. Kjo liri absolute nuk është liri, por robëri ndaj pasioneve dhe teknologjisë. Në këtë kuptim, moderniteti nuk e çliron njeriun, por e dehumanizon. Në traditë, dija mbi të shenjtën është burimi i vlerës së njeriut. Kur kjo dije humb, humb edhe dinjiteti. Ky është mesazhi i Kuranit: "Ata që harruan Allahun, pra (Allahu bëri që ata) harruan vetveten." (El Hashr, 19). Pra, dehumanizimi është pasojë e drejtpërdrejtë e harrimit të Zotit.

Tradicionalisht, njeriu modern është barazuar me figurën mitologjike të Prometeut (ai që u rebelua kundër zotave dhe u përpoq të vjedhë zjarrin për t'ia dhënë njerëzve). Prometeu simbolizon njeriun që "vret" Hyjninë për të marrë vetë rolin e Zotit. Ky është thelbi i mendësisë moderne, refuzimi i shenjtërisë dhe vendosja e njeriut si autoritet absolut. Në këtë kuptim, shprehja e Nietzsches "Zoti vdiq" është shprehja më radikale e njeriut modern prometeian.

Për njeriun modern, realiteti kufizohet vetëm në atë që shihet dhe matet dhe kjo është bota fizike dhe e dukshme. Çdo gjë tjetër, që nuk mund të përkthehet në kategori kuantitative, shpallet si e parëndësishme ose e pavërtetë. Në këtë kuptim, moderni është një njeri që e sheh edhe trupin e vet si objekt fizik dhe e vlerëson vetëm në aspektin sasior, jo cilësor. Kjo përmbysje e përparësisë së cilësisë ndaj sasisë është një nga shenjat më të qarta të dehumanizimit modern.

Njeriu modern, duke shpallur "vdekjen e Zotit", pretendon të luajë vetë rolin e Tij. Ai beson se përmes shkencës dhe teknologjisë mund të shpëtojë jo vetëm veten, por edhe botën. Megjithatë, paradoksi qëndron në faktin se ai nuk është në gjendje të shpëtojë as vetveten nga krizat morale, shpirtërore dhe ekzistenciale që ka krijuar, e lëre më të shpëtojë të tjerët. Kjo është shenja e qartë e iluzionit prometeian, pra arroganca për të zëvendësuar Hyjninë, ndërkohë që bota përballet me humbje kuptimi, shkatërrim natyre dhe shpërbërje shoqërore. Në vend që të forcojë humanitetin, ai e ka dobësuar atë, duke e reduktuar

ekzistencën vetëm në horizontin material dhe sasior. Ky proces është thelbi i dehumanizimit modern pra humbja e lidhjes me Zotin, që e lë njeriun të zhveshur, bosh dhe të mashtruar nga iluzioni i një lirie absolute.

Kësaj qasjeje prometeiane i ndihmoi shumë ateizmi së bashku me mendimin materialist. Ideologjia materialiste u mundua ta ndërpres çdo raport të njeriun me hyjnoren, e po ashtu me gjithçka metafizike. Një ndikim po ashtu të madh i dha edhe deizmi, i cili e pranon Zotin si krijues dhe arkitekt të madh të universit, por e mohon ndërhyrjen e Tij dhe shpalljen. Njeriu nuk ka ma një referencë transcendente duke mbetur vetëm me racionalizëm dhe i zbrazët. Agnosticizmi nuk e mohon Zotin, por e bën të parëndësishëm. Ky qëndrim prodhon një njeri që jeton sikur Zoti të mos ekzistonte. Njeriu e organizon jetën pa pas referenca metafizike, edhe pse në mënyrë kategorike nuk i mohon ato.

Në modernitet, antropocentrizmi ka zëvendësuar theocentrizmin dhe njeriu e sheh veten si qendër të gjithësisë. Kjo liri absolute nuk është liri, por robëri ndaj pasioneve dhe teknologjisë. Në këtë kuptim, moderniteti nuk e çliron njeriun, por e dehumanizon.

KRITIKA NDAJ DEHUMANIZIMIT

Heideggeri e interpreton krizën moderne si pasojë të harrimit të së Shenjtës, ku teknologjia e kthen njeriun në resurs dhe e zhvesh nga dimensioni shpirtëror. Për të, mund të thuhet se deizmi dhe agnosticizmi janë forma të harrimit, ku Zoti bëhet ose i tërhequr, ose i parëndësishëm, dhe si pasojë njeriu humb vetveten. Në një intervistë të famshme ai potenconte se pas kësaj katrahure vlerore, "Vetëm një Zot mund të na shpëtojë." Kjo tregon shumë për rrugëtimin e njeriut në procesin e dehumanizimit. Mendimtarë bashkëkohorë si Sejid Husein Nasr, Muhamed Ikball dhe Alasdair MacIntyre, e shohin modernitetin si krizë shpirtërore dhe morale. Nasr e përshkruan zhveshjen e natyrës dhe njeriut nga shenjtëria si shenjë të dehumanizimit. Njeriu ka shenjtëri vetëm nëse ka raport me metafiziken dhe hyjnoren. Ikballi kritikon reduktimin e njeriut në makinë ekonomike duke e zhveshur nga cilësitë njerëzore duke theksuar se vetëm lidhja me Absolutin e bën atë krijues e të lirë. MacIntyre e quan modernitetin epokë të zhveshur nga identiteti moral. Këto perspektiva e shohin qartë se pa lidhje me Zotin, njeriu humb vlerën dhe dinjitetin e vet dhe si përfundim mund të përfundojë në dehumanizim.

PËRFUNDIM

Nga perspektiva tradicionale, njeriu është vërtet njeri vetëm kur është në marrëdhënie me Zotin. Nga kjo perspektivë del qartë se dehumanizimi nuk është një fenomen i thjeshtë, por pasojë e drejtpërdrejtë e shkëputjes së njeriut nga dimensioni i shenjtë. Tradita klasike e shihte njeriun si qenie të marrëdhënies, që vetëm në bashkësi dhe në orientim vertikal drejt hyjnores arrin përkufizimin e vet të plotë. Tradita islame e përforcon këtë vizion duke e cilësuar njeriun si halife në tokë, bartës të amanetit hyjnor dhe pasqyrim të atributeve të Krijuesit. Kur ky raport prishet, njeriu e humb dinjitetin e vet dhe rrëshqet drejt zbrazëtisë ekzistenciale. Moderniteti, me antropocentrizmin e vet, e ka zëvendësuar theocentrizmin dhe ka krijuar një njeri prometeian, që shpall "vdekjen e Zotit" dhe pretendon të luajë rolin e Tij. Ky proces nuk e çliroi njeriun, por e dobësoi atë, duke e reduktuar ekzistencën vetëm në dimensionin material. Ateizmi, deizmi dhe agnosticizmi, duke e bërë Zotin të tërhequr ose të parëndësishëm, e kanë thelluar këtë krizë dhe e kanë lënë njeriun pa orientim transcendental. Prandaj, përfundimi i natyrshëm është se njeriu arrin humanitetin e tij të plotë vetëm nëse e rivendos raportin me të shenjtën dhe e njeh veten si krijesë të Zotit. Vetëm në këtë mënyrë ai del nga iluzioni i lirisë absolute dhe e realizon veten si njeri i përmbushur, ku arsyeja, morali dhe shpirti bashkohen në një harmoni të udhëhequr nga hyjnorja. Nëse ky dimension humbet, njeriu rrezikon të kthehet në një qenie të zbrazët, të dehumanizuar, të paqëndrueshme. Prandaj, shpëtimi i njeriut dhe i njerëzimit qëndron në rikthimin e lidhjes me Zotin aty ku është burimi i dinjitetit dhe kuptimit të vërtetë njerëzor.

Referenca

1. Aristoteles, Politika,çev. Mete Tunçay; Remzi Kitapevi yay. 15. Baskı İstanbul 2012
2. Aristoteles 1997 Aristoteles, Nikomakhos'a Etik (Çev: Saffet Babür), Ayraç Yayınevi, Ankara.
3. Heidegger, Martin. "Nur noch ein Gott kann uns retten." Interview with Der Spiegel, 1966 (published 1976).
4. Nasr, Seyyed Hossein. Man and Nature: The Spiritual Crisis of Modern Man. Chicago: ABC International Group, 1997.
5. Iqbal, Muhammad. The Reconstruction of Religious Thought in Islam. Stanford: Stanford University Press, 2013 (orig. 1930).
6. MacIntyre, Alasdair. After Virtue. Notre Dame: University of Notre Dame Press, 1981.
7. Bauman, Zygmunt. Liquid Modernity. Cambridge: Polity Press, 2000.
8. Taylor, Charles. A Secular Age. Cambridge, MA: Harvard University Press, 2007.



Mosndarja e kohës me fëmijët si faktor i lajthitjes së tyre në jetë

Adlie Morina-Krasniqi

Në shoqërinë e sotme, prindërit shpeshherë janë të angazhuar me punë, detyra dhe presione të ndryshme, duke e lënë në plan të dytë kalimin e kohës me fëmijët e tyre. Por, kjo mungesë vëmendjeje dhe afërsie emocionale nuk është thjesht një shqetësim i vogël, por një faktor madhor që ndikon thellësisht në zhvillimin e fëmijëve. Nga një perspektivë psikologjike dhe islame, kjo braktisje emocionale mund t'i shtyjë fëmijët drejt lajthitjes, zbrazëtisë shpirtërore dhe sjelljeve problematike.

Pejgamberi Muhamed a.s., ka thënë: "Secili prej jush është bari dhe secili do të pyetet për kopenë e tij." (Buhariu, Muslimi). Ky hadith na kujton se përgjegjësia prindërore është e madhe dhe kërkon kujdes të vazhdueshëm dhe kohë të kushtueshme në edukimin e fëmijëve.

Fëmijët kanë një nevojë të lindur për të krijuar lidhje të forta emocionale me kujdestarët e tyre. Kjo lidhje shërben si një "bazë e sigurt" nga e cila fëmija mund të eksplorojë botën...

PERSPEKTIVA PSIKOLOGJIKE

Mosndarja e kohës cilësore është një nga shkaktarët kryesor të lajthitjes dhe zbrazëtisë shpirtërore te brezat e rinj, duke krijuar një boshllëk emocional dhe moral. Teoria e lidhjes (Attachment Theory), e zhvilluar nga John Bowlby dhe Mary Ainsworth, është themeli për të kuptuar se si ndërveprimi i hershëm prind-fëmijë ndikon në zhvillimin emocional dhe social. Në thelb, kjo teori thotë se fëmijët kanë një nevojë të lindur për të krijuar lidhje të forta emocionale me kujdestarët e tyre. Kjo lidhje shërben si një "bazë e sigurt" nga e cila fëmija mund të eksplorojë botën, duke ditur se ka një person të besueshëm tek i cili mund të kthehet për mbështetje, rehati dhe mbrojtje.

Një studim i kryer nga Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) në ShBA (2016), zbuloi se mungesa e përfshirjes prindërore është një faktor i rëndësishëm rreziku për sjelljet e rrezikshme tek adoleshentët, duke përfshirë përdorimin e duhanit, alkoolit dhe drogave, si dhe sjelljet me rrezik të lartë seksual. Kjo mungesë krijon një boshllëk në ndjenjën e përkatësisë dhe vlerës së fëmijës, duke e bërë atë të prekshëm ndaj ndikimit negativ të shoqërisë. Po ashtu ajo ndikon në mungesën e vetëvlerësimit, duke ndikuar që fëmijët që ndihen të braktisur emocionalisht shpesh të kenë një ndjenjë të ulët të vetëvlerësimit dhe besojnë se dashuria dhe vëmendja fitohen vetëm me sjellje negative. Një ndikim tjetër negativ është edhe varësia nga grupi shoqëror. Kur familja nuk ofron një pikë referimi të fortë, fëmija bëhet më i ndjeshëm ndaj ndikimit të shoqërisë. "American Journal of Orthopsychiatry" ka botuar

studime, që tregojnë se adoleshentët me marrëdhënie të dobëta familjare kanë më shumë gjasa të përfshihen në sjellje të rrezikshme si përdorimi i substancave apo kriminaliteti dhe mund të kenë probleme të shëndetit mendor si: mungesa e stabilitetit emocional që rrit ndjeshëm rrezikun për probleme si depresioni, ankthi dhe çrregullime të tjera psikologjike.

Një punim kërkimor i titulluar "The Power of Parental Involvement" (Fuqia e Përfshirjes Prindërore) nga Universiteti i Harvardit (2018), tregon se angazhimi aktiv i prindërve është një nga faktorët më të rëndësishëm në parashikimin e suksesit akademik dhe personal të fëmijëve. Këto studime tregojnë se fëmijët me prindër të angazhuar kanë aftësi më të mira për zgjidhjen e problemeve, ata kanë shanse më të vogla për të pasur sjellje agresive, apo për të përdorur alkool dhe drogë në adoleshencë. Kjo lidhje ndikon pozitivisht edhe në shëndetin fizik dhe emocional të prindërve. Ky studim konfirmon se prindërimi efektiv kërkon prezencë dhe ndërveprim të vazhdueshëm. Kur prindërit mungojnë fizikisht apo emocionalisht, fëmija shpesh ndihet i braktisur dhe i pafuqishëm. Kjo mungesë e vëmendjes dhe afërsisë i shtyn ata drejt rrugëve të gabuara. Ngjashëm, një studim i bërë në Kinë me fëmijët e lënë pas dore nga prindërit e tyre, tregoi rezultate më të ulëta në testet njohëse dhe akademike, dhe të tillët u vlerësua se kanë më pak gjasa të ndjekin arsim të lartë. Mungesa e nënës duket se ka efekte negative afatgjata në zhvillimin e fëmijëve. Kjo mungesë mund të çojë në shëndet më të dobët mendor dhe përpjekje të reduktuara në klasë, duke kontribuar në vonesa të përgjithshme zhvillimore (Mao et al., 2020). Po ashtu, stresi prindëror mund të përkeqësojë problemet e sjelljes dhe emocionale te fëmijët. Konflikti familjar, shpesh i nxitur nga stresi prindëror, është identifikuar si një ndërmjetës në këto rezultate negative. Sigurimi i një mjedisi mbështetës familjar, duke menaxhuar stresin prindëror dhe duke zvogëluar konfliktet familjare është thelbësor në mbrojtjen e zhvillimit të fëmijëve, veçanërisht midis familjeve në rrezik të keqtrajtimit të fëmijëve (Jones et al., 2021).

Sjelljet negative të prindërimit, të tilla si armiqësia ose ndëshkimi trupor, gjithashtu kanë efekte negative te fëmijët. Studimet theksojnë se sjellje të tilla mund të çojnë në probleme sjelljeje, veçanërisht te fëmijët me temperamente sfiduese. Ulja e përdorimit të ndëshkimit trupor mund të përmirësojë shëndetin mendor dhe sjelljen e fëmijëve (Boyle et al., 2004; Mulvaney dhe Mebert, 2007). Për më tepër, kur fëmijët përballen me burgim prindëror, ata janë në rrezik më të lartë për sjellje antisociale, probleme të shëndetit mendor dhe dështime akademike. Rezultate të tilla lidhen me traumën e ndarjes, stigmën dhe presionin ekonomik. Ndikimi është më i thellë kur prindi i burgosur është nëna, ose kur dënimi me burg është i gjatë (Murray dhe Farrington, 2008).

Fëmijët që përjetojnë neglizhencë emocionale dhe neglizhencë në prezencë fizike, kanë më shumë gjasa të përballen me sfida të shëndetit mendor, si: ankthi, depresioni dhe vetëvlerësimi i ulët.

Gjithashtu, edhe pritjet prindërore ndikojnë shumë në rezultatet arsimore të një fëmije. Pikëpamjet e prindërve për sjelljen e fëmijëve të tyre mund të paragjykojnë pritjet arsimore, të cilat nga ana tjetër ndikojnë në arritjet akademike. Pritjet më të ulëta prindërore për shkak të problemeve të perceptuara të sjelljes mund të ulin performancën e një fëmije, pavarësisht aftësive të tyre aktuale (Rutchick et al., 2009).

Studimet tregojnë se fëmijët që përjetojnë neglizhencë emocionale dhe neglizhencë në prezencë fizike, kanë më shumë gjasa të përballen me sfida të shëndetit mendor, si: ankthi, depresioni dhe vetëvlerësimi i ulët. Këto pasoja nuk kufizohen vetëm te fëmijët e neglizhuar; ato shtrihen në marrëdhëniet, komunitetet dhe kulturën që ata ndihmojnë të formojnë.

Pikërisht në këtë boshllëk lindin dështimet ndër-breznore dhe mbijnë farat e neglizhencës emocionale. Pasojat përhapen si valë: të rritur që luftojnë me intimitetin, fëmijë që kërkojnë vlerësim në arritje të jashtme dhe shoqëri të ndërtuara mbi dëshpërim të heshtur.

Për të adresuar këtë problem, është thelbësore të pranohet se neglizhenca emocionale është një çështje sistemike që kërkon ndërhyrje të gjera, përfshirë masa sociale dhe ekonomike që promovojnë mirëqenien emocionale. Kjo përfshin rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e shëndetit emocional, mbështetjen për prindërit në zhvillimin e aftësive emocionale dhe krijimin e politikave që lehtësojnë presionet mbi familjet.

Në fund, për të transformuar marrëdhëniet dhe për të shëruar plagët emocionale ndër-breznore, duhet të kthehemi tek ajo që ka vërtet rëndësi: ndërtimi i lidhjeve të sigurta dhe të thella me të tjerët.

PERSPEKTIVA ISLAME

Feja islame i jep rëndësi të veçantë përgjegjësisë prindërore. Pejgamberi a.s., pavarësisht angazhimeve të tij si udhëheqës i umetit, gjente gjithmonë kohë për t'u marrë me nipërit e tij, Hasanin dhe Husejnin, duke na treguar se koha me fëmijët është një formë e vërtetë e adhurimit (ibadetit). Kur një prind nuk kalon kohë me fëmijën ka pasojat e veta si: *dobësohet imani* – nëse prindi nuk merr kohën për të edukuar fëmijën me vlera islame, moral dhe dashuri për Allahun, fëmija do të mësojë nga rruga, interneti ose grupet shoqërore, dhe shpeshherë do të largohet nga

rruga e drejtë; *humbet amaneti – s*iç thotë Allahu në Kuran: *“O ju që besuat! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri.”* (Et Tahrim, 6), edukimi dhe udhëzimi i fëmijëve është një detyrë që do të na kërkohet llogari në Ditën e Gjykimit. Mungesa e vëmendjes për fëmijët tregon një lënie pas dore të këtij amaneti të rëndësishëm. Ka edhe shumë hadithe të tjera, që përshkruajnë rëndësinë e edukimit të fëmijëve. Një shembull tjetër është ai i transmetuar nga Imam Ahmedi: “*Urdhërojini fëmijët tuaj për namaz që nga mosha 7-vjeçare...*” Ky hadith tregon se prindërit duhet të jenë aktivë në edukimin e fëmijëve që në moshë të hershme.

Në Islam, mungesa e prindërve në edukimin e fëmijës është një neglizhencë e rëndë. Pejgamberi a.s., ka theksuar rëndësinë e të qenit shembull. Në hadithin e transmetuar nga Enesi, Pejgamberi a.s., ka thënë: “Bëhuni të butë me fëmijët, i doni ata dhe i drejtoni ata (në rrugë të drejtë).” (Transmetuar nga Ibën Maxhe). Ky hadith thekson se prindërimi nuk është thjesht një detyrë, por kërkon butësi dhe dashuri. Kur një prind nuk kalon kohë me fëmijën, nuk mund t’i transmetojë me efikasitet parimet e Islamit, moralin dhe dashurinë për Allahun.

Koha që prindërit kalojnë me fëmijët e tyre luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e lajthitjes dhe sjelljeve delikuente. Studimet tregojnë se programet e hershme të trajnimit prindëror mund të zvogëlojnë sjelljet problematike, përfshirë sjelljen antisociale dhe delikuencën. Një analizë tregoi se trajnimi i tillë është një ndërhyrje efektive për uljen e problemeve të sjelljes te fëmijët e vegjël, duke ndikuar gjithashtu në reduktimin e delikuencës dhe kriminalitetit gjatë adoleshencës dhe më vonë (Piquero et al., 2009).

Një tjetër hulumtim demonstron se kalimi nëpër periudha të pasigurta familjare, si ndryshimet e figurës prindërore, janë të lidhura me rritjen e gjasave për sjellje delikuente tek adoleshentët me prindër të varur nga substancat (Keller et al., 2002). Ndërkohë, një marrëdhënie e fortë prind-fëmijë dhe mbikëqyrja adekuate prindërore janë kritike për parandalimin e delikuencës. Studimet tregojnë një marrëdhënie reciproke ndërmjet ndjeshmërisë prindërore dhe delikuencës, ku ndjenja e prindërve dhe lidhja e fortë mund të ndihmojnë në reduktimin e sjelljeve të padëshiruara (Gault- Sherman, 2011).

Programet e hershme për fëmijëri që ofrojnë mbështetje intensive për familjen dhe arsim të hershëm kanë treguar efekte afatgjata në sjelljen antisociale ose delikuente, duke u bërë një element kyç në uljen e përhapjes së delikuencës (Yoshikawa, 1995). Pra, investimi në kohën prind-fëmijë me elementë si: trajnimi i sjelljes prindërore, ndjenja e lidhjes dhe mbështetjes, mund të jetë shumë efektiv në menaxhimin dhe parandalimin e delikuencës te të rinjtë.

NGRITJA E THEMELEVE PËR NJË JETË TË LUMTUR DHE TË SHËNDETSHME

Fëmija juaj kërkon dashuri, mësim dhe siguri. Mundohuni të kaloni sa më shumë kohë cilësore së bashku. Nxitja e një marrëdhënieje të ngrohtë dhe të butë dhe ndihma e fëmijës suaj të ndihet i sigurt dhe nën kujdes, është një rrugë e gjatë për t’i hedhur bazat për një shëndet të mirë mendor gjatë gjithë jetës.

Foshnjat

Kalimi i kohës cilësore me fëmijën tuaj është e mirë për të dy. Kjo madje çliron hormone natyrale, të cilat ju ndihmojnë të lidheni me fëmijën tuaj dhe ta përmirësoni mirëqenien për të dy.

Luani me ta dhe përkëdhelni,

Flisni me ta, këndojuni,

Përgjigjuni tingujve të tyre me fjalë në mënyrë që ata të fillojnë ta kuptojnë gjuhën dhe komunikimin.

Fëmijët e vegjël

Derisa fëmija juaj fillon të lëvizë më shumë, dëshira e tij për të eksploruar vazhdon të rritet. Kjo kureshtje ka nevojë për edukim dhe inkurajim.

Lexojini fëmijës tuaj (çdo ditë nëse mundeni),

Luani lojëra që përfshijnë kuriozitetin dhe të mësuarit e tyre,

Kërkojini fëmijës suaj t’i emërtojë gjërat – filloni me emrin e tyre dhe objektet përreth, le të jenë emërtime të thjeshta,

Eksploroni së bashku mjedisin jashtë shtëpisë tuaj.

Fëmijët e moshës parashkollore

Përderisa fëmija juaj bëhet më i pavarur dhe më kureshtar, ai do të dëshirojë ta eksplorojë botën jashtë dhe të mësojë për gjërat rreth tij. Ndërveprimet me njerëzit do t’iu ndihmojnë fëmijëve t’i zhvillojnë mënyrat e tyre të të menduarit dhe ta kuptojnë botën përreth tyre.

Inkurajoni ndërveprimin social përmes lojës me fëmijët e tjerë,

Ftojini ata t’ju ndihmojnë me punët e thjeshta të përshtatshme për moshën e tyre. Drejtojini ata nëpër hapa për të zgjidhur probleme të thjeshta,

Vendosni kufij të qartë dhe pritshmëri realiste. Pas përgjigjes “jo” vazhdoni me alternativa për atë që do të preferonit ta bëjë,

Jepuni atyre zgjedhje të qarta që janë të lehta për t’u kuptuar, kur të merrni vendime se çfarë të hanë, çfarë të veshin apo çka të luajnë.

PËR ÇFARË DUHET TË KENI KUJDES

Fëmijët e vegjël mësojnë si ta shprehin veten dhe t’i menaxhojnë emocionet e mëdha. Kjo ndonjëherë mund të shkaktojë zemërim ose stres kur ata nuk mund t’i komunikojnë nevojat e tyre. Kur fëmijët ndihen të stresuar ose të mbingarkuar, ata kanë nevojë për një të rritur të dashur, që do t’i bëjë të ndjehen të sigurt dhe t’u ndihmojë t’i menaxhojnë ndjenjat e tyre.

Shmangni

Çdo formë të dhunës, duke përfshirë të bërtiturat dhe goditjet. Kur një fëmijë jeton në një mjedis negativ, kjo mund t'i shkaktojë "stres toksik" – që e dëmton rritjen dhe zhvillimin e fëmijës - si dhe shkakton probleme afatgjata në jetën e mëvonshme.

Debatet e shpeshta mes prindërve dhe njerëzve rreth fëmijës. Tensioni në ambientin familjar mund të jetë stresues për fëmijët – ata mund të ndihen të lënë pas dore, të pafuqishëm dhe të pambrojtur.

Çdo formë neglizhence. Fëmijët kanë nevojë për vëmendje, dashuri dhe kujdes të vazhdueshëm në mënyrë që të kenë rritje dhe zhvillim të shëndetshëm.

Bëni ibadet bashkë – falja e namazit me fëmijët, leximi i Kuranit apo leximi i historive të profetëve është një mënyrë e shkëlqyer për të lidhur shpirtin e fëmijës me fenë.

REKOMANDIME PRAKTIKE PËR PRINDËRIT

Për të mbrojtur fëmijët nga lajthitja, prindërit duhet të bëjnë një ndryshim të vetëdijshëm në stilin e tyre të jetesës. Ky ndryshim nuk kërkon sakrifica të mëdha financiare, por një riorganizim të prioriteteve dhe një përkushtim të vërtetë. Ja disa rekomandime praktike:

Planifikoni kohë çdo ditë – edhe 30 minuta bisedë, lexim ose lojë së bashku mund të forcojnë lidhjen prind-fëmijë. Kjo duhet të jetë kohë pa shpërqendrime, ku telefoni dhe detyrat e tjera lihen mënjanë. Kjo ka ndikim të madh në mirëqenien e fëmijëve.

Bëni ibadet bashkë – falja e namazit me fëmijët, leximi i Kuranit apo leximi i historive të profetëve është një mënyrë e shkëlqyer për të lidhur shpirtin e fëmijës me fenë.

Dëgjoni me vëmendje – fëmijët duan të ndjehen të dëgjuar. Dëgjoni me vëmendje shqetësimet dhe gëzimet e tyre pa i gjykuar. Kjo ndërton besim dhe siguri.

Jini shembull i gjallë – fëmijët mësojnë më shumë nga ajo që shohin sesa nga ajo që dëgjojnë. Jini një shembull i drejtësisë, mirësisë dhe përkushtimit ndaj Allahut. Aftësia juaj për të kontrolluar zemërimin, për të qenë të sjellshëm dhe përkushtimi juaj ndaj fesë janë mësime më të vlefshme sesa çdo ligjëratë.

PËRFUNDIM

Mosndarja e kohës me fëmijët është një nga shkaqet kryesore të lajthitjes së tyre. Ajo i privon ata nga dashuria, vëmendja dhe udhëzimi moral, duke i lënë të ndjeshëm ndaj ndikimeve të jashtme dhe të gabuara. Nga perspektiva psikologjike, kjo mungesë dëmton shëndetin emocional dhe social të fëmijëve, duke e bërë më të vështirë për ta krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme në të ardhmen. Për më tepër, nga këndvështrimi islam, mosndarja e kohës përbën një mungesë të amanetit që Allahu u ka besuar prindërve. Kjo neglizhencë, jo vetëm që pengon transmetimin e vlerave islame, por gjithashtu e lë fëmijën të ndjeshëm ndaj ndikimeve negative të mjedisit.

Prania e prindërve nuk është luks, por një nevojë thelbësore për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Përmes kohës së kaluar së bashku, prindërit ndërtojnë një lidhje të fortë emocionale dhe një bazë të sigurt për fëmijën, duke e ndihmuar atë të zhvillojë vetëvlerësim dhe identitet të qartë. Ashtu siç dëshmon sjellja e Pejgamberit a.s., koha me fëmijët është një akt i adhurimit, që forcon jo vetëm familjen, por edhe shoqërinë në tërësi.

Referencat:

1. Bowlby, John. "Union and Loss: Retrospect and Perspective". American Journal of
2. Orthopsychiatry 52 (1982): 664–678. https://doi.org/10.1111/j.1939-0025. 1982.tb01456.x
3. Holly Kreider, "Family Involvement: What Else". Harvard Family Research Project, July 24,
4. 2006,https://archive.globalfrp.org/publications-resources/browse-our-publications/family involvement-what-does-research-say.
5. Mao, Mingzhi, Lijun Zang, and Haifeng Zhang. 2020. "Effects of Parental Absence on Child Development: Evidence from Back-Injured Children in China." International Journal of Environmental Research and Public Health 17, no. 18: 6770. https://doi.org/10.3390/ijerph17186770
6. Jones, James H., TA Call, SN Wolford, et al. 2021. "Stresi prindëror dhe rezultatet e fëmijëve: Roli ndërmjetësues i konfliktit familjar." Journal of Child and Family Studies 30: 746–756. https://doi.org/10.1007/s10826-021-01904-8.
7. Boyle, Michael H., Jennifer M. Jenkins, Katholiki Georgiades, John Cairney, Eric Duku, Y. 2004.
8. "Differential Maternal Parenting Behavior: Assessing Within- and Between-Family Effects on Children." Child Development 75: 1457–1476. https://doi.org/10.1111/j.1467-
9. 8624.2004.00751.x.
10. David P. Farrington. 2008. "The Effects of Parental Incarceration on Children." Crime and
11. Justice 37 (1): 133–206. https://doi.org/10.1086/520070
12. Rutchick, Abraham M., Leonard M. Lopoo, Jordan B. Dusek, and Joshua M. Smyth. 2009. "High Expectations: The Prejudicial Effects of Reported Child Behavior Problems on Educational Expectations and Later Academic Achievement." Journal of Social and Clinical Psychology 28 (3): 392–413. https://doi.org/10.1521/jscp.2009.28.3.392
13. Piquero, Alex R., Wesley G. Jennings, David P. Farrington, Richard Tremblay, and Brandon C. Welsh. 2009. "Effects of Early Family/Parent Training Programs on Antisocial Change and Delinquency." Journal of Experimental Criminology 5 (2): 83–120. https://doi.org/10.1007/s11292- 009-9072-x.
14. Keller, Thomas E., Richard F. Catalano, Kevin P. Haggerty, and Charles B. Fleming. 202. "Transitions of Parental and Delinquent Figures and Their Use of All Adolescent Children of Substance Abusers." American Journal of Drug and Alcohol Abuse 28 (3): 399–427. https://doi.org/10.1081/ada-120006734.
15. Gault-Sherman, Maia. 2011. "It's a Two-Way Street: The Bidirectional Relationship between Parenting and Delinquency." Journal of Youth and Adolescence 41 (2): 121–145. https://doi.org/10.1007/s10964-011-9656-4.
16. Yoshikawa, Hirokazu. 1995. "Long-term effects of early childhood programs on social outcomes
17. and delinquency." The Future of Children 5 (3): 51. https://doi.org/10.2307/1602367.

Kush i dha fund skllavërisë, Islami apo Perëndimi?

Dija Halid

Pyetja se kush i dha fund skllavërisë kërkon një lexim historiko-ekonomik: Islami e rregulloi institucionin, por nuk e shfuqizoi plotësisht, ndërsa Perëndimi e mbylli kur u bë ekonomikisht e kushtueshme dhe pa vlerë tregu.

Kjo pyetje shpeshherë i vë në një pozicion të vështirë shumë predikues dhe hoxhallarë. Edhe pse një gjë e tillë është e lehtë që të shpjegohet, ngase sistemi i skllavërisë ishte pjesë e strukturës shoqërore të të gjitha shoqërive, ndërsa Islami e kodifikoi dhe e rregulloi këtë institucion në një mënyrë të pashembullt nga çdo sistem moral i mëparshëm – kjo edhe sipas dëshmisë së shumë orientalistëve – mirëpo, kjo nuk i përgjigjet pyetjes: "Kush i dha fund skllavërisë, Islami apo Perëndimi?" Kjo pyetje ka dimensione humanitare që kërkon përgjigje gjatë adresimit të kësaj çështjeje. Sepse, edhe nëse themi se Islami punoi për të tharë-prerë burimet e skllavërisë dhe për të shmangur një tronditje ekonomike duke i dhënë fund plotësisht asaj, prapëseprapë ka dy probleme me këtë argument:

Së pari: Edhe pse Islami punoi për të rregulluar dhe kodifikuar institucionin e skllavërisë, ai nuk e përfundoi atë ose nuk e ndaloi atë plotësisht.

Së dyti: Nëse Islami synonte ta zhdukte plotësisht këtë fenomen, pse nuk ka mbaruar ai trembëdhjetë shekuj pas ardhjes së Islamit? Pse bota islame kishte nevojë që Perëndimi ta përfundonte dhe ta ndalonte këtë fenomen? Grupi tjetër do të thoshte: "Ju thoni se Islami nuk e ndaloi skllavërinë për shkak të kostos së lartë ekonomike të ndalimit të saj për shoqërinë, por Perëndimi e ndaloi skllavërinë pavarësisht asaj kostoje të lartë ekonomike. Prandaj, humanizmi i Perëndimit është më superior ndaj humanizmit islam." Përballë këtij argumenti të fuqishëm, disa nuk janë në gjendje të përgjigjen. Nuk ka asnjë përgjigje logjike nga brenda sistemit fetar që shpjegon pse Islami nuk i dha fund skllavërisë, ndërsa Perëndimi e bëri.

E vërteta është se ekziston një përgjigje për këtë pyetje komplekse, por ajo nuk vjen nga brenda trashëgimisë fetare, por nga matricat e historisë dhe figurave ekonomike. Fenomeni i skllavërisë është një fenomen historik dhe ekonomik "par excellence", dhe të kuptuarit e

shfaqjes dhe zhdukjes së saj kërkon domosdoshmërish njohje dhe kuptim të këtyre dy disiplinave. Prandaj, shumë hoxhallarë, predikues dhe mendimtarë islamë ngurrojnë t'i përgjigjen kësaj pyetjeje për shkak të mungesës së kuptimit në këto dy disiplina. E vërteta është se që të dy këto disiplina, si ekonomia ashtu edhe historia, na tregojnë se Perëndimi nuk i dha fund skllavërisë për motive morale dhe humanitare, pavarësisht kostos së saj të lartë ekonomike. Përkundrazi, i dha fund asaj si rezultat i kostos së saj të lartë ekonomike dhe rënies së vlerës së tregut.

Para se ta diskutojmë pyetjen e kësaj eseje, është e rëndësishme të sqarojmë ndryshimin ndërmjet skllavërisë si një institucion historik i lidhur me luftën dhe skllavërisë së praktikuar në Evropën moderne, duke pasur parasysh ndryshimet e tyre në motive, shkaqe dhe natyrë, sepse këto ndryshime kontribuojnë në procesin e përfundimit të skllavërisë.

Ngritja në pushtet e memalikëve në Egjipt (ish-skllevër), tregon se skllavëria në Islam dallonte nga modeli modern kolonial evropian.

Shoqëritë e lashta mbështeteshin te sistemi i skllavërisë si pjesë e rregullimit shoqëror dhe ekonomik të atyre shoqërive, dhe kjo vazhdoi edhe pas ardhjes së Islamit, pavarësisht faktit se Islami bëri një përpjekje të madhe për ta përmbajtur fenomenin dhe për ta përmirësuar statusin e skllevërve. Në këtë drejtim, historiani Bodley, në librin e tij "*Jeta e Profetit Muhamed*", ka thënë: "Muhamedi e ktheu vëmendjen e tij te problemi i skllavërisë. Ai nuk kishte mundësi që ta ndalonte plotësisht skllavërinë, por ai i lehtësoi ligjet e skllavërisë dhe punoi për të inkurajuar lirimin e skllevërve. Ajo që ai urdhëroi ishte çlirimi i të gjithë atyre që u konvertuan në Islam. Ai shtoi në këtë urdhër se nuk ka stigmatizim të skllavit të liruar. Në fakt, skllavi i liruar, në Islam ka të gjitha mundësitë siç i ka një burrë ose një grua që kanë lindur të lirë."[1] Sigrid Hunke në librin e saj "*Allah ist ganz anders*", ka thënë: "Skllavëria tek arabët ishte më afër një shkëmbimi përfitimi ndërmjet dy palëve për të mbështetur të varfrit dhe për të mbajtur përgjegjësi ndaj të tjerëve."[2] Ngritja e memalikëve në pushtet në Egjipt, të cilët ishin skllevër, është argument i fuqishëm se institucioni i skllavërisë në Islam ishte krejtësisht i ndryshëm nga koncepti modern i skllavërisë së praktikuar nga fuqitë evropiane kundër popujve të kolonizuar, gjë që prodhoi një klasë shoqërore në Amerikë. Ish-kolonitë janë ende të bllokuara deri më sot në modelet dhe efektet e skllavërisë për shkak të shtypjes dhe shkatërrimit që u është shkaktuar atyre. Kjo skllavëri ishte e ndryshme nga çdo gjë tjetër në natyrë, motivime dhe shkallë. Megjithatë, përmirësimi i statusit të skllevërve dhe kufizimi i skllavërisë vetëm për robërit e luftës nuk e justifikon Islamin në sytë e modernistëve, as nuk e liron atë nga akuza e ruajtjes së skllavërisë në një kohë kur Perëndimi ishte në gjendje ta shfuqizonte atë.

Skllavëria, e cila mbeti edhe pas ardhjes së Islamit, ishte kryesisht një institucion i lidhur me luftën. Ishte mënyra se si fituesi sillej ndaj humbësit të luftës, duke siguruar që forca e palës së humbur të shpërndahej dhe që ai të mos ngrihej për të luftuar përsëri. Robërit e luftës shpërndaheshin si skllevër për t'i mbajtur nën mbikëqyrje dhe për të përfituar prej tyre në të njëjtën kohë. Islami ofronte një rrugëdalje përmes ligjeve të tij për të liruar skllavin si një mënyrë për të shlyer mëkatet, ose kur skllavi konvertohej në Islam, pasi kjo do të thoshte se ky individ ishte bërë pjesë e sistemit shoqëror. Lidhur me këtë, Zoti i Plotfuqishëm në Kuran thotë: "*Ata skllevër që gjenden në pushtetin tuaj e që kërkojnë të lirohen me shpërblim dhe ju kërkojnë aktlirimin, ua jepni, e nëse e dini që janë të mirë, jepuni diçka nga pasuria juaj, të cilën ju ka dhuruar Allahu.*" (En Nur, 33). Këto ligje, kur krahasohen me statusin e skllavërisë në perandoritë e asaj kohe, konsiderohen ligje shumë "progresive dhe humane". Në anën tjetër, skllavëria koloniale evropiane lindi dhe u zgjerua thjesht për arsye ekonomike. Skllevërit e zinj u përdorën për bujqësi dhe punë të rënda në numër të pashembullt në historinë e njerëzimit. Ata u transportuan përmes anijeve nga Afrika në Amerikë, ku u shtynë të hipnin në kushte që çuan në vdekjen e shumë prej tyre në ato anije. Meqenëse skllavëria koloniale motivohej nga fitimi dhe akumulimi i kapitalit, e jo nga domosdoshmëria e luftës, kjo i motivoi evropianët për të kërkuar dhe rrëmbyer në mënyrë sistematike skllevërit nga vendet e tyre, e pastaj për t'i transportuar ata në koloni, ku iu nënshtroheshin torturave më brutale për të maksimizuar potencialin e tyre për kultivimin e të korrave të mëdha në Amerikë.

Dallimi i dytë është se skllavëria e lashtë, përfshirë skllavërinë islame, nuk drejtohej nga ndonjë teori e superioritetit racor apo besime në dallimet biologjike midis njerëzve. Përkundrazi, ajo ishte – siç e përmendëm – e lidhur me makinerinë e luftës. Kjo shpjegon diversitetin e ngjyrave dhe formave të skllevërve në epokën islame, nga të bardhët tek aziatikët, nga të zinjtë tek arabët. Kjo nuk ishte për shkak të dëshirës së myslimanëve për të marrë konkubina të të gjitha racave, siç pretendojnë disa njerëz me qëllime të këqija. Përkundrazi, ishte thjesht sepse skllavëria nuk bazohej në racë, por në luftë, dhe në rastin e myslimanëve, në fe. Myslimanët, në fakt, theksonin skllavërinë e arabëve duke përjashtuar të tjerët, duke pasur parasysh se Kurani u shpall në gjuhën e tyre dhe Profeti erdhi prej tyre. Kështu, argumenti i Islamit kundër tyre ishte më i fortë.

Ndërsa skllavëria koloniale u legjitimua dhe u mbështet nga teoritë raciste që dominonin imagjinatën evropiane në atë kohë. Prandaj, evropianët i vunë në shënjestër afrikanët

për skllavëri më shumë se të tjerët, për shkak të besimit të tyre në inferioritetin e tyre në shkallën e njerëzimit. Këto ndryshime në natyrën e skllavërisë janë të rëndësishme në përcaktimin e rrethanave të skllavërisë. Skllavëria e bazuar në besimin fetar u çlirua lehtësisht duke u konvertuar në Islam dhe duke përqafuar besimin e ri, gjë që ishte rasti për shumë skllevër nën sundimin islam. Kurse skllavëria e bazuar në racë, mund të çlirohej vetëm duke ndryshuar ngjyrën e lëkurës së tyre. Kjo skllavëri racore i bëri evropianët të bëheshin brutalë në trajtimin e skllevërve. Ata i shihnin ata si më pak njerëzorë, gjë që i bënte të mos kursenin asnjë mundësi ose mjet për t'i torturuar dhe poshtëruar më tej. Ata i shihnin ata me syrin e njeriut si një kafshë, duke besuar atë që filozofi i Iluminizmit David Hume besonte kur tha: "Unë besoj se të zinjtë janë natyrshëm inferiorë ndaj të bardhëve."[3]

Skllavëria u nxit nga lakmia e pastër materiale, e cila erdhi si rezultat i braktisjes së fesë si një mënyrë jetese nga Evropa dhe miratimit të filozofive utilitare dhe materialiste, që legjitimuan skllavërinë bazuar në teoritë shkencore raciste.

Ata që bëjnë krahasimin ndërmjet Islamit dhe Perëndimit, vlerësojnë përparësinë e Perëndimit për heqjen zyrtare të skllavërisë si argument të progresit moral dhe etik të arritur nga Evropa gjatë epokave të Iluminizmit. Nëse kjo çështje do të ishte e ndërlidhur me çështje morali, atëherë ne do të kishim parë skllavërinë të binte gradualisht, ndërsa Evropa doli nga Mesjeta përmes epokës së iluminizmit duke arritur deri tek epoka moderne. Megjithatë, shifrat nuk e pasqyrojnë këtë. Teksa Evropa doli nga "epoka e errët", ajo i paraqiti botës një lloj të ri skllavërie brutale, të paparë në duart e fuqive evropiane. Edhe më e habitshme është fakti se shkalla e skllavërisë u rrit midis shekullit të pesëmbëdhjetë deri në periudhën e heqjes së saj në shekullin e nëntëmbëdhjetë nga vendet evropiane, ndërsa evropianët adaptoheshin më shumë me idetë e Iluminizmit. Kjo marrëdhënie e drejtpërdrejtë ndërmjet rritjes së skllavërisë dhe ngritjes së ideve të Iluminizmit nuk i shërben narratives së motivimeve morale pas heqjes së skllavërisë. Në të vërtetë, sa më e ndriçuar bëhej Evropa, aq më brutale dhe skllavëruese bëhej. Pastaj, papritmas, brenda periudhës pesëdhjetë vjeçare, vendet evropiane filluan të heqin skllavërinë një nga një. Cila është arsyeja pas kësaj? Kjo dilemë mund të kuptohet lehtësisht nëse e shohim çështjen nga një perspektivë thjesht ekonomike – dhe jo nga një perspektivë morale – që gjurmon marrëdhënien midis zhvillimit të shtetit modern në Evropë dhe asaj që po ndodhte në kolonitë evropiane, si dhe marrëdhënies së këtyre kolonive me skllavërinë. Zgjerimi i shtetit modern në Evropë ishte rezultat i fluksit të thesareve të mëdha nga kolonitë evropiane, kryesisht në formën e arit të vjedhur nga popujt e kolonizuar të Amerikave gjatë shekujve të parë të eksplorimit. Ky fluks thesaresh mundësoi prosperitetin ekonomik, i cili siguroi shfaqjen e mendimtarëve të Iluminizmit me filozofitë e tyre raciste dhe materialiste në raport me njeriun. Me nxitjen ekonomike, këta filozofë legjitimuan zgjerimin e skllavërisë për të realizuar fitimet ekonomike të ofruara nga puna e lirë e skllevërve. Skllavëria u nxit nga lakmia e pastër materiale, e cila erdhi si rezultat i braktisjes së fesë si një mënyrë jetese nga Evropa dhe miratimit të filozofive utilitare dhe materialiste, që legjitimuan skllavërinë bazuar në teoritë shkencore raciste.

Skllavëria krijoi një model ekonomik që e pasuroi Evropën në një mënyrë të paparë. Imagjinoni të keni tokë të pafundme dhe një fuqi punëtore të pafundme. Çfarë pasurie mund të krijoni? Grumbullimi i pasurisë, i cili vinte nga kolonitë, çoi në shfaqjen e kapitalit evropian të paparë në historinë e njerëzimit. Ky grumbullim kapitali stimuloi hulumtimin dhe shpikjen, duke i dhënë kështu jetë Revolucionit Industrial. Nuk është rastësi që Britania, e cila ishte një perandori mbi të cilën 'dielli nuk perëndonte asnjëherë', ishte qendra kryesore e skllavërisë në botë dhe, në të njëjtën kohë, djepi i Revolucionit Industrial.

Revolucioni Industrial krijoi një model të ri ekonomik të quajtur "kapitalizëm", një model i bazuar në prodhim, inovacion dhe konkurrencë të tregut të lirë, që e shndërron gjithçka në një mall të tregueshëm. Sipas Adam Smith (babait të kapitalizmit), kapitalizmi mund të funksionojë siç duhet vetëm nëse tregu lihet në mëshirë të fatit, pa ndërhyrje nga ndonjë entitet qeveritar ose joqeveritar. Sipas vetë teorisë kapitaliste, të gjitha hyrjet dhe daljet në treg duhet të trajtohen si mallra, çmimet e të cilave përcaktohen nga tregu bazuar në parimin e ofertës dhe kërkesës, duke përfshirë edhe dorën punëtore, ku edhe ajo (dora punëtore) duhet të qeveriset nga forcat e fshehura të tregut. Nëse ky ekuacion ndërpritet për ndonjë arsye, i gjithë sistemi ekonomik do të shembet. Për shembull, nëse ka një kërkesë të lartë për një mall të caktuar, ai mall do të përcaktojë çmimin e tij sipas asaj kërkese dhe sasisë së ofruar. Nëse kërkesa rritet dhe sasia zvogëlohet, atëherë çmimi do të ngritët, duke e inkurajuar tregtarin ose tregtarët e tjerë të prodhojnë mallra të ngjashme. Kjo rrit ofertën e atij malli krahasuar me kërkesën e tij, dhe çmimi i tij ulet derisa të arrijë gjendjen e ekuilibrit ku oferta është e barabartë me kërkesën, dhe çmimi i mallit është çmimi i ekuilibrit dhe çmimi i merituar. Megjithatë, nëse qeveria ndërhyn për të vendosur çmimin e atij malli, ajo e prish këtë ekuacion çmimi, duke shkaktuar ose një mungesë për shkak të çmimit të ulët të mallit në krahasim me kërkesën, duke i dekurajuar tregtarët që ta prodhojnë atë, ose një ulje të kërkesës nëse

çmimi i mallit është vendosur në një çmim të lartë. Prandaj, qeveria ose kushdo tjetër nuk duhet të ndërhyjë në caktimin e çmimit të mallit. Sipas teorisë kapitaliste, dora punëtore nuk bën përjashtim nga kjo situatë. Që tregu të funksionojë mirë, çmimi i dorës punëtore duhet t'i lihet tregut për ta përcaktuar. Dhe këtu lind çështja e skllavërisë.

Skllavëria llogaritet si dorë punëtore falas, së këndejmi dora punëtore falas minon parimet e tregut të lirë, sepse ajo lejon prodhimin e pakufizuar të mallrave, gjë që përfundimisht do të shkaktojë që tregu të humbasë ekuilibrin dhe të tkurret pasi çmimet e këtyre produkteve bëhen shumë të lira për shkak të kostove të ulëta të prodhimit. Nga ana tjetër, skllavëria jo vetëm që është bërë e padobishme, mirëpo ajo është bërë edhe problematike. Ngase në një sistem kapitalist, duhet të ketë një shitës dhe një blerës, e përderisa ka dorë punëtore falas, atëherë prodhimi do të rritet ndjeshëm, ndërsa blerjet do të ulen. Kjo ndodh sepse dora punëtore falas nuk merr para për punën e saj dhe për këtë arsye nuk blen asnjë nga mallrat. Së këndejmi, që modeli kapitalist të funksionojë, kemi nevojë për punëtorë që prodhojnë dhe më pas që blejnë mallrat. Nga kjo logjikë, skllavëria jo vetëm që bëhet një pengesë për konkurrencën e drejtë në tregun kapitalist me ofrimin e punës së lirë, por edhe një pengesë për funksionimin e duhur të modelit kapitalist. Këtu bëhet e dukshme nxitja ekonomike për të liruar skllevërit, duke i mundësuar ata të bëhen punëtorë produktivë, fitues dhe klientë, si shpenzues ashtu edhe blerës. Kështu, e njëjta nxitje materiale që prodhoi skllavërinë brutale koloniale në radhë të parë, është po e njëjta që nxiti heqjen e saj.

Kjo analizë nuk është thjesht çështje spekulimi apo leximi mbi një filxhan kafe. Ngjarjet historike, sekuenca e tyre dhe detajet e tyre dëshmojnë për këtë. Për shembull, Britania, vendosi t'i jepte fund skllavërisë në të gjitha kolonitë e saj në vitin 1833, saktësisht shtatëdhjetë vjet pas fillimit të Revolucionit Industrial në vitin 1760. Kjo ishte periudha kohore që iu desh ekonomisë britanike për t'u transformuar nga modeli i vjetër ekonomik në kapitalizëm industrial.[4] Për më tepër, Britania kishte humbur kontrollin e rajoneve më të rëndësishme të prodhimit bujqësor, duke përfshirë edhe vendqëndrimin më të madh të skllevërve në botë, koloninë e saj të Amerikës së Veriut, në favor të lëvizjes për pavarësi në Amerikë në vitin 1783. Britania kërkoi t'i jepte fund skllavërisë në të gjithë botën për shkak të çekuilibrit që shkaktonte në modelin ekonomik në zhvillim e sipër që po miratonte, kështu që ajo i detyroi vendet përreth saj e ndaj të cilave kishte ndikim, që ta zhduknin skllavërinë. Një shembull i qartë i rolit të rritjes së kapitalizmit industrial në zhdukjen e skllavërisë është Lufta Civile Amerikane. Shtetet veriore të Amerikës i paraprinë shteteve jugore në kalimin nga bujqësia në industri dhe hynë në tregun e kapitalit. Kjo u pasua nga zhdukja e skllavërisë në Amerikë. Kjo nuk i pëlqeu shteteve jugore, të cilat ende mbështeteshin në modelin e vjetër ekonomik të bazuar në bujqësinë e bazuar në skllavëri. Vendi hyri në një luftë civile të përgjakshme në vitin 1861, gjatë së cilës Veriu industrial në fund të fundit arriti t'i impononte interesat e tij Jugut dhe të miratonte rezolutën që hiqte skllavërinë. Kështu, vendet evropiane ndoqën shembullin, njëra pas tjetrës, sipas një afati kohor që përkonte pothuajse saktësisht me datën e kalimit të ekonomive të tyre në modelin kapitalist.

Kështu, mund ta shohim qartë se Perëndimi, i cili ishte në gjendje të shfuqizonte skllavërinë, nuk ishte i motivuar nga vlerat morale, por më tepër nga përfitimi ekonomik. I njëjti përfitim ekonomik e shtyu Perëndimin të fillonte një lloj skllavërie të paparë në historinë e njerëzimit.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se skllavëria në Lindjen e Mesme kishte arritur fazat e saj të fundit dhe ishte në prag të zhdukjes. Lindja e Mesme nuk përjetoi një rritje të shkallës së skllavërisë. Legjislacioni që lidhej me skllavërinë bazohej në parime morale, që binin ndesh me përfitimin ekonomik dhe kështu vazhdoi të binte vazhdimisht. Teksa Evropa përjetoi një rritje të skllavërisë gjatë epokës koloniale, Lindja e Mesme përjetoi një rënie të shkallës së skllavërisë. Disa vende arabe i paraprinë vendeve të tjera evropiane në ndalimin dhe parandalimin e skllavërisë, siç është Tunizia, e cila shfuqizoi skllavërinë në vitin 1837, dhjetë vjet para francezëve. Pyetja që lind këtu është: meqenëse Perëndimi ka braktisur referencat morale fetare dhe e ka bërë interesin ekonomik referencën për të drejtën dhe të gabuarën, çfarë na bën të sigurt se Perëndimi nuk do të kthehet në praktikimin e skllavërisë, ose më keq, nëse përfitimi ekonomik rishfaqet?

Përktheu dhe përshtati nga gjuha arabe:
Vedat Shabani

Burimi: https://hekmahyemanya.com

---

1 V. R. (1970). The messenger; the life of Mohammed. Garden City, N. Y., Doubleday & Company, inc.

2 Sigrid Hunke, Allah ist ganz anders.

3 Immerwahr, J. (1992). Hume's Revised Racism. Journal of the History of Ideas, 53(3), 481–4869889072/7032.01/gro.iod//:sptth .

4 Martin, Phyllis M. Review of Britain, the Slave Trade and Its Abolition, by Roger Anstey, P. E. H. Hair, M. M. Schofield, and Seymour Drescher. ASA Review of Books 5 (1979): 4–6.



Feja, shkenca dhe përgjegjësia etike

Nehat Shehu

> *Islami nuk e ka parë dijen vetëm si mjet për përfitime materiale, por si një mision shpirtëror dhe moral për afrimin me Krijuesin dhe për përmirësimin e gjendjes së njeriut në tokë.*

Çështja e marrëdhënies ndërmjet fesë dhe shkencës ka përbërë një nga temat më komplekse dhe thelbësore në historinë e mendimit njerëzor. Në këtë kuadër, Islami paraqet një paradigmë të veçantë, ku kërkimi shkencor dhe përsiatja metafizike nuk qëndrojnë në kundërshti, por gjejnë pikëtakime të shumta përmes një diskursi të harmonizuar. Që nga shpallja e Kuranit famëlartë, ku dija dhe reflektimi mbi krijimin përmenden me insistim të vazhdueshëm, Islami ka nxitur një kulturë të gjallë të hulumtimit dhe eksplorimit racional.

Raporti ndërmjet Islamit dhe shkencës ka qenë ndër temat më të trajtuara në fushat e studimeve fetare, filozofike dhe historike. Përkundër perceptimeve moderne, që shpesh e paraqesin fenë si një pengesë për zhvillimin shkencor, tradita islame ofron një qasje unike, në të cilën feja dhe shkenca janë dy drejtime të ndërthurura të së njëjtit kërkim për të vërtetën. Islami nuk e ka parë dijen vetëm si mjet për përfitime materiale, por si një mision shpirtëror dhe moral për afrimin me Krijuesin dhe për përmirësimin e gjendjes së njeriut në tokë.

Gjatë asaj që njihet si Epoka e Artë Islame (shek. VIII–XIII), dijetarët myslimanë kontribuuan në mënyrë madhore në zhvillimin e shkencave natyrore, matematikës, mjekësisë dhe filozofisë. Veprat e tyre, jo vetëm që ruajtën trashëgiminë greko-romake, por edhe i shtuan asaj përmbajtje të re dhe metodologji rigoroze. Ndër veprat më të rëndësishme mund të përmendim: "Libri i Algjebrës" i El Khavarizmit, që hodhi bazat e algjebrës moderne; "Libri i optikës" i Ibën el Hejthemit, që u konsiderua pararendës i metodës shkencore eksperimentale në Evropë; "Libri i bazës së mjekësisë" i Ibën Sinës, që mbeti tekst bazë në universitetet evropiane për disa shekuj.

Me kalimin e kohës, për shkak të faktorëve të shumtë – si rënia politike, ndikimi i kolonializmit, dobësimi i institucioneve shkencore dhe izolimi kulturor – marrëdhënia ndërmjet Islamit dhe shkencës u zbeh. Megjithatë, në epokën moderne ka një përpjekje të qartë për ringjalljen e mendimit shkencor islam dhe rivendosjen e një harmonie midis shpalljes fetare dhe arsyes natyrore.

Ky punim do të shqyrtojë këtë marrëdhënie nga katër këndvështrime:

1. Parimet themelore të Islamit mbi dijen dhe shkencën,

2. Kontributi historik i dijetarëve myslimanë,

3. Shkenca dhe kultura islame në kontekstin global,

4. Roli i etikës në shkencën islame.

DIJA SI DETYRË SHPIRTËRORE DHE SHOQËRORE

Islami e ka vlerësuar dijen si një akt të shenjtë, që është e lidhur ngushtë me adhurimin dhe përgjegjësinë shpirtërore. Kërkimi i dijes është i urdhëruar në Kuran, ku Allahu thotë: "*Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?*" (Ez Zumer, 6). Ky varg nënvizon rëndësinë e dijes, e cila është një mjet për të kuptuar më mirë Krijuesin dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë.

Një nga hadithet më të njohura të Pejgamberit Muhamed a.s. thotë: “Kërkimi i dijes është detyrë për çdo mysliman.”[1] Ky hadith nxjerr në pah se dijen, jo vetëm që duhet ta kërkojmë për t’u zhvilluar si individë, por edhe për të kontribuar në mirësinë e përbashkët dhe për të përmirësuar gjendjen e shoqërisë në tërësi.

Në këtë kontekst, kërkimi shkencor nuk është një aktivitet i veçantë i një grupi të caktuar, por është një përgjegjësi, që përfshin çdo individ të shoqërisë, i cili mund të kontribuojë me njohuri dhe inovacion në çdo fushë të dijes, nga shkencat natyrore deri te shkencat sociale.

Kërkimi shkencor nuk është një aktivitet i veçantë i një grupi të caktuar, por është një përgjegjësi, që përfshin çdo individ të shoqërisë, i cili mund të kontribuojë me njohuri dhe inovacion në çdo fushë të dijes, nga shkencat natyrore deri te shkencat sociale.

KURANI DHE SHKENCA

Një nga aspekte më të rëndësishme të parimeve islame mbi dijen është lidhja e ngushtë e Kuranit me shkencën. Shumë ajete të Kuranit i drejtohen vëzhgimit të natyrës dhe fenomeneve natyrore, të cilat mund të kuptohen vetëm përmes kërkimit shkencor. Disa ajete të Kuranit përshkruajnë proceset natyrore, si krijimin e universit, zhvillimin e jetës, ciklet e ujit dhe shumë të tjera që mund të shpjegohen nga shkenca moderne.

Një ajet i njohur është ai që përmend zhvillimin e embrionit në barkun e nënës, ku përshkruhen fazat e zhvillimit të njeriut. Ky përshkrim i mrekullueshëm ka shpërfaqur shumë detaje, që janë zbuluar vetëm me avancimin e teknologjisë moderne të mjekësisë. Për këtë arsye, shumë dijetarë myslimanë janë të mendimit se Kurani nuk është në kundërshtim me shkencën, por përkundrazi, ai inkurajon dhe mbështet kërkimin shkencor si një mënyrë për të kuptuar më mirë botën dhe gjithashtu për të reflektuar mbi fuqinë dhe mençurinë e Krijuesit.

THIRRJA PËR PËRSOSMËRI DHE INOVACION

Në Islam, kërkimi i dijes dhe avancimi shkencor janë të lidhura ngushtë me konceptin e “Ihsan” (përsosmërisë). Një nga parimet më themelore të mësimit islam është se çdo individ duhet të synojë të bëjë më të mirën që mundet në çdo aspekt të jetës, përfshirë kërkimin dhe zhvillimin shkencor. Ashtu siç na thotë Pejgamberi a.s., në hadithin e tij të njohur: “Vërtet Allahu ka bërë obligim përsosmërinë në çdo send.”[2]

Në këtë kontekst, përpjekja për të zbuluar ligjet e natyrës, për të zhvilluar teknologji dhe për të kontribuuar në mirëqenien e shoqërisë përmes dijes është një akt që është i vlerësuar në Islam. Kërkimi shkencor, duke përfshirë inovacionet teknologjike dhe aplikimet praktike, është i lidhur ngushtë me idenë e përmirësimit të kushteve të jetesës dhe lehtësimin e jetës së individëve dhe shoqërisë.

KONTRIBUTI HISTORIK I DIJETARËVE MYSLIMANË NË SHKENCAT NATYRORE – EPOKA E ARTË E SHKENCËS ISLAME

Gjatë periudhës së Epokës së Artë Islame (shekulli VIII deri në shekullin XIII), bota islame ishte qendra kryesore e dijes dhe zhvillimit shkencor. Kjo periudhë shënoi një rinovim të madh intelektual, ku dijetarët myslimanë, të cilët ishin të frymëzuar nga Kurani dhe hadithet e Pejgamberit a.s. kontribuuan në mënyrë të jashtëzakonshme në fusha të ndryshme shkencore, duke ndikuar thellësisht në formimin e mendimit shkencor dhe filozofik të Evropës dhe Azisë.

Profesori dhe mendimtari mysliman gjerman, Muhamed Esed, përshkruan qasjen islame ndaj jetës me këto fjalë: “Islami nuk e sheh botën me syze të errëta, siç bën Krishterimi,

përkundrazi, ai na mëson që të mos jemi shpërdorues në vlerësimin e jetës në tokë as të mos e teprojmë në vlerat dhe mundësitë e saj, siç ndodh në qytetërimet perëndimore. Krishterimi e kritikon dhe e urren jetën materiale, ndërsa perëndimi i qytetëruar, ndryshe nga shpirti i Krishterimit, i kushton rëndësi jetës siç interesohet i urituri për ushqim, i cili, edhe pse e ha atë, nuk ndjen ndonjë respekt për të. Ndërsa Islami bën të kundërtën. E sheh jetën me qetësi dhe respekt. Ai nuk e adhuron jetën, por e llogarit si një periudhë kalimtare në të cilën ecim drejt një jete tjetër, më të lartë. Dhe meqë kjo jetë është thjeshtë një etapë, që nuk bën pa të, atëherë njeriut nuk i takon ta nënvlerësojë, apo t'ia pakësojë rëndësinë që ka ajo."[3]

Shkenca në Islam nuk është e ndarë nga parimet morale dhe etike, sepse njohuria e kërkuar duhet të shërbejë për dobinë e njerëzve dhe të respektojë vlerat morale të shoqërisë.

Një nga arsyet që ndihmoi në zhvillimin e shkencës në botën islame ishte themelimi i institucioneve shkencore si "*Bejtu-l Hikme*" (Shtëpia e Urtësisë) në Bagdad, një qendër e madhe kërkimi dhe përkthimi e themeluar nga kalifi El Me'mun në shekullin IX. Këtu u përkthyen shumë vepra të rëndësishme nga latinishtja dhe greqishtja në arabisht, duke përfshirë veprat e Aristotelit, Ptolemeut dhe Galenit. Përkthimet dhe studimet e këtyre veprave krijuan një bazë për zhvillimin e shkencës dhe filozofisë në botën islame.[4]

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i kësaj periudhe ishte shkrimi i shumë veprave origjinale, që synonin të zhvillonin më tej njohuritë ekzistuese. Dijetarët myslimanë krijuan shumë fusha të reja të dijes dhe teknologjisë, duke sjellë kontribute në astronomi, matematikë, mjekësi, kimi dhe optikë.

KONTRIBUTET NË ASTRONOMI DHE MATEMATIKË

Astronomia dhe matematika janë dy fushat ku kontribuuan shumë dijetarë myslimanë. Për shembull, El Khawarizmi, i cili është i njohur për krijimin e algjebrës, ka qenë një nga dijetarët më të rëndësishëm të periudhës. Vepra e tij "*El Kitabu el Mukhtasaru fi Hisabi el Jebri vel Mukabeleti*" (Libri i shkurtuar i Algjebrës dhe krahasimi), formoi bazat e algjebrës moderne dhe pati ndikim të thellë në zhvillimin e matematikës në Perëndim.[5]

Një tjetër figurë e shquar është Ibën el Hejthami, i cili është konsideruar si "babai i optikës". Vepra e tij "*Kitab el Menadhir*" (Libri i Optikës), përshkruan shumë aspekte të rrezatimit të dritës dhe vizionit. Ai është i njohur për zhvillimin e teorisë së kamerës obskurë dhe për përdorimin e eksperimentimit si metodë për të testuar teoritë shkencore, një parim që më vonë u shndërrua në metodën shkencore të kërkimit.[6]

KONTRIBUTET NË MJEKËSI DHE KIMI

Mjekësia dhe kimia ishin gjithashtu fusha ku dijetarët myslimanë dhanë kontribute të jashtëzakonshme. Ibën Sina (Avicena) është ndoshta figura më e njohur në këtë fushë. Veprat e tij, sidomos "*El Kanun fi Tibb*" (Baza në Mjekësi), mbetën tekstet mjekësore të përdorura në Evropë dhe botën islamike deri në shekullin XVII. Ai zhvilloi një sistem të integruar mjekësor dhe është i njohur për përpjekjet e tij për të lidhur mjekësinë me filozofinë dhe shkencën natyrore.[7] [8]

Po ashtu, Xhabir ibën Hajjan (Geber), i konsideruar "babai i alkimisë", krijoi një shumëllojshmëri metodash të përpunimit të kimikateve dhe u ndikua nga praktikat e transformimit të substancave. Vepra e tij "*Kitab el Seb'iin*" (Libri i Shtatëdhjetë) dhe shumë traktate të tjera kanë pasur ndikim të thellë në zhvillimin e kimisë dhe farmaceutikës.

FILOZOFIA DHE SHKENCA

Përveç fushave teknike, dijetarët myslimanë kontribuuan gjithashtu në filozofi dhe etikë shkencore. El Farabi, Ibën Rushdi (Averroes) dhe Ibën Sina, zhvilluan mendime të thella për natyrën e realitetit dhe marrëdhënien mes arsyes dhe besimit fetar. Këta mendimtarë, nëpërmjet përpjekjeve të tyre për të harmonizuar filozofinë aristoteliane me mësimet islame, ndihmuan në krijimin e një lidhjeje midis mendimit racional dhe të besuarit fetar. Filozofia islame mbetet një trashëgimi e çmuar që ka pasuruar debatet shkencore dhe filozofike për shumë shekuj.

RËNDËSIA E SHKENCËS PËR SHKOLLËN ISLAME TË MENDIMIT

Në kontekstin global, shkenca islame ka një rëndësi të veçantë për mënyrën se si myslimanët e shohin botën dhe marrëdhënien e tyre me Krijuesin. Një nga aspektet më të rëndësishme të mendimit islam është se shkenca dhe feja nuk janë të ndara, por bashkëjetojnë në mënyrë harmonike. Ky ka qenë gjithmonë një parim i thellë në filozofinë islame, i cili synon të lidhë zhvillimin e dijes me kuptimin e thellë të natyrës dhe botës që na rrethon.

Në fakt, shumë dijetarë myslimanë të periudhës së Artë Islame, si El Farabiu, Ibën Sina dhe Ibën Rushdi, e konceptuan shkencën si një mënyrë për të kuptuar ligjet e Krijuesit përmes studimit të natyrës dhe rregullave të saj. Kjo qasje e theksonte rëndësinë e arsimit shkencor si një mjet për të kuptuar më mirë Krijesën dhe për të përmirësuar jetën e individëve dhe shoqërive. Shkenca, siç është paraqitur në kulturën islame, është më shumë se një aktivitet intelektual;

ajo është një mjet për të kuptuar dhe për t'i shërbyer botës dhe njerëzve. Në këtë kuptim, shkenca dhe feja kanë një qëllim të përbashkët: përmirësimin e jetës njerëzore dhe zhvillimin e mendjes dhe shpirtit.[9]

SHKENCA, FEJA DHE SHPËRNDARJA E DIJES NË KOMUNITETIN MYSLIMAN

Një nga sfidat e mëdha që mbetet është lidhja midis besimit fetar dhe shkencës, veçanërisht në aspektin e edukatës dhe përhapjes së dijes. Pavarësisht përpjekjeve të mëdha, që janë bërë për të integruar shkencën dhe fenë, disa grupe myslimanësh ende mendojnë se shkenca dhe feja janë të kundërta. Megjithatë, shumë intelektualë dhe dijetarë myslimanë besojnë se shkenca dhe feja nuk janë në kundërshtim, por janë të nevojshme për njëri-tjetrin.

Shkenca islame është gjithashtu një faktor kyç në zhvillimin e një shoqërie që vlerëson dijen dhe kërkimin. Një nga mundësitë që ekzistojnë në këtë drejtim është të sigurojmë një sistem arsimor që u ofron studentëve mundësi për të zhvilluar jo vetëm njohuri shkencore, por edhe një kuptim të thellë të feve dhe filozofisë islame. Kjo do të ndihmojë që të krijohet një ekuilibër i shëndetshëm midis arsyes dhe besimit, duke mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të shoqërisë.[10]

ETIKA SHKENCORE NË TRADITËN ISLAME

Në traditën islame, etika është një element i rëndësishëm që udhëheq veprimet e individëve dhe shoqërive. Kjo është e vërtetë edhe në kontekstin e shkencës. Shkenca në Islam nuk është e ndarë nga parimet morale dhe etike, sepse njohuria e kërkuar duhet të shërbejë për dobinë e njerëzve dhe të respektojë vlerat morale të shoqërisë. Ky qëndrim është i bazuar në mësimet e Kuranit dhe haditheve të Pejgamberit Muhamed a.s., të cilat theksojnë se njohuria duhet të përdoret për të ndihmuar dhe përmirësuar jetën e njerëzve, në harmoni me mësimet e Islamit.

PARIMET ETIKE TË SHKENCËS NË ISLAM

Për të ndihmuar në udhëzimin e praktikës shkencore, Islamit ofron disa parime etike që duhet të ndiqen nga shkencëtarët dhe studiuesit. Këto parime janë të lidhura ngushtë me mësimet e Kuranit dhe haditheve, dhe përfshijnë:

1. Ndërgjegjësimi për përgjegjësinë ndaj Zotit: Njohuria dhe shkenca janë të cilësuara si dhurata nga Zoti, dhe studiuesit janë të ftuar të përdorin dijen në mënyrë që respektojnë këtë dhuratë dhe të kontribuojnë në përmirësimin e shoqërisë dhe botës. Kjo do të thotë se përdorimi i dijes për qëllime egoiste, të dëmshme, ose që i kundërvihen parimeve islame është i papranueshëm.

2. Përkushtimi ndaj të vërtetës: Shkencëtarët duhet të jenë të angazhuar në kërkimin e të vërtetës dhe në mbylljen e çdo dileme, duke u bazuar në fakte dhe prova të qarta. Kjo është e drejta e çdo individi për të pasur qasje në të vërtetën, dhe shkencëtarët janë të obliguar të mos manipulojnë faktet për interesat e tyre personale, apo për të fshehur të vërtetën.

3. Përgjegjësia sociale: Dija shkencore duhet të kontribuojë për përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë njerëzit, pa bërë dallime të pasurisë, racës apo feve. Shkencëtarët janë të detyruar të aplikojnë dijen e tyre për të mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të drejtë, që i shërben shoqërisë dhe individëve në mënyrë të barabartë.

4. Respektimi i jetës dhe dinjitetit të njeriut: Shkenca duhet të përdoret në mënyrë që të ruajë jetën dhe dinjitetin e çdo njeriu. Kjo përfshin përdorimin e etikës në kërkime të tilla si bioteknologjia, mjekësia dhe inxhinieria, ku ndihma dhe shpëtimi i jetëve është qëllimi i parë. Po ashtu, është e rëndësishme që shkencëtarët të evitojnë çdo veprim që mund të dëmtojë jetën e njeriut, siç janë eksperimentet që mund të shkaktojnë dëme të drejtpërdrejta.

5. Transparenca dhe ndershmëria: Shkencëtarët duhet të jenë të ndershëm dhe transparentë në punën e tyre. Kjo përfshin raportimin e saktë të të dhënave dhe rezultateve, pa manipulime që mund të rrezikojnë besueshmërinë e shkencës dhe ndikojnë negativisht në shoqëri.[11]

Në përfundim, Islami që nga fillesat e tij ka nxitur dhe promovuar dijen, duke e konsideruar atë një detyrim fetar dhe një rrugë drejt afërsisë me Zotin. Parimet islame e vendosin kërkimin e dijes në një vend të lartë, ndërsa Kurani dhe Suneti, shpeshherë i nxisin besimtarët të vëzhgojnë, të mendojnë dhe të hulumtojnë rreth krijimit dhe ligjeve të natyrës. Kontributi i dijetarëve myslimanë gjatë periudhës së artë të qytetërimit islam në fushat, si: astronomia, mjekësia, matematika dhe filozofia, ka qenë themelor për zhvillimin e shkencës në nivel global. Po ashtu, Islami i ka dhënë një dimension etik dijes dhe shkencës, duke vendosur kufij moral dhe duke kërkuar që çdo përpjekje shkencore të jetë në shërbim të njeriut dhe të drejtësisë. Në një kohë kur teknologjia zhvillohet me ritme të shpejta, këto parime etike islame mbeten tejet aktuale dhe të domosdoshme për të ruajtur humanizmin dhe qëllimin fisnik të dijes. Prandaj, dialogu ndërmjet Islamit dhe shkencës nuk është konfliktual, por plotësues, duke ndërtuar ura mes besimit dhe arsyes, mes shpirtërores dhe shkencores.

---

1 Muhamed bin Jezid bin Maxhe, *Sunnen ibën Maxhe*, (244)

2 Muslim bin Haxhaxh, *Sahih el Muslim*, (1955)

3 Ebu Hasen en Nedevij, *Madha Hasirel Alem bi Inhitatil Muslimin*, f. 175.

4 https://www.oxfordreference.com/The_Significance_of_the_Bayt_Al_Hikma.

5 https://www.newscientist.com/people/muhammad-ibn-musa-al-khwarizmi/

6 https://www.ibnalhaytham.com/discover/who-was-ibn-al-haytham/

7 https://plato.stanford.edu/entries/ibn-sina/

8 Sigrid Hunke, *Shems el Arab testa ala el Garb*, Përkthyer në arabisht nga Faruk Bejdun, Kemal Dusukij, f. 105.

9 Po aty.

10 Ebu Hasen en Nedevij, *Madha Hasirel Alem bi Inhitatil Muslimin*, f. 139.

11 Hej'etu Ulemai Filistin, *Ahlakijat el Marife ve el Bahth el Ilmi*, f. 6, 7, 9.

Roli historik i hoxhallarëve për arsimimin shqip në Kosovë

PhDc. Agon Krasniqi

Roli i hoxhallarëve për zhvillimin e arsimit shqip dhe gjeneratave ishte nga faktorët kryesor të mbrojtjes së arsimit shqip në Kosovë, në kohën kur lufta ndaj arsimit shqip, ishte nga qëllimet kryesore të politikave jugosllave të kohës.

HYRJE

Zhvillimi i arsimit shqip në kushte të vështira si rezultat i situatës politike dhe juridike të krijuar në Kosovë, ishte një kontribut i përgjithshëm i popullit shqiptar në Kosovë. Në mesin e tyre ishin edhe hoxhallarët, të cilët dhuruan kontributin e tyre, ku si njerëz të shkolluar, kishin për qëllim që shoqërinë shqiptare në Kosovë, t'i nxitnin në mësim shkrimin dhe leximin e gjuhës shqipe dhe më gjerë. Si qendra të kësaj lëvizjeje nga hoxhallarët, rol të rëndësishëm luajtën mejtepet[1] dhe medresetë[2] si dhe myderrizët[3] e tyre. Kështu faktorin e zhvillimit të arsimit shqip e specifikojmë në disa etapa: etapa e parë ka të bëjë me pavarësinë e brendshme fetare, e që kjo ndikoi që të shfrytëzohej si mundësi për mësimin e gjuhës shqipe në mejtepe. Etapa e dytë ka të bëjë me medresetë dhe myderrizët e saj, me ç'rast u kultivua mësimi shqip. Etapa e tretë ka të bëjë me mësimet e brendshme private nga hoxhallarë të ndryshëm, ndërsa etapa e katër ka të bëjë me lëvizje e hoxhallarëve në aktet patriotike, për hapjen e shkollave shqipe. Këto raste dhe raste të ndryshme që do të trajtohen, tregojnë një faktor të madh se hoxhallarët ishin element i rëndësishëm i zhvillimit të arsimit shqip në Kosovë gjatë periudhës jugosllave.

HOXHALLARËT DHE ARSIMI SHQIP NË KOSOVË

Islami përpos edukimit fetar, ka për qëllim edukimin arsimor të shoqërisë. Fjala "Ikre – Lexo", është tradicionalizuar në vende të ndryshme të shoqërive myslimane dhe është përdorur si udhërrëfim për lexim, shkollim dhe arsimim. Kjo kishte ndodhur edhe në Kosovë, ku arsimi luftohej nga parimi i ortodoksisë serbe për ndalimin e mësimit shqip. Kështu prijësit fetarë, luajtën një rol të rëndësishëm për arsimimin e shoqërisë në kohërat kur Kosova ishte e pushtuar. Faktori i mësimit të gjuhës dhe pastaj i shkollimit të tërësishëm, ishte elementi kryesor i vetëdijesimit kombëtar, ruajtjes së gjuhës dhe fuqizimit të nacionalizmit shqiptar, kundrejt elementit kërcënues serb. Pikërisht për këtë, hoxhallarët, të cilët ishin të shkolluar, kishin për qëllim që dijen e tyre ta vendosnin në shërbim të atdheut. Atdheu në këto kohëra kishte për qëllim që arsimimi të mos mungonte, kjo si rezultat që arsimimi i shoqërisë ishte burimi i lirisë. Hoxhallarët të cilët fillimisht kontribuuan me penë, nuk hezituan më vonë që këtë ta rikthenin edhe me rezistencë të përgjithshme ushtarake. Megjithatë gjithçka fillimisht filloi me rezistencën e arsimit, mbrojtja e shkollës shqipe, mbrojtja e gjuhës shqipe dhe më gjerë.

Kontribut të madh në zhvillimin e arsimit shqip në Kosovë kanë dhënë hoxhallarët, si shembull përmendim hoxhë Bajram Aganin. Ai njihet edhe si themelues i bibliotekës qendrore të vakëfit në Prishtinë.[4] Hoxhë Bajram Agani ishte edhe kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai, duke parë nevojën e arsimimit, mori iniciativën e formimit të bibliotekës së vakëfit. Kështu, më 14 shtator 1951, u mbajt mbledhja e Kuvendit të Vakëfit të Bashkësisë së Fesë Islame të Kosovës, me ç'rast u mor vendim formimi i bibliotekës qendrore, e njohur si "Biblioteka Qendrore e Vakëfit". Kjo bibliotekë ndryshe njihej edhe me emërtime të tjera si "Kutubhaneja e Vakëfit", "Biblioteka e Vakëfit". Qëllimi i hoxhë Bajram Aganit ishte

Rol primar luajtën mejtepet, të cilat i mësuan nxënësve shkrim-leximin e gjuhës shqipe.

që biblioteka të shfrytëzohej nga njerëzit e arsimuar. Ai propozoi që "qitapet", të mblidheshin nga Këshillat e Bashkësisë Islame dhe të vendoseshin në bibliotekën qendrore.[5]

Kontributdhënës në sferën e arsimit shqip dallojmë edhe myderriz Sadri Prestreshin, i cili lindi në vitin 1917 dhe vdiq në vitin 2002. Mulla Sadriu shkollën e kreu në medresenë "Pirinaz", në Prishtinë, ndërsa më pas u punësua si imam në xhaminë e Dobrajës së Madhe të komunës së Lipjanit. Ai ishte pjesë e KNDSh-së (Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar).[6] Kjo ndikoi që ai të dënohej me katër vjet burgim nga ana e gjykatës ushtarake. Pas burgut, shërbeu si mësimdhënës në shkollën fillore të Obiliqit, pastaj në shkollën fillore të Korroticës së Drenicës.[7] Përpos këtyre, ai në vitin 1962, u emërua edhe si imam-vaiz në Xhaminë e Madhe të Prishtinës. Krahas saj, ai shërbeu si mësimdhënës edhe në Medresenë e Prishtinës, ku ligjëroi lëndët: Ahlak, Kiraet, Imamat, Fikh. Për lëndën e Ahlakut ai përktheu edhe një dispensë në gjuhën shqipe.[8] Në Medrese ai shërbeu si mësimdhënës deri në vitin 1983, kur edhe u pensionua. Rol të veçantë ka edhe veprimtaria arsimore në gjuhën shqipe nga ana e hoxhës Sadri Prestreshit. Qëllimi i tij ishte ngritja e arsimimit kombëtar. Siç u cek më lartë, ai shërbeu edhe si mësimdhënës në shkollën e Obiliqit dhe Korroticës. Qëllimi i hoxhës ishte mësimi i shkronjave shqipe, kjo meqë mësimi i shkronjave shqip ishte parim i idesë së mbrojtjes kombëtare të arsimit shqip. Në anën tjetër, Sadri Prestreshi kontribuoi edhe në emancipimin e shkollimit të femrës. Duke thirrur në largimin e tradicionales, pasi që asnjë femër nuk ishte e regjistruar në shkollën e Karraticës në Drenas gjatë vitit 1949, hoxhë Sadriu bëri thirrje për largimin e këtij mentaliteti.[9]

Numri i hoxhallarëve që kontribuuan në arsimimin shqip ishte i madh, megjithatë dallojmë edhe hoxhë Rrystem Shportën, i cili kontribuoi në kohëra të vështira, pikërisht në kohën e mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene. Roli i tij në arsimimin kombëtar dhe fetar është shumë i rëndësishëm, pasi ai pas vetës la vepra të rëndësishme fetare, por edhe bibliotekën e tij të pasur. Më e rëndësishmja është se udha e tij u pasua edhe nga djali i tij, hafëz Sadik Shporta, i cili ishte kryetar i Vakëf Mearifit të Prizrenit.[10]

SHERIF AHMETI DHE HASAN NAHI – PËRKTHYES TË KURANIT DHE MBROJTËS TË ARSIMIT SHQIP

Një nga hoxhallarët më të rëndësishëm të kohës, ishte padyshim hoxhë Sherif Ahmeti, i cili ka kontribute të mëdha jo vetëm në sferën e arsimimit, por edhe në sfera të tjera shoqërore. Mulla Sherif Ahmeti shërbeu si myderriz në Medresenë "Alauddin" të Prishtinës gjatë viteve 1965-1985. Ai po ashtu shërbeu edhe si pedagog e drejtor i Medresesë, si dhe ishte themelues i revistës "*Edukata Islame*". Po ashtu ishte autor i teksteve shkollore vaiz dhe hatib. Shërbeu edhe si profesor në Fakultetin e Studimeve Islame.[11] E gjithë karriera e tij e bujshme në aspektin arsimor, kurorëzohet me përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe. Kontributi i tij si myderriz ishte i lartë, kjo pasi që medreseja nuk financohej nga shteti dhe punonte me programin e Bashkësisë Islame. Kështu mësimi mbahej shqip, mbi bazën e lirisë fetare. Kjo u shfrytëzua nga myderrizët, konkretisht edhe nga Sherif Ahmeti, në aspektin e arsimimit kombëtar, të mësimit në gjuhën shqipe.

Nga kontributdhënësit dallohet edhe myderriz Hasan Nahi, i cili lindi në vitin 1905 dhe vdiq në vitin 1991. Hasan Nahi shërbeu si myderriz në medresenë e "Mehmet Pashës" në Prizren, ndërsa më pas edhe në Medresenë "Alauddin" në Prishtinë. Në aspektin e kulturës fetare dallohet për përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe. Përpos saj, në aspektin arsimor, përpos që shërbeu si myderriz në Medresenë "Alauddin" dhe "Mehmet Pashës" në Prizren, ai dallohet edhe si mbrojtës i arsimit kombëtar shqiptar, konkretisht rasti i mbrojtjes së Gjimnazit të Gjakovës,[12] ku qëllimi i jugosllavëve ishte mbyllja e gjimnazit. Kontributi i Hasan Nahit në këtë drejtim, ka mbetur në kujtesën e popullatës së Gjakovës.

Nga emrat e njohur të hoxhallarëve që kontribuuan në zhvillimin e arsimit shqip në Kosovë, gjatë shek. XX, ishte edhe Hashim Kuleta, apo i njohur ndryshe si Mulla Hashim Kuleta. Përpos kontributit të tij fetar në Podujevë, ai njihet edhe për kontributin e tij në aspektin arsimor, konkretisht hapjen e shkollave shqipe në Podujevë. Ai punoi si mësues, pedagog, drejtor shkolle dhe inspektor arsimor. Në anën

tjetër ishte edhe nëpunës i Bashkësisë Islame të Kosovës. Hashim Kuleta ndryshe njihet si pishtar i arsimit nga qytetarët e Podujevës, kjo si shkak për kontributin e tij në hapjen e shkollave shqipe, rasti konkret në hapjen e shkollës në Tërnavë, shkollë fillore katër klasëshe.

ROLI I HOXHALLARËVE LOKALË DHE MEJTEPEVE

Numri i hoxhallarëve që kontribuuan në arsimin shqip në Kosovë është i madh. Nga hoxhallarët e popullarizuar deri te hoxhallarët lokal dhe në fshatra, që të gjithë qenë pjesë e idesë së arsimimit dhe edukimit. Vlen të theksohen edhe emra të tjerë si: hoxhë Azem Topalli, i cili ndryshe njihej si Arap Hoxha, ku shërbeu si mësues në medresenë e Ferizajt. Po ashtu dallojmë edhe Mulla Nezën, Mulla Selman Ratkoceri, ku edhe këta shërbyen si mësues në medresenë e Ferizajt. Po ashtu Ymer Pllana, i cili ndihmoi në hapjen e shkollës shqipe në Ferizaj. Vlen të theksohet se mejtepet luajtën rol të rëndësishëm në kultivimin e gjuhës shqipe. Ato ishin strehë e ngritjes së bazës arsimore, në kohën kur luftohej gjuha shqipe nga sistemi. Shembulli qëndron në rajonin e Shtimes, ku emra të përveçëm si: mulla Vesel Xheladin Guta, mulla Sinan Hoxha, mulla Ibush Hysiqi, mulla Hamdi Dauti, mulla Xhemajl Bilalli, mulla Fazli Mahmuti, mulla Sylejman Ajeti, mulla Mahmut Mahmuti, mulla Xhemajl Zegiri, etj., kishin hapur mejtepe dhe zhvillonin mësimin shqip, konkretisht mësim shkrim-leximin shqip. Rasti i mësimit privat specifikohet edhe te mulla Sinan Duga, i cili i mësonte nxënësit e tij me librat që kishte marrë nga Idriz Ajeti, për gjuhën shqipe.[13] Bashkëpunimi i mulla Sinan Dugës ishte edhe me Aziz (Rrahman) Krasniqin nga fshati Dugë, njohës i fesë, leximit të Kuranit dhe historisë kombëtare. Ky i fundit në kushte private ndihmoi nxënësit në mësimin e gjuhës shqipe, edukimin e tyre në frymën kombëtare dhe në frymën myslimane.

Po ashtu vlen të theksohet Mahmut Mahmuti nga Reçaku i Shtimes, i cili ishte dekretuar nga Bashkësia Islame e Kosovës në vitin 1950. Në vitin 1996, ai do fillonte organizimin për zgjerimin e shkollës fillore të Reçakut.

Mulla Faik Havolli, mulla Ahmet Mustafa, mulla Shaip Rexhepi, mulla Salaudin Ibrahimi, etj., ishin mësues që kishin për qëllim mësimin në shqip dhe zhvillimin e arsimit shqip. Të gjithë emrat e përmendur, por edhe të tjerë, kishin qëllim të qartë, shkollimi i tyre të ndikonte në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, si një shoqëri e arsimuar, shoqëri kjo që të mos mbetej e izoluar në analfabetizëm, por të njihte dhe studionte gjuhën e saj, mësimin ta bënte në gjuhën shqipe dhe shkollimin ta bënte në shkollën shqipe.

KONLUZION

Roli i hoxhallarëve për zhvillimin e arsimit shqip dhe gjeneratave ishte nga faktorët kryesor të mbrojtjes së arsimit shqip në Kosovë, në kohën kur lufta ndaj arsimit shqip, ishte nga qëllimet kryesore të politikave jugosllave të kohës. Për ta kundërshtuar këtë lëvizje dolën kundër hoxhallarët shqiptarë nga Kosova, të cilët, ndonëse në kushte të vështira, filluan që dijen e tyre ta përdornin për të shkolluar gjeneratat e reja. Kështu hoxhallarët luajtën rol të rëndësishëm për zhvillimin e gjeneratave të reja në Kosovë. Rol primar luajtën mejtepet, të cilat i mësuan nxënësve shkrim-leximin e gjuhës shqipe. Po ashtu medresetë, të cilat nxorën gjenerata të suksesshme, të cilat ishin produkt i hoxhallarëve. Duhet theksuar se emra të përveçëm si: Hashim Kuleta, Sherif efendi Ahmeti, mulla Faik Havolli, Shaip Rexhepi, etj., luajtën rol të rëndësishëm për zhvillimin e arsimit shqip, zhvillimin e publicistikes, mbrojtjen e shkollës shqipe dhe kontributin për hapjen e shkollave shqipe.

---

1 Mejtepet ishin shkolla ku merrej mësimi fillestar, konkretisht mësimi i shkronjave dhe i gjuhës. Rrjedh nga fjala ketb që do të shkruash .Shih: Nebi Bozkurt, *“Mektep”*, Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 28, (Ankara: Diyanet Yayin Vakiflari, 2004), 10.

2 Medresetë ishin shkolla fetare islame, që me kohën u institucionalizuan me shkollat e tjera islame dhe u ndanë në degë. Mësimi në medrese karakterizohet si mësim i lartë. Shih: Nebi Bozkurt, *“Medrese”*, Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 23, (Ankara: Diyanet Yayin Vakiflari, 2003), 308.

3 Myderrizi ishte mësuesi në medrese. Nebi Bozkurt, *“Müderris”*, Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 31, (Ankara: Diyanet Yayin Vakiflari, 2020), 467.

4 Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor “Myderriz Hfz. Bajram ef. Agani, Jeta dhe vepra (1899-1962)”, Sadik Mehmeti, kumtesë *“Hafiz Bajram ef. Agani themelues i Bibliotekës Qendrore të Vakëfit në Prishtinë (1951-1959)”*, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), f. 51.

5 Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor “Myderriz Hfz. Bajram ef. Agani, Jeta dhe vepra (1899-1962)”, Hajrullah Hoxha *“Kontributi i Hfz Bajram ef. Aganit* në fushën e arsimit dhe shtypit fetar*”*, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), f. 81.

6 Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor ‘‘Myderriz Sadri Ef. Prestreshi, Jeta dhe vepra (1917-2002), Qazim Qazimi *“Mulla Sadri ef. Prestreshi myderriz dhe pedagog në Medresenë Alauddin”*, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), f. 31.

7 Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor “Myderriz Sadri Ef. Prestreshi, Jeta dhe vepra (1917-2002)”, Nuridin Ahmeti, *“Gjurmëve të veprimtarisë arsimore në gjuhën shqipe të Sadri ef. Prestreshit”*, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), f. 96.

8 Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor “Myderriz Sadri Ef. Prestreshi, Jeta dhe vepra (1917-2002)”, Resul Rexhepi, *“Dispensa Ahlaku e Sadri ef. Prestreshit – gurë themeltar në fushën e islamologjisë* në gjuhën shqipe në Kosovë*”*, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), f. 127.

9 Ahmeti, *“Gjurmëve të veprimtarisë arsimore në gjuhën shqipe të Sadri ef. Prestreshit”,* f. 101.

10 Resul Rexhepi dhe Sadik Mehmeti, H. Rrystem ef. Shporta, Jeta dhe Vepra (1864-1937), (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2013), f. 50.

11 Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor “Haxhi Sherif ef. Ahmeti, Jeta dhe Vepra (1920-1998)”, Qemajl Morina, *“Mulla Sherif ef. Ahmeti, Myderriz në medresenë e mesme “Alaudin”* të Prishtinës*”*, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2010), f. 19.

12 Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor “Myderriz Hasan ef. Nahi, Jeta dhe Vepra (1905-1991)”, Alban Dobruna, *“Hasan ef. Nahi* në mbrojtje të Gjimnazit të Gjakovës*”*, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2012), f. 83.

13 Qemal Ratkoceri dhe Ruzhdi Marevci, *Shkollat në Komunën e Ferizajt*, f. 605-627.

Ndikimi i trashëgimisë kulturore islame në zhvillimin e Evropës

Ermal Bega

Bota në të cilën jetojmë ka kaluar shumë qytetërime të ndryshme, qofshin ato pagane, me adhurues idhujsh, por edhe qytetërime me besim në Zotin Një, Krijues.

Njëri prej tyre është padyshim edhe Islami, i cili jo vetëm që ka qenë një besim i të gjithë profetëve të dërguar nga Zoti, por gjithashtu është edhe një sistem i përsosur vlerash, për të cilat njerëz të ndryshëm të botës kanë shkruar për ndikimin e tyre te vende dhe popuj të ndryshëm.

Në këtë shkrim, ne do të përcaktohemi vetëm në zhvillimin e tij në Evropë, ku më saktë do të flasim vetëm për ndikimin që ka luajtur trashëgimia kulturore islame në këtë rajon.

Kush e njeh historinë e Evropës, sidomos atë të periudhës së Mesjetës, e cila në histori njihet si Periudha e Errët e Evropës, do të kuptojë qartë se në çfarë gjendje të mjeruar ka jetuar ky kontinent si dhe popujt brenda tyre, duke përfshirë edhe popullin shqiptar.

Këtu është e rëndësishme të dihet se cili ishte shkaku i një prapambetje të tillë?!

Është lehtësisht dhe tërësisht e vërtetuar historikisht dhe shkencërisht se, arsyeja e vetme e cila bëri që Evropa të ishte e zhytur në errësirën e paditurisë dhe të mospasjes kul-turë, art e qytetërim gjatë Mesjetës, ishte pikërisht besimi i tyre i krishterë, në veçanti përmes sektit katolik.

Papati dhe Vatikani me qendër në Evropë, ishin zhytur aq shumë në errësirë e padituri, saqë këto dy institucione si dhe fiset dhe popujt brenda tyre, nuk mund ta duronin dritën që mund t'u vinte nga ndonjë vend, besim apo popull tjetër. Madje, krahas kun-dërshtimeve që bënin ndaj vetë banorëve të

Islami, si besim monoteist dhe sistem vlerash, ka ndikuar thellë në historinë dhe kulturën e Evropës.

Islami u përhap me shpejtësi edhe në rajonin e Evropës, pasi ishte shpërndarë më herët në Persi dhe Bizant pas rënies së atyre perandorive të mëdha.



tyre pasi jepnin mendime të ndryshme që binin ndesh me besimin e tyre, çdo besim tjetër ata e quanin të ardhur nga ferri dhe shejtani, ndërsa profetët e tyre nuk i pranonin.

Edhe Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të, ka qenë i tillë deri vonë për të krishterët e Evropës, ku ai njihej zyrtarisht nga papati dhe kisha e sektit katolik si një profet i rremë, duke shfaqur vetëm paragjykime dhe asnjë bazë shkencore. Madje disa ekstremistë shkojnë edhe më larg, siç ishte poeti italian Dante Alighieri, i cili në librin e tij "Komedia hyjnore" shkruan se Profeti Muhamed do të vendoset në rrethin e tetë të ferrit, më të ulëtin, pasi ai konsiderohej, sipas tij, si një mashtrues, ndarës e përçarës, që meriton të jetë në atë vend.

Ndërkohë, historia islame na tregon qartë respektin që ka këshilluar Islami dhe ka shprehur vetë Profeti Muhamed ndaj të krishterëve dhe besimtarëve të feve të tjera, pasi ai e dinte shumë mirë se ishte pasardhës profetik i Profetit Isa (Jezusit), duke ndjekur të njëjtën rrugë të qartë të besimit të pastër monoteist, njësoj si ai dhe populli i tij gjatë kohës që vetë Isai (Jezusi) ishte gjallë.

Gati 100 vjet pas shpalljes së Islamit si plotësim i besimit monoteist, dhe si mesazhi i fundit i zbritur nga Krijuesi për të gjithë njerëzimin deri në fundin e kësaj bote, Islami u përhap me shpejtësi edhe në rajonin e Evropës, pasi ishte shpërndarë më herët në Persi dhe Bizant pas rënies së atyre perandorive të mëdha.

Deri në shekullin e tetë, sipas kalendarit gregorian, kur Islami dhe myslimanët e parë u paraqitën në Evropë pas pushtimit të Spanjës dhe Gadishullit Iberik, e pastaj një pjese të madhe të Portugalisë (që njohim sot) nga Halifati Umejad, Evropa ka qenë e zhytur në një errësirë jo vetëm për shkak të mungesës së diturisë dhe lirisë së mendimit të lirë për shkak të trysnisë dhe ndalimeve që vinin nga papati dhe kisha e sektit katolik, por gjithashtu, ata nuk kishin asnjë qytetërim më të cilin mund të krenoheshin në ato kohë, ku përveç kështjellave, atje nuk kishte asgjë tjetër.

Ndërkohë, në shumë anë të tjera të botës së asaj kohe, brenda 100 vjetësh, myslimanët, përmes diturisë dhe lirisë së mendimit që u kishte dhënë Islami dhe Kurani fisnik, kishin arritur të përhapnin dituri, kulturë e qytetërim kudo që ata shkelnin, duke mos prishur asnjë qytetërim të vendeve apo popujve të cilat i pushtonin.

Kjo është pikërisht arsyeja pse deri më sot gjenden shumë ndërtime nga trashëgimia e pasur kulturore islame në shumë vende të botës, në Lindje e në Perëndim.

E njëjta ndodh edhe me shumë objekte të mbetura ende nga trashëgimia e pasur islame në Evropë, ku shumë turistë mahniten nga kjo trashëgimi e ndritur dhe e mbetur në shumë vende, si në Itali, Spanjë, Portugali, krahas shumë vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit, duke përfshirë dhe trashëgiminë kulturore islame në trojet shqiptare, si pjesë e Evropës së madhe.

A është kjo një pengesë për Evropën? Absolutisht që jo, pasi trashëgimia kulturore e qytetërimit islam është një pjesë e rëndësishme e tërësisë së të gjithë Evropës dhe nuk mund të shkatërrohet tërësisht, pasi do të ishte në dëm të vetë kontinentit.

Muhamed Asad ka një thënie të bukur në lidhje me këtë. Ai thotë se: "Sot, asnjë komb apo grup i vetëm, nuk është në gjendje që të qëndrojë i izoluar nga pjesa tjetër e botës."[1]

Trashëgimia kulturore islame në Evropë e ka zanafillën pikërisht në kohën kur kalifati islam po zgjerohej shumë dhe Islami si besim dhe sistem jete po pranohej nga shumë popuj të botës. Gjatë asaj kohe, në Bagdad sundonte kalifati i Abasidëve.

Sundimi i Harun el Rashidit, kalifit të pestë abasid (mbretëroi 786–809), konsiderohet si kulmi i fuqisë së Epokës së Artë Islame. Ai themeloi bibliotekën legjendare Bejt el Hikmah ("Shtëpia e Urtësisë") në Bagdad dhe gjatë sundimit të tij Bagdadi filloi të lulëzonte si një qendër botërore e dijes, kulturës dhe tregtisë, ku vinin njerëz nga e gjithë bota për të marrë dhe shpërndarë dituri.

Kështu, ndërsa Bagdadi, Kajro, Damasku, Samarkandi dhe Isfahani gjatë kësaj kohe njiheshin si qendra të qytetërimit dhe trashëgimisë islame në Lindje, Andaluzia (Spanja e sotme) në të njëjtën kohë u bë qendra e qytetërimit dhe trashëgimisë islame në Evropë dhe Perëndim.

Dijetarë të mëdhenj, shkencëtarë, poetë dhe artistë gjendeshin kudo nëpër rrugët e Evropës islame, duke ndriçuar me dituri dhe pjesë të tjera të kontinentit. Myslimanë, të krishterë dhe çifutë bashkëpunonin për të mirën e shoqërisë,

ku emrat e tyre janë skalitur në librat e historisë së përbashkët të qytetërimit dhe trashëgimisë islame në Evropë.[2]

Edhe pse Kisha dhe Papati e urrenin Islamin dhe myslimanët, ata nuk mund të kundërshtonin qytetërimin që ata sollën në rajon, pasi ishte i dukshëm dhe një trashëgimi e prekshme, saqë shumë priftërinj e kardinalë të krishterë, të sektit katolik, i dërgonin zyrtarët apo fëmijët e tyre në Andaluzinë islame që të mësonin fillimisht gjuhën arabe, e më pas edhe shkencat e ndryshme të shpikura nga myslimanët, për të cilat Evropa e krishterë katolike as që e kishte njohurinë që ekzistonin.

Fatkeqësisht, ripushtimi i rajonit të Andaluzisë, si dhe shkatërrimi i kalifatit të Kordobës nga mbretëritë e krishtera të Evropës, i bëri dëm fillimisht vetë Evropës, pasi ato popuj u sulën si barbarë ndaj qytetërimit islam dhe shkatërruan shumë trashëgimi islame në të gjitha vendet që ripushtuan.

Krahas djegies së shumë objekteve, shkatërrimit të shumë institucioneve, si: xhami, hamame, shtëpi, medrese (shkolla) etj., ata dogjën edhe shumë libra e libroteka, për diturinë e të cilave myslimanët kishin derdhur djersë dhe u ishte dashur një kohë e gjatë për t'i shkruar.

Për të kuptuar mbi ndikimin e qytetërimit dhe trashëgimisë së madhe islame të Evropës, edhe pse i bazuar në një novelë me gabime historike, ju këshillojmë të ndiqni filmin me titull "Mjeku" (The Physician), i cili bën fjalë vetëm për njërin nga mjekët, filozofët dhe dijetarët myslimanë të asaj kohe, Ibën Sina, dituria e të cilit kishte marrë emër dhe ishte shpërndarë në të gjithë botën e asaj kohe, si dhe shfrytëzohet ende sot.

Janë shkruar me qindra e mijëra libra në lidhje me trashëgiminë e madhe kulturore islame që ka pasur Evropa, e në veçanti Andaluzia (Spanja e sotme), duke përmendur gjithashtu fatkeqësinë e madhe që të krishterët e paqytetëruar katolikë të Evropës së asaj periudhe, të zhytur në errësirën mesjetare, i sollën atij qytetërimi, pasi dihet se deri në ato kohë fiset dhe kombet e krishtera të rajonit jetonin vetëm duke luftuar mes tyre.

Pas një shekulli të gjatë luftimesh kundër qytetërimit islam në Evropë, veçanërisht në Andaluzi, përgjegjësit kryesorë të kësaj gjëme njihen mbreti Ferdinand dhe mbretëresha Isabela, të njohur si monarkë të krishterë katolikë, ku përmes martesës dhe marrjes së pushtetit, ata themeluan një komb të krishterë të sektit katolik, që vazhdoi me vrasjen, burgosjen dhe shpërnguljen e shumë çifutëve dhe myslimanëve nga Evropa duke shkatërruar shumë nga arritjet që myslimanët kishin arritur gjatë sundimit të tyre nëntë-shekullor në Andaluzi (Spanjë) dhe në vende të tjera të Evropës, si në Portugali, Francën jugore dhe Sicili të Italisë.

POR ÇFARË ROLI LUAN SOT TRASHËGIMIA E MBETUR ISLAME NË EVROPË?

Nga vizitat në xhaminë "Alhambra" në Granada të Spanjës, të kthyer me dhunë në kishë nga katolikët gjatë mesjetës, vetëm në vitin 2013 janë përfituar 490 milionë euro nga turizmi vendas, duke u bërë kështu monumenti më i vizituar në Spanjë dhe nga më të vizituarit në të gjithë Evropën e sotme. Ndërtesat shoqëruese të saj dhe parqet përreth tregojnë ende madhështinë dhe krenarinë e arritjes së lartë të qytetërimit islam në Spanjë dhe Evropë, duke u pranuar si një bukuri e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Xhamia "Alhambra", bashkë me objektet e tjera që ekzistonin gjatë sundimit të myslimanëve atje, u bë për shumë shekuj qendra e qytetërimit dhe trashëgimisë së madhe evropiane, duke qenë tregues i qartë se Evropa e asaj kohe u bë një qendër e rëndësishme e çifutëve, të krishterëve dhe myslimanëve, ku përmes parimeve hyjnore dhe të drejtave islame, respekti i lartë për çdo qenie njerëzore që jepte kontribute në aspektin e diturisë për të gjithë shoqërinë në Andaluzi, ishte shumë i lartë.

Shumë nga librat e shkruar nga studiues të ndryshëm të asaj kohe, u përvetësuan më vonë nga udhëheqësit e krishterë katolikë të Evropës, ku shumë prej tyre janë përdorur deri vonë si burime shkencore diturie në lidhje me çështje të ndryshme të mjekësisë, filozofisë, sociologjisë, shkencës dhe teknologjisë. Librat e Ibën Sinas, Ibën Rushdit, Muhamed Gazalit, Ibën Haldunit, Xhabir ibën Hajthamit, e shumë të tjerëve shfrytëzohen ende sot si referenca nga universitete evropiane me famë.

Evropa e sotme duhet të marrë ende mësime nga dituria, dijetarët, si dhe nga sunduesit myslimanë që sunduan me drejtësi me të gjithë popujt me etni dhe besime të ndryshme në Andaluzi dhe pjesë të tjera të Evropës, për të cilën shkruhen ende libra me dëshmi të kohës, të cilat shfrytëzohen nga studiuesit sot.

Është për të ardhur keq se shoqëritë shqiptare në të gjitha trojet tona, nuk i kemi dhënë shumë rëndësi trashëgimisë kulturore islame në Evropë, veçanërisht në Andaluzi, ku qytetërimi islam ka qenë më shumë i përcaktuar. Gjithashtu, shoqëria jonë nuk i ka dhënë rëndësi as historisë së qytetërimit islam në Sicili të Italisë (saraçenët) dhe trashëgimisë islame atje, si pjesë e rëndësishme në atë pjesë të Evropës, pasi mund të gjenden dhe shumë burime mbi ardhjen e Islamit në trojet shqiptare nga ky rajon, meqenëse është më i afërt me brigjet tona shqiptare përmes detit. Krahas disa shkrimeve autoriale apo të përkthyera mbi këtë çështje në shqip, apo përkthimit të ndonjë libri, si p.sh. në Tiranë, për këtë tema, nuk kemi botime të tjera.

Mund të përfundojmë me bindje të madhe se Evropa, duke përfshirë dhe trojet shqiptare, pa ndikimin e trashëgimisë së pasur kulturore islame dhe të qytetërimit islam, sot do të mund të përjetonte ende vazhdimin e periudhës së errët të saj.

---

1 Marrë nga libri "Shpirti i Islamit", Tiranë, 2025.

2 Për këtë ju këshillojmë të lexonin librin "Historia e shkencës islame", të shkruar nga autori belgo-amerikan Xhorxh Sarton, Tiranë, 2020.

Leksionet e Huzurit dhe zhvillimi i tyre historik

PJESËMARRJA E HAXHI ILJAS EFENDIUT NGA PRISHTINA NË LEKSIONET E HUZURIT – ANALIZA E DORËSHKRIMEVE TË TIJ

Arton Halili

Leksionet e Huzurit u institucionalizuan në shekullin XVIII dhe gjatë Ramazanit zhvilloheshin me ligjërues të përzgjedhur. Në kohë Abdylhamitin II ato u bënë simbol i lidhjes mes sarajit dhe ulemasë, derisa u ndërprenë më 1924.

Origjina e leksioneve të Huzurit bazohet në interesimin e veçantë që sulltanët osmanë tregonin ndaj dijes. Që nga periudha e Sulltan Mehmetit II, dihet se në rrethinën e sarajit zhvilloheshin biseda dhe diskutime shkencore. Megjithatë, këto mësime morën emrin “Leksionet e Huzurit” dhe një strukturë të rregullt e institucionale në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, veçanërisht gjatë periudhës së Sulltan Mahmutit I (1730–1754).[1] Forma më e rregullt dhe më e zhvilluar e Leksioneve të Huzurit është vërejtur gjatë periudhave të Sulltan Mahmutit II (1808–1839) dhe Sulltan Abdylmexhidit (1839–1861). Në këto periudha, mësimet zhvilloheshin sipas rregullave të caktuara, ligjëruesit dhe pjesëmarrësit përzgjidheshin me kujdes, dhe gjatë gjithë muajit Ramazan organizoheshin në mënyrë të rregullt takime të tefsirit.[2] Gjatë periudhës së Sulltan Abdylhamitit II, Leksionet e Huzurit e kaluan kufirin e të qenit vetëm një veprimtari shkencore dhe u shndërruan në një simbol të lidhjes zyrtare-fetare të legjitimitetit ndërmjet sarajit dhe ulemasë.[3] Këto leksione u zhvilluan për herë të fundit në vitin 1924 dhe më pas, me fillimin e periudhës së Republikës, u ndërprenë përfundimisht.[4]

PJESËMARRËSIT DHE MËNYRA E ZBATIMIT

Në pallatin osman, gjatë muajit Ramazan, në Leksionet e Huzurit, dijetari që ligjëronte quhej “mukarrir”, ndërsa dijetarët që merrnin pjesë në diskutime quheshin fillimisht “talip”, e më pas “muhatap”. Dihet se në këto Leksione të Huzurit merrnin pjesë shejhulislamët, kazaskerët, myderrizët, ulemaja e pallatit dhe ndonjëherë edhe dijetarë të shquar të ftuar nga provincat.[5] Ndër të dhënat e pasqyruara në burime përfshihet edhe fakti se mukarrirët dhe muhatapët, përpara ditëve zyrtare të leksioneve, nuk zhvillonin diskutime apo shqyrtime private ndërmjet tyre, por kishin mundësi të mbanin ligjërata vetëm në mënyrë publike, në ditët e caktuara zyrtarisht.[6]

Në këto leksione, fillimisht lexohej një ajet, më pas mukarriri e shpjegonte atë dhe zhvillonte një bisedë të thelluar shkencore duke iu përgjigjur pyetjeve të muhatapëve. Në rastet kur disa muhatapë e tejkalonin kufirin në debatet e tyre, ndërhyhej me paralajmërime ose, në raste të caktuara, ata përjashtoheshin nga mbledhja.[7] Sa i përket renditjes hapësinore, mukarriri ulej në të djathtën e sulltanit, ndërsa muhatapët zinin vend përpara rahleve, në formë gjysmëharku pranë tij. Pjesëmarrësit e leksionit caktoheshin personalisht nga sulltani.[8] Fakti që përbërja e këtyre mbledhjeve përcaktohej nga instanca më e lartë e shtetit, përbën një dëshmi të qartë të rëndësisë së këtyre leksioneve në kuadër të administrimit shtetëror.

METODOLOGJIA E TEFSIRIT NË KUADËR TË LEKSIONEVE TË HUZURIT

Gjatë Leksioneve të Huzurit, të organizuara në muajin Ramazan, fokusi kryesor ishte zakonisht në tefsirin e ajeteve. Ajetet e komentuar në këto leksione zakonisht përzgjidheshin

për thellësinë e kuptimit të tyre. Mukarrirët referoheshin te burime klasike të tefsirit (si Zemahsheriu, Raziu, Bejdaviu etj.) dhe interpretimin e ajetit e bënin duke analizuar fjalën, gramatikën, kontekstin dhe urtësinë e kuptimit.[9] Kjo traditë u mbajt deri në vitin 1923. Megjithatë, me ndryshimet strukturore që solli periudha republikane, Leksionet e Huzurit u ndërprenë përfundimisht.[10]

Një praktikë e ngjashme me Leksionet e Huzurit të zhvilluara gjatë periudhës osmane zhvillohet sot nga sulltani i Marokut, dhe këto ligjërata botohen nën emrin Ed Durusu'l-Hasenijje, në gjuhët arabe dhe angleze.[11]

Të zgjidhesh si mukarrir për këto mësime konsiderohej një prestigj i madh; këta persona zakonisht përzgjidheshin ndër më të aftët nga mësuesit e medreseve. Pjesëmarrja në këto leksione është konsideruar si një tregues i kompetencës shkencore dhe i afërsisë me pallatin.[12] Me kalimin e kohës, numri i muhatapëve u rrit, ndërsa kohëzgjatja, ditët dhe mënyra e zhvillimit të leksioneve pësoi ndryshime. Për shembull, në vitin 1767, në këto leksione morën pjesë 126 dijetarë, të cilët u ndanë në 19 këshilla.

HAXHI ILJAS EFENDI PRISHTINA

Sa i përket datës së lindjes së birit të Muratit, haxhi Iljas efendi Prishtinës, ajo nuk dihet me saktësi, megjithatë ajo që është e sigurt është se ai ka lindur në Prishtinë. Gjatë gjithë karrierës së tij shkencore dhe administrative, emri i tij ishte gjithmonë i lidhur me qytetin e lindjes, duke u identifikuar kështu me Prishtinën. Për këtë arsye, ai njihej gjerësisht në publik si haxhi Iljas efendi Prishtina, dhe ky titull figuron po ashtu në mbishkrimin e varrit të tij (shih figurën 1). Arsimin e lartë fetar e përfundoi në medresetë e Fatihut në Stamboll; ixhazetin e mori nga hafëz Ali bin Muhamed bin Abdullah el Birgevi. Haxhi Iljas efendi Prishtina ka dhënë mësim në Medresenë e Fatihut në kuadër të "ders-i âm" dhe konsiderohej një nga autoritetet më të rëndësishme akademike dhe shkencore të Stambollit në gjysmën e dytë të shekullit XIX.[13] Ai ka marrë pjesë në Leksionet e Huzurit si mukarrir.[14] Po ashtu ka qenë një nga mësuesit të shejhulislamit Mehmed Nuri Efendiut.[15] Haxhi Iljas efendi Prishtina ndërroi jetë në dhjetëditëshin e parë të muajit Rexheb, në vitin 1890, dhe u varros në oborrin e Xhamisë së Fatihut.[16]

Mbishkrimi mbi varrin e haxhi Iljas efendi Prishtinës

TEMAT KRYESORE TË VEPRËS

Tefsiri që haxhi Iljas efendi Prishtina ka shkruar mbi ajetin 156 të sures El A'raf nuk kufizohet vetëm në analizën fjalë për fjalë, por paraqet një shembull interpretimi me shumë shtresa, i pasuruar me elemente të akides, tasavufit, moralit, strukturës sociale dhe referencave historike. Më poshtë janë renditur temat kryesore të hasura në këtë dorëshkrim tefsiri.

KUPTIMI I ZEKATIT, NEFSI DHE DASHURIA PËR PASURINË

Për të nënvizuar vendin thelbësor të dashurisë për pasurinë në natyrën njerëzore, në këtë dorëshkrim theksohet shprehja "المال شقيق الروح", "pasuria është vëllai i shpirtit". Vështirësitë e Beni Israilëve për ta dhënë zekatin për shkak të lidhjes së tyre të fortë me pasurinë interpretohen si një tregues i drejtpërdrejtë i provës me nefsin. Në këtë kuadër, ibadeti i zekatit nuk konsiderohet vetëm një detyrim financiar, por edhe një mjet hyjnor për pastrimin e nefsit, kontrollimin e dashurisë ndaj botës dhe vendosjen e drejtësisë shoqërore.

DETYRIMI PËR TË BESUAR KOLEKTIVISHT NË ARGUMENTET E QARTA

Haxhi Iljas efendi Prishtina shprehjen "ajet-i bejjinat" (argumente të qarta) që përmendet në ajet, e komenton jo vetëm si mrekulli, por edhe si çdo dëshmi krijesore dhe shpallëse që vërteton zotërimin e Allahut dhe vërtetësinë e pejgamberëve. Në këtë kuptim, imani nuk duhet të jetë vetëm në disa ajete, por duhet të realizohet me lidhje të pandërprerë dhe të plotë me të gjitha ajetet. Qasja e Beni Israilëve "disa i besojmë, disa i mohojmë" kritikohet, dhe theksohet se imani i vërtetë nuk mund të copëtohet.

PËRFSHIRJA E MËSHIRËS HYJNORE

Një nga konceptet mbi të cilat është ndalur më shumë në tefsir, është se mëshira hyjnore përfshin çdo gjë. Kjo mëshirë nuk kufizohet vetëm te besimtarët, por arrin edhe te jobe-

Pjesë nga dorëshkrimi origjinal i veprës

simtarët, te kafshët, madje edhe te krijesat e pajeta. Duke u mbështetur në hadithin e të Dërguarit të Allahut a.s.: “قد تحجّرت واسعاً”, “*E ngushtove atë që është e gjerë*”, theksohet se mëshira nuk mund të kufizohet, dhe se mëshira e Allahut buron krejtësisht nga vullneti i Tij. Ky interpretim përforcohet edhe me hadithin kudsi: “*Mëshira Ime ka kapërcyer hidhërimin Tim.*”

THELBI I PENDIMIT DHE KUSHTET E PRANIMIT TË TIJ

Në shpjegimin që bëhet mbi lutjen e Musait a.s : “إنا هدنا إليك”, “*Ne u kthyem tek Ti*”, analizohet nga aspekti gjuhësor folja “hudna”, dhe theksohet se pendimi duhet të jetë më shumë se një fjalë në gojë; ai duhet të jetë një kthim i sinqertë që buron nga zemra. Haxhi Iljas efendi Prishtina shpjegon se kthimi tek Allahu nuk është çështje forme, por çështje thelbi, dhe se një pendim i pasinqertë nuk pranohet. Në këtë kuptim, pendimi shihet jo vetëm si një akt i kthimit dhe nënshtrimit individual ndaj Allahut, por edhe si një përgjegjësi me dimension shoqëror.

TRESHJA: DEVOTSHMËRIA, ZEKATI DHE BESIMI NË KURANIN

Me shprehjen e ajetit “فَسَأَكْتُبُهَا لِلَّذِينَ يَتَّقُونَ”, “*Unë do ta shkruaj atë (mëshirën) për ata që janë të devotshëm*”, tregohet se për kë do të shkruhet mëshira e Allahut në botën tjetër. Këta njerëz përshkruhen me tre cilësi kryesore: të jenë të devotshëm, të japin zekatin dhe të lidhen me një besim të pandërprerë në ajetet hyjnore. Këto tri cilësi tregojnë se mëshira nuk është vetëm çështje e dhuntisë së Allahut, por lidhet edhe me kryerjen e detyrimeve nga ana e robit. Theksohet në mënyrë të veçantë përmendja e zekatit, gjë që tregon se ai është njëkohësisht edhe adhurim, edhe detyrim me dimension moral.

MADHËRIMI I KURANIT DHE RRËFIMI PËR OSMAN GAZIN

Në rrëfimin që vendoset në fund të tefsirit, përmendet se Osman Gazi, për shkak të respektit që tregoi ndaj Mushafit, u përgëzua nga Allahu me hilafetin. Ky tregim paraqitet si një shembull i fuqishëm se si respekti ndaj Kuranit ndikon si në përsosjen individuale, ashtu edhe në të ardhmen shoqërore. Nderimi ndaj Kuranit nuk shihet vetëm si një sjellje e jashtme mirësjelljeje, por edhe si shenjë e besnikërisë dhe lidhjes së brendshme ndaj tij.

TIPARET E PËRGJITHSHME TË VEPRËS

Dorëshkrimi i tefsirit të ajetit 156 të sures El A‘râf nga haxhi Iljas efendi Prishtina është një shembull origjinal i traditës klasike osmane në dije dhe art. Është shkruar me shkrimin nes’h, me faqe prej rreth 19 rreshtash dhe dimensione afërsisht 23 x 33 cm. Letra është e lëmuar, me ngjyrë bezhë të verdhë, ndërsa teksti kryesor me bojë të zezë, i shoqëruar me tituj dhe korniza të zbukuruara me ngjyrë ari, të kuqe e të gjelbër. Zbukurimet përfshijnë motive bimore dhe figurën e gjysmëhënës me lule në faqen e parë, si dhe një ornament trekëndësh në fund që shënon mbylljen e dorëshkrimit. Në faqen përfundimtare, autori nënshkruhet me modesti si “el-da‘i el-muhlis Prishtinasi el Haxh Iljas ibn Murad”, duke vërtetuar përfundimin e veprës dhe të procesit të dorëshkrimit.

---

1 Mehmet İpşirli, *Huzur Dersleri*, TDV İslâm Ansiklopedisi, https://islamansiklopedisi.org.tr/huzur-dersleri.

2 Ibid.

3 Ibid.

4 Ibid.

5 Mehmet İpşirli, *Huzur Dersleri*, Türk Maarif Ansiklopedisi, https://turkmaarifansiklopedisi.org.tr/huzur-dersleri

6 Ibid.

7 Ibid.

8 Ibid.

9 Mehmet İpşirli, *Huzur Dersleri*, TDV İslâm Ansiklopedisi, https://islamansiklopedisi.org.tr/huzur-dersleri

10 Ibid.

11 Ibid.

12 Ibid.

13 Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmeti, Ramadan Shkodra, *Dijetarë shqiptarë në perandorinë osmane (1880-1912),* Prishtinë, (2021), f. 48.

14 Rıdvan Kara, *Osmanlı’da Huzur Dersleri Kronolojisi*, Sakarya Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi (SAUIFD) 26/49 (05 Haziran 2024), f. 275-302.

15 Tahsin Özcan, *Mehmed Nûri Efendi,* TDV İslâm Ansiklopedisi, https://islamansiklopedisi.org.tr/mehmed-nuri-efendi.

16 Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmeti, Ramadan Shkodra, *Dijetarë shqiptarë në perandorinë osmane (1880-1912),* Prishtinë, (2021), f. 48.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM MINISTRIN NË DETYRË TË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT, Z. HAJRULLA ÇEKU

Më 12 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim ministrin në detyrë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku.

Gjatë këtij takimi u bisedua rreth bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, me theks të veçantë në projektet e restaurimit dhe ruajtjes së trashëgimisë islame në vend. Të dyja palët vlerësuan se ky bashkëpunim ka dhënë rezultate të prekshme në mbrojtjen e objekteve me vlerë historike, kulturore dhe fetare, e të cilat përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të identitetit tonë kombëtar dhe shpirtëror.

Myftiu Tërnava e falënderoi ministrin në detyrë, z. Çeku për mbështetjen dhe përkushtimin e treguar, duke theksuar se kujdesi ndaj trashëgimisë islame është një detyrë e përbashkët e të gjithëve, si dhe një vlerë që duhet trashëguar brezave të ardhshëm.

Nga ana e tij, ministri në detyrë, z. Çeku, shprehu gatishmërinë e Ministrisë për të vazhduar bashkëpunimin me Bashkësinë Islame të Kosovës, me synimin që trashëgimia kulturore islame të mbrohet, të restaurohet dhe të promovohet si pasuri e përbashkët e vendit tonë. Ai çmoi lart përkushtimin dhe përpjekjet e Bashkësisë Islame të Kosovës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E ITALISË NË KOSOVË, Z. MAURIZIO ANTONINI

Më 8 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në një takim kurtuazie ambasadorin e Italisë në Republikën e Kosovës, z. Maurizio Antonini.

Gjatë takimit, Myftiu Tërnava, e njohu ambasadorin italian me historikun dhe funksionimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, me të arriturat dhe zhvillimet e saj ndër vite, si dhe me rolin që ky institucion luan në kultivimin e bashkëjetesës, harmonisë ndërfetare dhe paqes shoqërore në vendin tonë.

Kurse, nga ana e tij, ambasadori Antonini, e falënderoi Myftiun për mikpritjen dhe vlerësoi lart rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës si faktor stabiliteti dhe dialogu në shoqërinë kosovare.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E RI TË HUNGARISË NË KOSOVË

Më 16 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Hungarisë në Republikën e Kosovës, z. László István Dux.

Myftiu Tërnava fillimisht i uroi mirëseardhje ambasadorit, e më pas e uroi atë për detyrën e re, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Më pas, gjatë takimit, Myftiu Tërnava, e njohu ambasadorin për veprimtaritë dhe angazhimet e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke theksuar rolin që ky institucion ka në edukimin fetar, ruajtjen e harmonisë ndërfetare dhe promovimin e vlerave morale në shoqëri. Ai nënvizoi se BIK-u ka qenë gjithmonë faktor stabiliteti dhe paqeje në vend, duke kontribuar për mirëqenien shpirtërore dhe shoqërore të qytetarëve.

Nga ana e tij, ambasadori Dux, çmoi lart rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe kontributin e saj të vazhdueshëm në forcimin e vlerave të paqes, dialogut dhe bashkëjetesës.

NË XHAMINË E MADHE NË PRISHTINË U MBAJT PROGRAM PËR NDER TË MEVLUDIT – DITËLINDJES SË PEJGAMBERIT A.S.

Më 8 shtator 2025, me këndimin e pjesëve nga Kurani fisnik, salvateve, ilahive dhe pjesëve nga Mevludi, në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, u mbajt manifestim kushtuar Mevludit – ditëlindjes së Pejgamberit a.s..

Ligjëratën kryesore kushtuar jetës dhe porosive të Pejgamberit a.s. e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, i cili ndër të tjera tha se Pejgamberi a.s. erdhi si mëshirë për mbarë botët dhe për të gjitha krijesat.

“Zoti i Madhëruar që nga krijimi i njeriut të parë, Ademit a.s., dërgoi edhe pejgamber, që njeriun mos ta linte të pa udhëzuar. Kështu nisi vargun e pejgamberëve nga Ademi a.s. për të vazhduar kështu deri te Muhamedi a.s., i cili erdhi si mëshirë për gjitha botët dhe gjitha krijesat. Zoti i Madhëruar, në një ajet kuranor, thotë: “Ne të dërguam ty vetëm si mëshirë për gjitha krijesat.”

Myftiu Tërnava më tej porositi që jeta dhe mësimet e Pejgamberit a.s. vazhdimisht të rikujtohen nëpër shtëpitë tona, qoftë përmes këndimit të Mevludit, apo edhe përmes leximit të librave që janë shkruar për jetën e bekuar të Pejgamberit a.s..

Programi më pas vazhdoi me këndimin e pjesëve nga Mevludi nga hoxhallarët, Jahir ef. Beqiri dhe Sallah ef. Feta, si dhe me këndimin e ilahive nga vëllezërit Allajbeg.

U PËRURUA OBJEKTI I DEPARTAMENTIT TË GRUAS NË GJILAN

Më 10 shtator 2025, Këshilli i BI-së në Gjilan përurroi objektin e ri që do të shfrytëzohet për organizimet e Departamentit të Gruas dhe për mësim -besimin e nxënësve të qytetit. Në ceremoni morën pjesë Myftiu Naim ef. Tërnava me bashkëpunëtorët, përfaqësuesit e Këshillit të Gjilanit dhe donatori nga "Swiss Barakah", z. Ardian Mehmetaj. Në fjalën e tij, Myftiu kujtoi rëndësinë e dijes si porosi e parë hyjnore dhe theksoi se fjala e parë e shpallur ishte "Lexo", që tregon se përmes leximit arrihet arsimimi e edukimi. Ai po ashtu porositi ruajtjen e vetes, vendit dhe familjes, duke kujtuar sakrificat e popullit. Kryetari i Këshillit të Gjilanit, Naim ef. Aliu, falënderoi donatorët dhe vlerësoi rëndësinë e objektit për fëmijët. Përfaqësuesi i "Swiss Barakah", Ardian Mehmetaj, u shpreh i lumtur që objekti do të shërbejë si mundësi e artë për nxënie dhe zhvillim të aspiratave të fëmijëve. Në fund, Myftiu vizitoi nxënësit që vijojnë mësim-besimin në këtë hapësirë.

MYFTIU TËRNAVA REALIZOI NJË VIZITË PUNE NË KËSHILLIN E BI-SË SË GJILANIT

Më 10 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka vizituar Këshillin e Bashkësisë Islame në Gjilan, në të cilin u prit nga kryetari Naim ef. Aliu, administrata dhe anëtarët e këtij Këshilli.

Gjatë këtij takimi u diskutua për mbarëvajtjen e jetës fetare në Gjilan, si dhe për projektet e reja që janë duke u zhvilluar në këtë qytet.

Pjesë e kësaj vizite ishte edhe vizita e objektit vakëf të Këshillit të BI-së së Gjilanit, i cili është në ndërtim e sipër, si dhe vizita në punishten e ndërtimit të xhamisë në Lagjen e Spitalit.

Myftiu Tërnava u njoh për së afërmi me ecurinë e punimeve në këto dy objekte, për të cilat tha se do ta lehtësojnë mbarëvajtjen e jetës fetare këtu.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS

Më 11 shtator 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnava.

Gjatë kësaj mbledhje u diskutua për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026 në Medresenë e Mesme "Alauddin", si dhe për fillimin e vitit të ri akademik 2025-2026 në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

Po ashtu gjatë mbledhjes u diskutuan edhe lëndë të tjera bazuar në kompetencat e Kryesisë së BIK-ut.

U HAP DYQANI I BAMIRËSISË NË FUSHË KOSOVË

Më 12 shtator 2025, Shoqata Humanitare "Bereqeti" hapi në Fushë Kosovë dyqanin e bamirësisë, të katërtin pas Prishtinës, Prizrenit dhe Malishevës. Në hapje morën pjesë Myftiu Naim ef. Tërnava me bashkëpunëtorë, nënkryetari i Komunës Besnik Osmani, përgjegjësi i "Bereqetit" Xheladin ef. Fazliu dhe kryetari i Këshillit të BI-së, Valon ef. Ibrahimi. Myftiu tha se fillimisht do të ndihmohen rreth 50 familje, duke theksuar përkrahjen e donatorëve dhe bashkëpunimin me Komunën. Osmani shtoi se objekti do të zgjerohet në të ardhmen. Dyqani ofron produkte ushqimore dhe higjienike bazike.

U VU GURTHEMELI I XHAMISË SË RE NË FUSHË KOSOVË

Më 12 shtator 2025, në prani të Myftiut të Kosovës Naim ef. Tërnavës, kryetarit të Fushë Kosovës Burim Berisha, përfaqësuesit të Shoqatës së Katarit Ahmed al Ashal, kryetarit të Këshillit të BI-së Valon ef. Ibrahimit dhe të tjerëve, u vu solemnisht gurthemeli i xhamisë së re në Fushë Kosovë.

Myftiu tha se kjo ditë shënon realizimin e një dëshire të kahershme, duke falënderuar Komunën për bashkëpunimin dhe Shoqatën e Katarit për përkrahjen 25-vjeçare ndaj Kosovës. Ai theksoi se veçanta e xhamisë është se financohet nga familja e emirit të Katarit, Muhamed bin Hamad bin Abdullah. Kryetari Berisha u shpreh i lumtur për nisjen e ndërtimit dhe theksoi se, me rritjen e qytetit, do të ndërtohen edhe xhami të tjera për besimtarët.

MYFTIU TËRNAVA TAKOI KOORDINATORËT E SHOQATËS HUMANITARE BAMIRËSE "BEREQETI"

Më 15 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka zhvilluar një takim me koordinatorët e Shoqatës Humanitare Bamirëse "Bereqeti".

Në këtë takim u diskutua për rrugëtimin dhe sukseset e deritanishme të kësaj shoqate, për sfidat me të cilat janë përballur gjatë realizimit të projekteve humanitare, si dhe për planet dhe synimet në të ardhmen.

Myftiu Tërnava vlerësoi lart angazhimin e koordinatorëve në terren, duke theksuar rëndësinë e punës së tyre në shërbim të familjeve në nevojë dhe të gjithë shoqërisë. Ai shprehu mbështetjen e plotë të Bashkësisë Islame të Kosovës për nismat e "Bereqetit", duke nënvizuar se solidariteti dhe humanizmi janë vlera të çmuara islame.

Nga ana e tyre, koordinatorët e "Bereqetit" paraqitën të arriturat në projekte të ndryshme sociale, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen në përmbushjen e misionit të tyre. Ata falënderuan Myftiun Tërnava për mbështetjen e vazhdueshme dhe ofruan ide për projekte të reja që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët në nevojë.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI AMBASADËN E KUVAJTIT NË TIRANË

Më 17 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, vizitoi Ambasadën e Kuvajtit në Tiranë, ku u prit nga i ngarkuari me punë, z. Adnan al Gunejmi.

Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm dhe mundësitë e thellimit të tij. Myftiu falënderoi diplomatin kuvajtian për mbështetjen që Kuvajti i ka dhënë Kosovës, sidomos në projekte humanitare e zhvillimore.

Nga ana e tij, z. Al Gunejmi vlerësoi rolin e Bashkësisë Islame në shërbim të komunitetit dhe shprehu gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimit.

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA AMBASADORI I ARABISË SAUDITE NË TIRANË

Më 17 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, u prit nga ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fejsal Hifzi. Në takim u diskutua për forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve fetare dhe avancimin e projekteve të përbashkëta në dobi të besimtarëve dhe shoqërisë.

Myftiu falënderoi ambasadorin për përkrahjen që Arabia Saudite i ka dhënë myslimanëve të Kosovës, duke vlerësuar kontributin në jetën fetare dhe mbështetjen në fusha të ndryshme. Nga ana e tij, ambasadori Hifzi shprehu gatishmërinë për thellimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

MYFTIU TËRNAVA UROI PROF. DR. SAFI ARPAGUŞ PËR EMËRIMIN KRYETAR I ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

Më 19 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnava, i ka dërguar një telegram urimi prof. dr. Safi Arpaguş, me rastin e emërimit të tij në detyrën e lartë të kryetarit të Çështjeve Fetare të Turqisë.

Në urimin e tij, Myftiu Tërnava shprehu kënaqësinë dhe nderin për këtë emërim, duke e konsideruar këtë si një përgjegjësi me rëndësi të madhe për Republikën e Turqisë, popullin turk dhe mbarë umetin islam.

Ai, në emër të myslimanëve të Kosovës, uroi që detyra e re e prof. dr. Arpaguş të sjellë begati e dobi, si dhe shprehu urimet e tij të përzemërta për shëndet, suksese dhe mbarësi në kryerjen e kësaj përgjegjësie të lartë.

KOSOVA CUMHURİYETİ İSLAM BİRLİĞİ

BAŞKANLIĞI

Konu: Tebrik Mektubu

Sayın Prof. Dr. Safi Arpaguş

Türkiye Cumhuriyeti Diyanet İşleri Başkanı

Diyanet İşleri Başkanlığı görevine atanmış olmanız münasebetiyle zat-ı âlinizi en kalbi duygularımla tebrik ediyorum.

Bu müstesna vazifenizin Türkiye Cumhuriyeti, kardeş Türk halkı ve bütün İslâm ümmeti için hayırlara vesile olmasını Yüce Allah'tan niyaz ederim.

Kardeş ülkemiz Türkiye ile daima güçlü ve samimi bağlar içinde bulunan Kosova Müslümanları başta olmak üzere şahsım adına, yeni görevinizde üstün muvaffakiyetler dileklerimi en derin hürmetlerimle arz ederim.

Saygılarımla,

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME TË SARAJEVËS

Më 23 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në selinë e Kryesisë së BIK-ut një delegacion nga Fakulteti i Shkencave Islame në Sarajevë, i kryesuar nga dekani prof. dr. Mustafa Hasani, i shoqëruar nga prodekanët prof. dr. Zuhdija Hasanoviç, prof. dr. Nedim Begoviç dhe prof. dr. Ahmet Alibasiç.

Në takim u bisedua për mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë, me theks në shkëmbimin e studentëve e profesorëve, ngritjen e kapaciteteve akademike dhe realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e arsimit islam.

Myftiu Tërnava theksoi rëndësinë e shkëmbimit të përvojave ndërmjet institucioneve simotra, duke vlerësuar rolin e Fakultetit të Sarajevës në përgatitjen e kuadrove cilësore dhe ruajtjen e traditës së studimeve islame në rajon. Ai shprehu gatishmërinë e BIK-ut për të fuqizuar lidhjet institucionale dhe ndërtuar ura të reja bashkëpunimi.

Delegacioni nga Sarajeva vizitoi edhe institucionet fetaro-arsimore, veçanërisht Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, për të parë nga afër mundësitë konkrete të bashkëpunimit dhe zhvillimit të projekteve akademike.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ATASHEUN PËR ÇËSHTJE FETARE TË ARABISË SAUDITE NË SARAJEVË

Më 30 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim atasheun për çështje fetare të Arabisë Saudite në Sarajevë, njëherësh drejtor i Qendrës Kulturore "Mbreti Fahd" në Bosnjë dhe Hercegovinë, z. Abdulatif al Husain.

Në fillim të takimit, Myftiu Tërnava e uroi z. Al Husain për detyrën e re, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Më pas Myftiu Tërnava e njohu mysafirin me punët, angazhimet dhe të arriturat e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke theksuar rolin e rëndësishëm të këtij institucioni në mbarëvajtjen e jetës fetare në vend. Ai foli edhe për projektet dhe iniciativat e shumta që BIK-u ka ndërmarrë në fushën e edukimit fetar dhe shërbimeve ndaj besimtarëve. Kurse, nga ana e tij, atasheu Al Husain shprehu vlerësim për kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe u interesua për zhvillimin e bashkëpunimit në fusha me interes të ndërsjellë.

MYFTIU TËRNAVA DËRGOI TELEGRAM NGUSHËLLIMI ME RASTIN E VDEKJES SË MYFTIUT TË ARABISË SAUDITE

Më 25 shtator 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i ka dërguar një letër ngushëllimi mbretit të Mbretërisë së Arabisë Saudite me rastin e kalimit në botën tjetër të myftiut të Arabisë Saudite, shejh Abdulaziz al Shejh.

Në telegramin e tij, Myftiu Tërnava ngushëlloi familjen, të afërmit, kolegët dhe gjithë kombin arab, duke lutur Zotin e Madhëruar që myftiun Al Shejh ta mëshirojë dhe t'ia japë një vend në kopshtet e Xhenetit.

Myftiu Tërnava vlerësoi lart figurën e myftiut Al Shejh, duke e cilësuar atë si një dijetar të shquar dhe një jurist me njohuri të thella të parimeve të jurisprudencës islame. Ai tërë jetën e tij ia kushtoi shërbimit të dijes dhe njerëzve të saj, duke lënë pas vetes një trashëgimi të gjerë dhe të pasur shkencore.

BIK-U EKZEKUTOI MJETET FINANCIARE PËR 500 JETIMË

Më 2 shtator 2025, Bashkësia Islame e Kosovës ka ekzekutuar mjetet financiare për 500 jetimë në gjithë vendin për tremujorin e tretë të shpërndarjes, në kuadër të projektit "Përkujdesja ndaj jetimëve të Republikës së Kosovës", realizuar në bashkëpunim me Qendrën e "Mbretit Selman" të Arabisë Saudite. Shefi i Kabinetit të Myftiut, Besim Mehmeti, ritheksoi përkushtimin e BIK-ut për t'u gjendur pranë qytetarëve në çdo situatë.

Mjetet transferohen përmes xhirollogarive bankare për të shmangur prezencën fizike.

Në inaugurimin e projektit, Myftiu Naim ef. Tërnava shprehu mirënjohje për Qendrën "Mbretit Selman" për mbështetjen e vazhdueshme dhe theksoi synimin që vitet e ardhshme ndihmat të shtohen edhe për më shumë jetimë në gjithë territorin e Kosovës.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË MANIFESTIMIN QENDROR KUSHTUAR DITËLINDJES SË MUHAMEDIT A.S.

Më 3 shtator 2025, me ftesë të presidentit të Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në manifestimin qendror kushtuar ditëlindjes së Muhamedit a.s., në Pallatin Presidencial në Ankara.

Presidenti Erdogan, në fjalën e tij, vlerësoi jetën dhe misionin e Muhamedit a.s. si dritë udhëzuese për botën, duke përmendur edhe tragjedinë në Gaza dhe nevojën e paqes. Kryetari i Dijanetit, dr. Ali Erbash, theksoi rëndësinë e 12 Rebiul Evelit dhe shpalli këtë vit si vitin e ndriçimit të jetës dhe shembëlltyrës së Profetit, me rastin e 1500-vjetorit sipas kalendarit hënor.

Në manifestim morën pjesë krerë të bashkësive islame nga Ballkani e mbi dyzet vende, si dhe personalitete shtetërore e fetare. Aktiviteti u shoqërua me kaside, ilahi dhe salavate nga orkestra presidenciale. Veprimtaritë do të vijojnë në Konja me një konferencë ndërkombëtare mbi jetën dhe porositë e Profetit për familjen.

ORGANIZIM PËR BLERJEN E OBJEKTIT PËR XHAMI AU TË ZVICRËS

Më 21 shtator 2025, me ftesë të Xhamisë "Uniteti" në Au të Zvicrës, drejtori për Diasporë në BIK, Ekrem ef. Simnica, mori pjesë në tubimin "Me emrin e Allahut, bashkë ndërtojmë dritë e unitet", organizuar për blerjen e objektit të xhamisë në Cyrih.

Në këtë aktivitet morën pjesë shumë besimtarë nga diaspora, mysafirë nga trojet dhe përfaqësues të institucioneve islame nga Zvicra, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Lugina e Preshevës. Simnica, në emër të BIK-ut dhe Myftiut Tërnava, theksoi vlerën e xhamisë dhe rëndësinë e kontributit për ndërtim, renovim e blerje.

Tubimi u përmbyll me grumbullimin e 900 mijë CHF për blerjen e objektit të xhamisë. Në fund u shpërndanë dhurata dhe mirënjohje, të pranuara nga kryetari Qamil Begjeti dhe imami Irfan Musliu.



Sureja Jâsîn

Shtëpia botuese "Dituria Islame" ka nxjerrë në qarkullim librin në format xhepi "Sureja Jâsîn - e transkriptuar, e përkthyer dhe në arabisht".

Përkthimi i sures "Sureja Jâsîn" është marrë nga H. Sherif Ahmeti.

Të gjithë të interesuarit për broshurën "Sureja Jâsîn - e transkriptuar, e përkthyer dhe në arabisht", mund ta sigurojnë në librarinë "Dituria Islame" (https://www.facebook.com/librariadituriaislame), në Prishtinë.

DITURIA ISLAME • Nr. 419 TETOR 2025